

**ROLI I GJYKATËS NË FAZAT QË PARAPRIJNË GJYKIMIN E THEMELI NË
PROCEDIMINN PENAL**

ANDI DURAJ

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

Shkenca Juridike, me profil “E drejtë publike”, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Jordan Daci

Numri i fjalëve: 51.000

Tiranë, Janar, 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Une i nënshkruari Andi Duraj, deklaroj, nën përgjegjësinë time personale, se ky disertacion është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar asnjëherë përpara një komisioni apo institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara në brendësi të tij.

Andi Duraj

Abstrakt

Gjatë këtij studimi i është kushtuar një vëmendje e veçantë aspektit teorik – ligjor i figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake si një subjekt i pakonsoliduar në procedurën penale si dhe rolit të gjyqtarit të seancës paraprake gjatë procesit penal në vendin tonë.

Duke sjellë debatin juridik dhe praktikën gjyqësore si dhe duke analizuar në detaje këtë problematikë, përmes metodës krahasuese dhe analitike janë nxjerrë konkluzionet për praktikën më të mirë në disa vende sidomos në Itali por edhe në Kosovë, me qëllim që këto të aplikohen ose të gjejnë zbatim edhe në Shqipëri. Qëllimi final është padyshim plotësimi dhe harmonizimi i legjislacionit procedural penal i Republikës së Shqipërisë, me ato ndërkombëtare dhe në veçanti me ato të vendeve të Bashkimit Europian.

Fjalë kyçe: gjyqtar i hetimeve paraprake, procedim penal, gjyqtar i seancës paraprake, prokurori, policia gjyqësore, i pandehuri, mbrojtësi i të pandehurit, viktima Konventa e Palermos, legjislacioni italian mbi gjyqtarin e hetimeve paraprake dhe atë të seancës paraprake, legjislacioni kosovar, aspekte krahasimore.

Abstract:

During this study, special attention was paid to the theoretical-legal aspect of the figure of the preliminary investigations judge as an unconsolidated subject in the criminal procedure and the role of the pre-trial judge during the criminal process in our country.

Bringing the legal debate and case law as well as analyzing in detail this issue, through the comparative and analytical method, conclusions have been drawn for the best practices in some countries, especially in Italy but also in Kosovo, in order for these to be applied or find application. also in Albania.

The final goal is undoubtedly the completion and harmonization of the criminal procedural legislation of the Republic of Albania, with the international ones and in particular with those of the European Union countries.

Keywords: preliminary investigations judge, criminal proceedings, pre-trial judge, prosecutor, judicial police, defendant, defendant's defense counsel, victim, Palermo Convention, Italian legislation on preliminary investigations and pre-trial judge, Kosovo comparative legislation, comparative aspects.

DEDIKIMI

Këtë punim ia dedikoj familjes time që më ka mbështetur gjithmonë dhe i falenderoj për atë që kam arritur deri më sot.

FALENDERIME

Në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi, dëshiroj të përshëndes dhe veçanërisht të falenderoj të gjithë ata që janë treguar të gatshëm të më japin ndihmesën e tyre në realizimin e kësaj teme.

Falenderime të sinqerta shkojnë për kolegët e mi të Universitetit European të Tiranës për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë në kuadër të përfundimit të këtij disertacioni.

Familjes sime, e cila ka qenë dhe mbetet frymëzim e mbështetje për mua.

Miqve dhe kolegëve të mi, për të gjithë mbështetjen dhe mirëkuptimin e vazhdueshëm dhe të pakursyer.

Falenderimet e mia shkojnë edhe për udhëheqësin shkencor me të cilin njihem dhe jam mik prej vitesh.

Me mirënjohje

Andi Duraj

ROLI I GJYKATËS NË FAZAT QË PARAPRIJNË GJYKIMIN E THEMELI NË
PROCEDIMINN PENAL

TABELA E PËRMBAJTJES:

Deklarata e Autorësisë	1
Abstrakt.....	2
Abstract	3
Dedikimi	4
Falenderime.....	5
Tabela e Përmbajtjes	6
Lista e Shkurtimeve	10

KAPITULLI I:- HYRJE

1.1 Hyrje.....	11
1.2 Objekti studimit.....	i 13
1.3 Qëllimi dhe rëndësia e punimit	15
1.4 Metodologjia dhe metodat e kërkimit.....	16
1.5 Pyetjet kërkimore dhe Hipoteza.....	19

1.5.1	Pyetjet kërkimore.....	19
1.5.2	Hipotezat e studimit.....	20
1.6.	Kufizimet e punimit.....	21
1.7	Përmbledhja dhe struktura e studimit.....	22
1.8	Rishikimi i Literaturës.....	24

KAPITULLI II : SISTEMI PROCEDURAL PENAL DHE VLERAT KUSHTETUESE

2.1	Vështrim historik mbi lindjen dhe evolimin e sistemit procedural penal.....	30
2.2	Modeli inkuizitor dhe akuzator në procesin penal.....	33
2.2.1	Modeli “miks” i procesit penal.....	36
2.3	Dallimi midis ‘procedimit për hetimet paraprake’ dhe ‘procesit’.....	37
2.4	Garancitë e të pandehurit në Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut.....	40
2.5	Procesi i rregullt ligjor në Kushtetutë.....	42
2.6	Garancitë e të pandehurit në Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut.....	45
2.7	Garancitë e të pandehurit në Bashkimin European.....	47
2.8	Kontradiktoriteti si rregull i procesit penal.....	48

KAPITULLI III: ROLI GARANTUES DHE KONTROLLUES I GJYQTARIT PËR

HETIMET PARAPRAKE: Vështrim krahasues

3.1 Pamundësia e eleminimit të një faze që paraprin gjykimin.....	51
3.2 Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake në vende të ndryshme. Një vështrim i shkurtër.....	52
3.3 Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin italian. Nga gjyqtari hetues (giudice istruttore) në gjyqtarin e hetimeve paraprake (Giudice delle indagini preliminari).....	54
3.3.1 Roli dhe rëndësia e tij në sistemin procedural penal italian.....	57
3.3.2 Diskutimet mbi rolin dhe zgjerimin e funksioneve të gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin italian.....	61
3.4 Diskutimet mbi ecurinë e figures së gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe të gjyqtarit të seancës paraprake në legjislacionin kosovar.....	68

KAPITULLI IV: LINDJA DHE NEVOJAT PËR KONSOLIDIMIN E FIGURËS SË GJYQTARIT TË HETIMEVE PARAPRAKE NË LEGJISLACIONI PROCEDURAL PENAL SHQIPËTAR.

4.1 Vështrim historik mbi figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin procedural penal shqipëtar.....	72
4.2 Rëndësia e fazës së hetimeve paraprake.....	77
4.3 Konsiderata introductive mbi vepritarinë me iniciativën e policisë gjyqësorë.....	80

4.4 Prokurori si ‘dominus’ i hetimeve paraprake: shkurtimisht mbi veprimtarinë me iniciativën e tij.....	89
4.5 Gjyqtari i hetimeve paraprake si organ i pushtetit gjyqsor.....	97
4.6 Roli ‘garantit’ dhe funksioni ‘kontrollues’ i gjyqtarit në hetimet paraprake.....	100
4.7 Përfundimi i hetimeve.....	104
4.8 Disponimet e prokurorit pas përfundimit të hetimeve.....	109
4.8.1 Pushimi i akuzës ose çështjes në procedimet për kundërvajtje penale.....	111
4.8.2 Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes në procedimet për krim.....	115
4.8.3 Revokimi i vendimit të pushimit.....	119
4.8.4 Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq.....	122

Kapitulli V: SEANCA PARAPRAKE SI FAZË E RE E PROCEDIMIT PENAL:

VËSHTRIM KRAHËSUES

5.1 Hyrje.....	125
5.2 Përgatitja për seancën paraprake.....	127
5.3 Hapja e seancës: Verifikimi i paraqitjes së palëve dhe rinovimi i njoftimeve.....	129
5.4 Diskutimi palëve.....	midis 131
5.5 Vendimi që i jep fund seancës paraprake.....	135
5.6 Fashikulli i gjykimit.....	140

5.7 Fashikulli	i
prokurorit.....	142
5.8 Gjyqtari i seancës paraprake në legjislacionin italian (Giudice dell’Udienza Preliminare-GUP). Dallimi ndërmjet tij dhe gjyqtarit të hetimeve paraprake.....	144
5.9 Vendimi për mosvazhdimin e procedimit (Sentenza di non luogo a procedure).....	145
5.10 Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq (decreto che dispone il giudizio).....	148
5.11 Formimi i fashikullit të gjykimit.....	151

KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Konkluzione.....	154
6.2 Rekomandime.....	158
BIBLIOGRAFIA.....	164

LISTA E SHKURTIMEVE

AP- Avokati i Popullit

BE – Bashkimi European

BKH-Byroja Kombëtare e Hetimiti

DUDNJ - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

GJED - Gjykata Europiane e Drejtësisë

GJEDNJ- Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

GJK- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

GJL - Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

GJHP-Gjyqtari i Hetimeve Paraprake

GJKKO- Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

POL.GJYQ- Policia Gjyqësore

GJSP- Gjyqtari i Seancës Paraprake

KE - Këshilli i Europës

KEDNJ- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

KEFDG - Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

KP- Kodi Penal

KPP- Kodi i Procedurës Penale

MD - Ministria e Drejtësisë

SPAK-Struktura e Posaçme Anti Korrupsion

RSH- Republika e Shqipërisë

VKM -Vendim i Këshillit të Ministrave

Kapitulli I

1.1 HYRJE.

Qëllimi i një procedimi penal është të vërtetojë kryerjen e një vepre penale, të përcaktojë mënyren e kryerjes së saj, të gjejë autorin e kësaj vepre si dhe ta vërë atë përpara përgjegjësisë

penale. Sistemi i drejtësisë duhet të jetë eficient në luftimin e kriminalitetit, duke zhvilluar një veprimtari të plotë dhe të saktë në aktivitetin e tij. Në thelb, funksioni mbrojtës i të drejtës penale është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe në kuadrin e këtij funksioni të përgjithshëm e drejta penale, në radhë të parë ka për detyrë që të mbrojë lirinë dhe të drejtat themelore të njeriut, rendin juridik dhe sigurinë e një vendi. E drejta penale bashkëkohore njëhereazi ka për detyrë që pikërisht duke mbrojtur marrëdhëniet shoqërore ekzistuese, të përcjellë gjithashtu progresin dhe dinamizmin e zhvillimit shoqëror si dhe të mundësojë krijimin e institucioneve të reja që do t'i kontribuojnë zhvillimit më të shpejtë dhe përsosjes së sistemit të një vendi¹. Kjo përshtatje duhet të realizohet në radhë të parë jo vetëm sa i takon veprave penale por në veçanti sistemit procedural penal, nëpërmjet rishikimit, modifikimit dhe futjes së dispozitave penale juridike.

Interesi për të trajtuar një temë të tillë lindi si pasojë e problematikave të hasuara në praktikë si dhe nga një dëshirë individuale për të dhënë kontributin tim në debate juridike bashkëkohore lidhur me figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe gjyqtarit në senacën paraprake. Këto figura mungonin krejtësisht në sistemin tonë ligjor ndaj edhe për këtë arsye mendoj se paraqet një risi në trajtimin e kësaj teme në funksion të kërkimit shkencor dhe sidomos për mënyrën se si këto figura janë përfshirë në legjislacionin tonë. Gjithsesi, shpresoj që përmes këtij punimi të kem arritur të evidentoj disa nga problemet më të spikatura dhe të kem sugjeruar trajtimin e duhur juridik të tyre. Po ashtu, procedura penale përcakton edhe format me anë të të cilave duhet të ushtrohen veprimet procedurale në procedurën penale, mënyrën e thirrjes, ngritjen e akuzës, si duhet të zhvillohet seanca paraprake, seanca gjyqësore etj. Një vlerë të vecantë në këtë drejtim bazuar në nenin 277 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së

¹ I.Saliu, “E drejta penale. Pjesa e përgjithshme”, Prishtinë, 2010, 27-28.

Shqiperisë, organet e ngarkuara për hetimet paraprake janë Prokurori dhe Policia Gjyqësore². Prokurori dhe Policia Gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Organi procedues është i detyruar jo vetëm që ta marrë proven por edhe të verifikojë nëse thëniet e personave që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit apo të pandehurve janë të sakta, gjë që është e nevojshme për zbulimin e së vërtetës dhe në formimin e bindjes së tyre. Veprimtaria hetimore e Policisë Gjyqësore dhe e prokurorit përfundohet në kohën kur çmohet se janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe janë grumbulluar të dhënat e nevojshme për të arritur në përfundimin se çfarë do të bëhet me çështjen konkrete. Reformimi i sistemit procedural mendoj se duhet të ndryshojë konceptet, mendesitë dhe praktikatat e vjetra, të formohen koncepte të reja bashkëkohore për vendin dhe rolin e pushtetit gjyqësor, për nevojën e demokratizimit të mëtejshëm të procedimit penal. Prokurori ose Oficeri i Policisë Gjyqësore që ka kryer hetimet e njofton të pandehurin se ato kanë përfunduar me një akt të veçantë dhe i vë në dispozicion atij dhe mbrojtësit të tij të gjitha aktet dhe provat e marra. Kuptohet që kjo e drejtë i takon prokurorit. Para ndryshimeve të bëra me ligjin 35/207, prokurori shqyrtonte aktet dhe çdo gjë që përmban fashikulli i hetimeve, si dhe pretendimet e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij. Kur arrinte në përfundimin se hetimet nuk ishin bërë të plota, ai urdhëronte që ato të vazhdonin, duke treguar edhe se çfarë duhej hetuar. Ne qoftë se oficeri i policisë nuk është i një mendimi me prokurorin që kishte shqyrtuar aktet, mund të ankohej tek drejtuesi i Prokurorisë, i cili vendoste përfundimisht. Kur hetimet konsideroheshin të plota dhe të sakta, prokurori vendoste, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjyq. Ndërsa vendimi i pushimit të çështjes merrej nga drejtuesi i prokurorisë dhe prokuror më i lartë për atë ishte Prokurori i Përgjithshëm. Kjo hallkë e sistemit procedural

² Shfuqizuar pika 3 me ligjin 35/2017 datë 30.03.2017, në pjesën ku përcaktohej kompetenca e Prokurorit të përgjithshëm në juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë.

penal shqiptar është modifikuar dhe është përshtatur me modelet e tjera europiane megjithse jo në përputhje të plotë me to. Duhet të konsolidohet pikërisht figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake me qëllim që organi akuzës mos të marrë më vendime me karakter juridiksional por vetëm të konstatoj duke ja lënë vendimëmarrjen një subjekti të pavarur dhe të paanshëm i cili të vendos në respektim të parimit të kontradiktoritetit. Pra, vendimtar dhe me rëndësi paraqitet shqyrtimi i fashikullit të dosjes së hetimeve paraprake nga një gjyqtar i posaçëm dhe/ose në një seancë gjyqësore të posaçme.

1.2. OBJEKTI I STUDIMIT

Tema në këtë punim shkencor ka të bëjë dhe synon të analizojë rolin dhe rëndësinë e konsolidimit të figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake në procedimin penal si dhe evidentimin e attributeve të gjyqtarit të seancës paraprake. Procedimi penal përfaqëson terësinë e aktiviteteve për konstatimin e fakteve që përbëjnë veprën penale, për përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të akuzuar dhe që dënimi të jetë i mundur të aplikohet. Ai është i ndarë në tre faza tërësisht të dallueshme në qëllimet dhe funksionet e tij: faza e hetimeve paraprake, seanca paraprake dhe faza e gjykimit. Faza e parë ka të bëjë pikërisht me *hetimet paraprake* të kryera nga ana e Prokurorit Publik, të cilat kanë për qëllim të mbledhin të gjitha faktet me qëllim që ky i fundit për një person që presumohet i përfshirë në veprën penale si përgjegjës (person i dyshuar), të vendosë nëse do të procedojë ose jo në ngritjen e akuzës. Faza e dytë e quajtur *senaca paraprake* zhvillohet përpra një gjyqtari, i quajtur gjyqtari i seancës paraprake dhe përbën një ‘filtër’ midis hetimeve paraprake dhe gjykimit dhe ka si funksion që të përcaktojë nëse veprimet

e kryera gjatë hetimeve paraprake janë në përputhje me rregullat e përcaktuara në k.p.p dhe nëse kto veprime janë të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykim. Faza e tretë, që quhet *gjykimi*, i është besuar gjyqtarit, dhe ajo hapet kur informacioni i marrë është konsideruar i mjaftueshëm për të mbështetur akuzën kundër personit të dyshuar që quhet i akuzuari. Ajo ka për qëllim formimin e provave nëpërmjet debatit midis palëve, dhe përfundon me një vendim dënimi ose pafajësie.

Duke patur parasysh natyrën specifike të procedimit penal dhe në mënyrë të vecantë atë të hetimeve paraprake del si nevojë që ligjshmëria e gjithë fazës së hetimeve paraprake të kontrollohet dhe garantohet , pikërisht nga gjyqtari i hetimeve paraprake. Duke patur gjithmonë parasysh edhe zhvillimin e shoqërisë në nivel global, por mbi të gjitha edhe përshtatjen me rregullat dhe standardet ndërkombetare, përshtatja me këto të fundit kërkon pa dyshim nevoja për ndryshime që duhet të realizohen në legjislacionin shqiptar.

Objektivat e studimit mund të përmbliidhen në mënyrë konkrete si më poshtë:

- 1.2 Studim i historikut të lindjes dhe evoluimit të figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe gjyqtarit të seancës paraprake.
- 2.2 Analizë e standardeve ndërkombëtare dhe europiane lidhur me legjislacionin dhe praktikatat më të mira në këtë fushë.
- 3.2 Analizë e legjislacionit të dy vendeve të marra në analizë të cilat e kanë figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake: Italia dhe Kosova. Fokusi është në nivel vështrimi krahasues.
- 4.2 Studim hipotetik i rolit, rëndësisë dhe funksionit të gjyqtarit të hetimeve paraprake. Studim i kompetencave specifike.

1.3 QËLLIMI DHË RËNDËSIA E PUNIMIT

Qëllimi i studimit të kësaj teme është pikërisht brishtësia në legjislacionin tonë të kësaj figure, që e konsiderojmë tepër të rëndësishme në fazën e hetimeve paraprake, sidomos duke marrë për bazë standardet ndërkombëtare si dhe modelet e vendeve të tjera. Një fokus i veçantë në studim do të jetë legjislacioni ndërkombëtar, në mënyrë specifike ai që ka të bëjë me gjyqtarin e seancës paraprake si dhe legjislacioni i dy vendeve të marra në analize të cilat e kanë figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake: Italia dhe Kosova. Arsyet e përzgjedhjes kanë të bëjnë pikërisht me Italinë sepse është një vend i cili e aplikon në mënyrë të suksesshme këtë pjesë procedurale penale (gjyqtari i hetimeve paraprake dhe gjyqtari i seancës paraprake) dhe me Kosovën e cila si vend specifik ka marrë nga sistemi italian pikërisht këtë pjesë të rëndësishme të procedurës dhe është në fazën e parë (vitet e para) të implementimit dhe të funksionimit.

Trajtimi i kësaj përbën sidomos në ditët e sotme një ndër sfidat më të mëdha të teorisë dhe praktikës, jo vetëm të natyrës metodologjike, të shtrimit së problemeve të kësaj fushe por dhe posaçërisht në nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve të rëndësishme dhe të qëndrueshme për të reformuar këtë pjesë të procedimit penal në përputhje me nevojat për zhvillim dhe demokraci reale. Synimi i mëtejshëm është pa dyshim qëllimi për t'i avancuar studimet me qëllim që ato të jenë shtysë për zgjidhjen e problemeve që lidhen me rolin dhe sidomos me funksionet kryesore që do i atribuohen në të ardhmen gjyqtarit të hetimeve paraprake.

Qëllimi gjithashtu fokusohet edhe në debatin juridik në fushë lidhur me legjislacionin shqiptar si dhe nevoja për konsolidimin e figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe gjyqtarit të seancës

paraprake në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, duke dashur që analiza të mos jetë krejtësisht sipërfaqësore dhe për të shpjeguar thelbin e çështjes, por të analizojë deri në detaje edhe funksionet dhe kompetencat e kësaj figure të re institucionale.

Sa i takon rëndësisë jam përpjekur të sjell në këtë temë thelbin e motivimit dhe të ngritjes së problematikës pasi mendoj se është tejet e rëndësishme konsolidimi kësaj figure për përmiresimin e legjislacionit tonë procedural penal si dhe në funksion të përshtatjes me standardet ndërkombetare dhe europiane.

1.4. METODOLOGJIA DHE METODAT E KËRKIMIT

Me rëndësi të veçantë paraqitet në një punim doktoral edhe metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor. Metodologjia e studimit në fjalë është hartuar nëpërmjet metodave të ndryshme me qëllim vërtetimin e hipotezave kërkimore të ngritura. Gjatë hartimit të këtij punimi kam aplikuar metodat e hulumtimeve në fushën juridike duke zbatuar në menyre konkrete metodën cilësore dhe atë sasiore. Metodologjia e studimit që kam prezantuar është pikërisht një ndërthurje e dy metodave të sipërpërmendura. Pra, *Metodologjia e punës kërkimore* është bazuar në përdorimin e metodave cilësore dhe sasiore, në funksion të temës dhe strukturës së parashtruar të punimit. Në veçanti jam munduar që hulumtimin ta ilustroj edhe me paraqitje empirike duke hartuar disa pyetesorëte cilet i kam bashkangjitur në forme ilustrative në fund të disertacionit. Gjatë hartimit të punimit kam shfrytëzuar literaturën ndërkombëtare dhe kombëtare që i referohet zhvillimit të figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake. Për efekt të qëllimeve të temës, metodat që spikasin janë *metoda historike, analitike, krahasimore* me qëllim të evidentimit të situatës aktuale dhe dhënies së rekomandimeve. Përdorimi i kësaj metodologjie ka

qenë në funksion të hipotezave të ngritura dhe pyetjeve kërkimore, duke më ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve të duhura për temën dhe sidomos për rekomandimet e propozuara. Pra, metodat e përdorura i përshtaten arritjes së qëllimeve të këtij punimi doktoral dhe metodat e hulumtimit shkencor të përdorura në këtë rast janë shfrytëzuar në varësi të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura në këtë punim doktoral. Për përgatitjen e këtij punimi është dashur një punë e gjatë, pasi materialet studimore për këtë temë nuk janë të shumta përsa i përket legjislacionit dhe akteve ndërkombëtare dhe botimeve e materialeve të autorëve të ndryshëm në lidhje me temën e më pas në trajtimin e jurisprudencës dhe praktikave të njohura të huaja e vendase.

Rishikimi i literaurës është me rëndësi për efekte studimi pasi figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake, si objekt studimi thuhet nuk është trajtuar më parë nga studiuesit shqiptarë. Për këtë arsye kam sjellë mendimet dhe debatet bashkëkohore të huaja, sidomos ato italiane me vështrim krahasues. Po ashtu në këtë drejtim kam sjellë edhe debatet bashkëkohore juridike lidhur me avancimin e mëtejshëm të studimeve procedurale penale me qëllim analizën e detajuar për rolin dhe rëndësinë e konsolidimit të figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin tonë.

Metoda historike është e një rëndësie të veçantë në punim pasi ajo përmbledh në mënyrë të përgjithshme historikun e lindjes dhe evoluimit të figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake në rendet e huaja ligjore, ato të sanksionuara në aktet ndërkombëtare, dhe në vendet europiane.

Metoda analitike po ashtu ka një rëndësi të veçantë pasi në këtë punim pasi analizohen në mënyrë të detajuar doktrina lidhur me elementët më thelbësore të hetimeve paraprake, roli i policisë gjyqësore dhe roli i prokurorit në momentin e përcaktimit të ngritjes së akuzës ose jo.

Eshtë analizuar legjislacioni ndërkombëtar, (në vecanti Konventa e Palermos) europian (legjislacioni i disa vendeve të Bashkimit Europian, duke e fokusuar analizën në mënyrë të veçantë në dallimin e sitemit inkuizitor nga ai akuzator) dhe kombëtar në funksion të analizës së detjuar të procedurës së përfundimit të hetimeve paraprake me qëllim konsolidimin e figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake. Po ashtu analizohen në mënyrë të detajuar roli, funksionet dhe kompetencat specifike që ky organ duhet të ketë.

Në kuadër të integritit europian dhe të përqaşjes së legjislacionit dhe praktikës sonë me standardet europiane, analiza e gjerë e legjislacionit të sipërpërmendur si dhe e praktikës gjyqësore, më ka ndihmuar në trajtimin dhe analizën e bërë për të konkluduar me rekomandimet përkatëse lidhur me rëndësinë e futjes së figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake.

Metoda krahasimore ka gjithashtu një rëndësi të veçantë pasi në këtë punim janë trajtuar elementet thelbësore të rolit dhe rëndësisë së gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe senacës paraprake edhe në nivel krahasimor, sidomos me vendet europiane dhe në veçanti me dy vende: Italia dhe Kosova. Qëllimi i metodës krahasimore është evidentimi i modelit më të mirë të kësaj figure me qëllim përcaktimin e saktë të rolit, funksionit dhe kompetencave specifike. Pra, qëllimi i këtij punimi është gjithashtu të analizojë në vështrim krahasimor në mënyrë që të evidentohen zgjidhjet më efektive në raport me vetë çështjet e trajtuara dhe të jepen rekomandimet përkatëse për vendin tonë.

Analiza sasimore është e ndërtuar mbi bazën e pyetësorëve të hartuara për këtë studim. Nëpërmjet pyetësorëve janë hartuar disa pyetje specifike lidhur në radhë të parë me qenien dakord ose jo për konsolidimin në parim të kësaj figure të re institucionale në kuadër të procedimit penal, si dhe në elemente specifike. Pyetësorë janë shpërndarë në radhët e prokurorëve, gjyqtarëve dhe e skipterë të së drejtës penale dhe proceduriale penale. Në përfundim

të këtij procesi janë mbledhur dhe përpunuar të dhënat e dala nga metoda në fjalë. Përfundimet e të dhënave empirike më kanë shërbyer për të dhënë disa konkluzione dhe mbi të gjitha disa rekomandime.

1.5. PYETJET KËRKIMORE DHE HIPOTEZAT

Në lidhje me temën dhe fokusin dhe qëllimin e saj, pyetjet kërkimore dhe hipoteza kanë rëndësi esenciale për të realizuar një punim cilësor doktoral, duke qenë shtyllat bazë për garantimin e suksesit të punimit dhe orientimit të gjithë procesit të studimit dhe të punës.

1.5.1. Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore të ngritura në këtë punim doktoral janë:

- 1.2 Pse lindi nevoja e figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake?
- 2.2 A ka dispozita në kodin tonë që i atribuojnë prokurorit njëkohësisht edhe rolin e gjyqtarit si në proceset inkuizitore?
- 3.2 Cilat janë vendet të cilat e kanë adoptuar këtë model institucional?
- 4.2 Cilat janë aktet juridike që e parashikojnë institucionin e gjyqtarit të hetimeve paraprake?
- 5.2 A është e nevojshme konsolidimi i këtij institucioni edhe në vendin tonë? Cili është qëllimi dhe roli që ai luan?
- 6.2 Cilat janë kompetencat e këtij organi gjyqësor?
- 7.2 Cilat janë kompetencat e gjyqtarit të hetimeve paraprake në Itali? Po në Kosovë?
- 8.2 A janë përcaktuar qartë kompetencat e gjyqtarit të senacës paraprake?

1.5.2. Hipotezat e studimit

Hipotezat e ngritura në këtë punim dhe që kërkoj që të vërtetohen janë:

Hipoteza e parë kryesore: Paraqitet më se e domosdoshme konsolidimi dhe specifikimi i pozicionit të gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin procedural penal shqiptar.

Hipoteza e dytë (nënhipotezë): Gjyqtari i hetimeve paraprake në legjislacionin italian është një figurë e konsoliduar dhe ka funksionuar më së miri ndaj dhe për këtë arsye nuk mjafton thjesht implementimi i kësaj figure në vendin tonë por është e qënësishme edhe përcaktimi sa më i i detajuar i kompetencave dhe funksioneve të tijë.

Hipoteza e tretë (nënhipotezë): Gjyqtari i hetimeve paraprake do të luajë një rol të rëndësishëm në sistemin procedural penal shqiptar në fazën e hetimit paraprak, dhe në përfundim të hetimeve dhe do ti heq mundësinë prokurorit të marrë vendime me karakter juridiksional.

Hipoteza e katërt: (nënhipotezë): Gjyqtari i hetimeve paraprake do të ketë një funksion kontrollues dhe garantues të pavarur dhe të paanshëm mbi masat që prekin të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë . Ai nuk do të ushtrojë pushtetin e iniciativës; funksioni i tij është karakterizuar si një "juridiksion gjysmë i plotë" për shkak se ka dy kufizime themelore:

1. Funksioni do të ushtrohet vetëm në rastet e parashikuara nga ligji dhe në dispozitat e veçanta të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë si psh.. konvalidimin e arrestimit dhe paraburgimit, nxjerrja e masave paraprake dhe autorizimin për përgjimet.
2. Gjyqtari nuk ka një

njohuri të plotë të dosjes siç ndodh në gjykatë, por ai duhet të vendosë vetëm në bazë të provave të paraqitura nga palët e mundshme (Oficer i Policisë gjyqësore, Prokurori, i dyshuari).

1.6. KUFIZIMET E PUNIMIT

Për sa i përket kufizimeve, ato lidhen si me përcaktimin e objektit të analizës, si me vështirësitë e ndeshura gjatë grumbullimit të të dhënave dhe burimeve. Lidhur me të parin, zgjedhja për ta kufizuar analizën e studimit tim është për arsye se çështja e përcaktimit të kompetencave të figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe përcaktimit të rolit, dhe rendësisë së tij konsiderohet një risi dhe thuajse nuk është trajtuar më parë. Kufizimet e punimit kanë të bëjnë konkretisht me këtë institucion i cili studiohet në vende të tjera dhe në rinde të tjera juridike. Për këtë arsye edhe përzgjedhja e literaturës së shfrytëzuar në studim ka qenë e kufizuar: në mënyrë të veçantë në burimet dytësore është shfrytëzuar më së shumti doktrina dhe jurisprudenca italiane.

Përveç kufizimeve nga pikëpamja e shtrirjes së studimit, punimi kufizohet edhe në aspektin historik pasi nuk ka një historik të mirfilltë të institucionit të gjyqtarit të hetimeve paraprake në vendin tonë. Për këtë arsye, qasja historike do të jetë e kufizuar në funksion të argumentimit të zgjidhjeve aktuale, dhe në fokus të punimit do të jetë analiza e kuadrit normativ aktualisht në fuqi në Itali dhe Kosovësi dhe zgjidhjet respektive jurisprudenciale dhe doktrinale në këtë fushë. Një ndër kufizimet e tjera kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit dhe përpunimin e të dhënave të dala nga pyetëtori. Shumë prej ekspertëve të fushës nuk i janë përgjigjur në kohë

pyetjeve të hartuara në pyetësor. Për pasojë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave (studimi empirik) është bazuar vetëm mbi bazën e informacioneve të grumbulluara.

1.7. PËRMBLEDHJA DHE STRUKTURA E PUNIMIT

Ky studim analizon në mënyrë të detajuar çështjen e gjyqtarit të hetimeve paraprake si një figurë e re dhe e pakonsoliduar në sistemin procedural penal në Shqipëri. Ai shtrihet në analizën e legjislacionit përkatës por edhe të praktikës gjyqësore më bashkëkohore në këtë fushë. Studimi është ndërtuar mbi bazën e gjashtëkapitujve. Në *kreun e parë* kemi trajtuar hyrjen, rëndësinë dhe objektin e studimit, si dhe pyetjet kërkimore tënëgritura për studim së bashku me katër hipotezat. Po ashtu janë pjesë e këtij kapitulli kufizimet e studimit, përmbajtja dhe struktura.

Kreu i dytë i dedikohet sistemeve procedurale penale si dhe garancive Kushtetuese të personit nën hetim apo të pandehurit në procesin penal. Në këtë kapitull pasi përcaktohen dallimet midis sistemeve të ndryshme procedurale penale, evidentohen të drejtat e të pandehurit të përcaktuar në Kushtetutë, në KEDNJ në DUDNJ si dhe të drejtat e të pandehuriti apo personit nën hetim në legjislacionine Bashkimit European duke vënë theksin te parimi i kontradiktoritetit si rregulli bazë për zhvillimin e procesit penal.

Kreu i tretë trajton figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake duke ju referuar legjislacioni italian por edhe atij kosovar. Rëndësia e fazës së hetimeve paraprake dhe rolit të organit gjyqësor në

këtë fazë. Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake në vende të ndryshme. Një vështrim i shkurtër.

Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin italian. Nga gjyqtari hetues (giudice istruttore) në gjyqtarin e hetimeve paraprake (Giudice delle indagini preliminari).

Roli dhe rëndësia e tij në sistemin procedural penal italian, kompetencat dhe funksionet e tij si dhe ndërhyrjet e Gjykatës Kushtetuese në përcaktimin e tyre.

Kreu i katërt përfshin legjislacionin procedural penal shqiptar në lidhje me rolin e gjykatës në fazën e hetimeve paraprake. Fillimisht do të përcaktohen ndryshimet e qënësishme në kodin e procedurës penale si pasojë e ligjit 35/2017 e më pas do të përcaktohet roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake duke evidentuar kompetencat dhe funksionin e tij në këtë fazë duke evidentuar vakumet ligjore dhe nevojën e plotësimit të tyre në mënyrë që të qartësohet përmbajtja e këtij institucioni të ri procedural penal. Do të analizohen subjektet e ngarkuar me hetimet paraprake dhe kompetencat e tyre pas ndryshimeve të raportuara me ligjin 35/2017.

Kreu i pestë do i dedikohet seancës paraprake si fazë e re e procesit penal. Do të evidentohen dispozitat me karakter inkuizitor në brendinë e procesit me karakterë të theksuar akuzator si dhe do të përcaktohen rastet kur duhet të iniciohet seanca paraprake si dhe rastet kur seanca paraprake nuk është e nevojshme. Në fund të këtij kapitulli do të evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet me gjyqtarin e seancës paraprake në legjislacionin italian.

Kreu i gjashtë dhe i fundit përfshin një përmbledhje me gjetje, konkluzione dhe rekomandime në kuadër të studimit të bërë.

1.8 RISHIKIMI I LITERATURËS.

E drejta procedurale penale përfshin tërësinë e normave që rregullojnë veprimtarinë e subjekteve të procedimit penal. Ai ka pësuar ndryshime në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike dhe ideologjike në shoqëri të ndryshme, pra në shtete të ndryshme. Në këto norma procedurale përcaktohet organizimi dhe kompetencat e gjykatave, detyrat dhe kompetencat e prokurorit, të drejtat e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij, të viktimës së veprës penale, të paditësit dhe të paditurit civil si dhe të drejtat e të dënuarit. E drejta procedurale penale është rendi i vendosur me ligj që rregullon pikërisht veprimtarinë e organeve të procedimit, raportet midis tyre dhe ato me të pandehurin dhe të dëmtuarin, rend ky që mbështetet mbi parimet demokratike dhe siguron realizimin e drejtësisë.

Në të drejtën procedurale penale harmonizohen me njëra-tjetrën raportet procedurale, forma procedurale dhe garancitë procedurale. Sipas autorëve **Halim Islami, Artan Hoxha dhe IlirPanda** në veprën *Procedura Penale*, botim i vitit 2014, e drejta procedurale penale përcakton raportet midis subjekteve të procedimit penal, duke treguar të drejtat dhe detyrat që kanë ato ndaj njëra-tjetrës në të gjitha fazat e procedimit. Së drejtës se prokurorit për të kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq i pergjigjet detyrimi i tij për të njohur të pandehurin me të gjitha aktet e fashikullit të prokurorit si dhe e drejta e të pandehurit për të kërkuar plotësimin e hetimeve.

Veprimet procedurale krijojnë raporte të caktuara procedurale dhe këto të fundit sjellin veprime të reja procedurale. Kështu psh, veprimi procedural i marrjes së një personi të pandehur

krijon raporte të caktuara midis tij dhe prokurorit të policisë gjyqësore. Këto raporte nga ana e tyre krijojnë të drejta dhe detyra si për prokurorin ashtu edhe për të pandehurin. Për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore për sqarimin e çështjes.

Ndërsa, me formë procedurale kuptohen rregullat e caktuar me ligj që parashikojnë kushtet për kryerjen e veprimeve procedurale, lidhjen dhe radhën e tyre. Respektimi i tyre siguron zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e subjekteve të procedimit penal dhe zbulimin e së vërtetës. Në të kundërt mosrespektimi i tyre përben shkelje me pasoja të dëmshme.

Ndërsa garancitë procedurale janë ato mjete, të parashikuara me ligj të cilat ndihmojnë të pandehurin dhe të dëmtuarin që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, si dhe detyrojnë organet e procedimit që t'i respektojnë rigorozisht ato.

Nga ana tjetër *Ismet Salihu*, në veprën e tij “*E drejta Penale 2010*“, mbron tezën se Shqipëria ka një legjislacion procedural penal bashkëkohor, të pajtueshëm me standardet demokratike ndërkombëtare, të harmonizuar me sistemet e modelet e shteteve perëndimore dhe të bazuar në traditat e veçoritë historike, politike e legjislative të vendit. Njëkohësisht, Kodi i Procedurës Penale ka më shumë karakteristikat e një sistemi procedural të një natyre mbizotëruese akuzatore, duke pasur parasysh barazinë në thelb të palëve në proces (prokuror dhe i pandehur), si dhe pozicionin e te tretit që mban gjykatesi, i cili ka të drejta vendimarrëse mbi palët.

Po ashtu, mbi bazën e provave realizohet dhe zhvillimi i hetimeve, caktimit të pistave ku do procedohet, që fillimisht ngrihen mbi dyshimin e arsyeshëm të bazuar në keto prova. Pra, organi procedues dhe subjektet interesat e të cilëve preken angazhohen në arritjen e qëllimit të përbashkët, që është vërtetimi i fakteve. Megjithatë, që të vendoset një sanksion penal i parashikuar në ligj është e nevojshme që në procesin penal gjyqësor të shqyrtohen dhe të

vërtetohet ekzistenca e atyre kushteve që vetë e drejta i parashikon për dhënien e këtij sanksioni penal. Organi procedues pas evidentimit të kryerjes së një vepre penale haset drejtpërdrejt me pasojat dhe rezultatin që kjo veper ka sjellë. Duke u bazuar fillimisht mbi këto rezultate fitohen të dhënat e para lidhur me shkaqet e kryerjes së vepres penale.

Vërtetimi i drejtë i fakteve është një objektiv i domosdoshëm, i rëndësishëm i organeve të dhënies së drejtësisë. Ky vërtetim zhvillohet në sajë të analizimit dhe shqyrtimit të provave nga gjykata e cila vlerëson rast pas rasti fuqinë e tyre provuese dhe në bazë të tyre jep vendimin final, caktimin e fajësisë apo të pafajësisë dhe zbardhjen e drejtë dhe të saktë të çdo çështjeje konkrete.

Dënimi i personit të akuzuar nuk duhet të kthehet në qëllim në vetvete por qëllim duhet të jetë përpjekja për të provuar të vërtetën në gjykim, e vërtetë që tenton ti afrohet të vërtetës objektive. Qëllim i procedimit penal e sigurisht edhe i procesit të të provuarit është zbulimi i së vërtetës. Vlen të shtrojmë për diskutim këtu edhe çështjen e sistemeve procedurale: njihen dy lloje sitemesh procedurale, inkuizitor dhe akuzator. Në fakt, ka studiues që mendojnë se ekziston edhe nje sistem i tretë, ai i përzier. Karakteristikat që përcaktojnë njërin apo tjetrin sistem vërtitetn gjithnjë mbi vlerësimin më të madh ose më të vogël që i bëhet rolit të njërit prej protagonistëve, që përbejnë treshen procesuale: gjykatës, prokuror, i pandehur.

Nga epoka e Perandorisë Romake, në proceset kanonike dhe gjithashtu në regjimet autoritare procesi penal kishte një karakter inkuizitor, si i tillë, ai kishte si qëllim të vetëm shtypjen e krimeve, duke mbizotëruar interesi i Shtetit mbi të drejtat individuale. Metoda procedurale që ky sistem përdorte i mohonte të akuzuarit një mbrojtje dhe e nënshtrohte atë në një procedurë sekrete të iniciuar nga një gjyqtar i pjesshëm i cili gjithashtu ndërhynte në privilegjet e organit të akuzës, ose gjykatësi dhe akuzuesi ishin i njëjti person. Karakteristikat e këtij sistemi ishin prezumimi i fajësisë, detyrimi i të akuzuarit për të demonstruar mospërfshirjen

e tij në faktin që i ishte atribuar dhe pikërisht bashkimi i akuzuesit dhe gjykatësit në të njëjtin person.

Për shtetet demokratike, personi ishte i mbrojtur nga garancitë kushtetuese dhe procedimet penale evoluojnë drejt konceptimit që nuk mund të jetë më gjyqtari që heton të akuzuarin, por mbajtësi i pushtetit të ndjekjes penale, prokurori. Sistemi procedural mbizotërues në shtetet demokratike është ai akuzator i cili kërkon që akuzuesi, i ndryshëm nga gjyqtari, të veprojë në të njëjtat kushte me të akuzuarin në kërkimin e provave që do të ofrohen për vlerësimin e gjyqtarit, që thirret si subjekt pa kompetenca hetimore, të vendosë në bazë të të dhënave provuese të marra me iniciativën e palëve, prezumimin e pafajësisë së personit të akuzuar, deri në vendimin e përvokueshëm të dënimit, mbrojtjen e të drejtës së lirisë së personit të akuzuar në pritje të një vlerësimi, vërtetimi- i menjëhershëm i kuptuar si kontakt të drejtpërdrejtë të gjyqtarit me burimin e provave dhe publicitetin e procedurës, që nuk karakterizohet ose ndërthuret me veprimtari sekrete, për të lejuar kontrollin e shoqërisë.³

Ndërsa sipas autorit **Shefqet Muçi**, në *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, botimi vitit 2012 ekzistenca e legjislacionit të plotë penal është njëra anë e zbatimit të ligjshmërisë, e konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe e parandalimit të kriminalitetit, ndërsa, ana tjetër, po aq e rëndësishme është zbatimi me rigozitetin e tij, gjë që në shtetin dhe shoqërinë shqiptare paraqitet me boshllëqe dhe mangësi të dukshme.

Sipas autorit **Dhimitër Lara**, në veprën e tij *Koment mbi procedurën penale*, botim i vitit 2019 Legjislacioni ynë në mënyrë të shprehur nuk ka marrë përsipër të evidentojë antinomitë apo vakumet ligjore eventuale apo rregullimin e rasteve të ndryshme dhe zgjidhjen e tyre, cështje të kuptohet se legjislacioni ynë nuk njih as kundërshtitë apo antinomi dhe as boshllëk apo zbrastje

³ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010.

ligjore. Sipas autorit **Enrico Dotti** në *Filosofia e së drejtës*, botim i vitit 2013, një system ligjor është koherent nëse nuk paraqet antinomi [...] dhe ai- paraqet një antinomi nëse përmban dy norma të papajtueshme, dmth dy norma që disiplinojnë në mënyrë të kundërt një rast. [...].

I njëti autor po ashtu shkruan se “një sistem ligjor është i plotë nëse nuk paraqet boshllëqe. Një sistem ligjor paraqet një boshllëk nëse nuk përmban asnjë normë që disiplinon një rast të caktuar”. Për të njëjtën çështje **Hans Kelsen** në veprën e tij “*Limeamenti di dottrina pura e di diritto*” shkruan se “intepretimit i atribuohet një funksion i veçant ai i mbushjes së boshllëqeve”. Ai përcaktonte individët mund të bëjnë çdo gjë që nuk është e ndaluar nga ligji ndërsa personat që veprojnë në emër të shtetit mund të veprojnë vetëm në rastet kur janë të autorizuar nga ligji dhe është e kotë të ndalosh me ligj veprimin e një personi që ushtron funksione publike, mjafton mos ta autorizosh. Ndalimi me ligj i vepritarisë së personave që ushtrojnë funksione publike, shkruante Kelesen, mund të ndodh vetëm në ato raste kur duhet të zhfuqizohet një autorizim i mëparshëm.⁴

Konkretisht, procedimi penal është ajo procedurë e veçantë që fillon që nga marrja e njoftimit për kryerjen e një vepre penale, duke kaluar nëpërmjet konstatimit se vepra penale, në fakt, është kryer dhe vazhdon me nevojën për të shmangur rreziqet, përsëritjen apo nxjerrjen e efekteve të rrezikshme apo dëmtimin dhe përfundon me objektivin që është identifikimi dhe, nëse po, dënimi i autorëve të saj. Dhe, procedura penale, që ka për qëllim kryerjen dhe kapërcimin e njëpasnjëshëm të këtyre fazave karakterizohet nga hulumtimi, nga zhvillimi dhe përdorimi i platformës së provave, në kuptimin që ajo është nëpërmjet marrjes dhe vlerësimit të provave që arrihet në përfundimin e bazimit të ngritjes së akuzës ose arkivimit të çështjes.

⁴ Përkthyer nga Renato Treves. Giulio Einaudi editore. Torino 2000

Faza e hetimit paraprak është institucionalisht dhe rrënjesisht e lidhur me kërkimin e provave, pra përmbushja e këtyre aktiviteteve procedurale (inspektimeve, kontrollet dhe sekuestrimet e provave, përgjimet) dhe marrja e provave, përkatësisht e objekteve, gjurmët, të dhënat, deklaratat, qoftë futur ritualisht në këtë proces, do të ndihmojnë shumë që të formojnë të gjithë materialet për njohjen nga ana e tyre e gjyqtarit.

Autoria **Marzia Ferraioli**, në veprën e saj *Manuale di diritto processuale penale* shprehet se cdo kod i procedurës penale reflekton vlerësimin që sistemi politik i bën raporteve midis ‘autoriteteve’ dhe ‘lirive’ duke mbartur për këtë arsye një përmbajtje që i përgjigjet ngushtësisht velrave që në ato momente ndien. Në një sistem politik që karakterizohet nga një gjurmë e fortë autoritare nuk merakosen aspak për të drejtat minimale të njeriut: bindja për përparësinë e interesit për shtypjen e krimin - e arritshme edhe duke rrezikuar që të sakrifikohen të drejtat atij që inënështrohet procesit - shuan cdo vëmendje për këtë temë delikate. Në një sistem që inspirohet anasjelltas mbi parimet e demokracisë, objektivi i rikonfirmimit të rendit juridik i shkelur nga mosbindja përkundërjet një norme penale arrihet pikërisht duke respektuar garancitë e personit që i nënështrohet procesit penal.

P.Tonini në veprën e tij “*Manuale di procedura penale*” Tredicesima edizione, Giufre Editore-Milano, 2012 shprehet se: Duke normuar në mënyrë taksative përmbajtjen, kërkeses për dërgimin e çështjes në gjykim tregohet qartë se kërkesa nuk duhet të jetë e arsyetuar; qëllimi i ligjvënësive është të mos i ngarkoj punë prokurorit dhe në të njëjtën kohë të shmang cdo kushtëzim të gjyqtarit e senacës paraprake.

Kapitulli II: SISTEMI PROCEDURAL PENAL DHE VLERAT KUSHTETUESE

2.1 Vështrim historik mbi lindjen dhe evolimin e figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake.

Në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore kanë ekzistuar rrugë dhe mënyra të ndryshme të zhvillimit të procesit të të provuarit dhe konkretisht gjetjes së të vërtetës në procedimin penal. Prosesi i të provuarit është i hershëm. Në *Athinën e Lashtë*, procesi i të provuarit si pjesë e procesit penal zhvillohej përpara trupit gjykues "*Jeliese*"⁵, i përbërë nga gjyqtarë të zgjedhur nga rradhët e qytetarëve. Shqyrtimi bëhej vetëm nga ky trup gjykues. Si pjesë tjetër e drejtësisë ishte edhe Këshilli i Aeropagut. Për pjesën më të madhe të veprave penale si paditës paraqitej i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij ligjor, ndërsa për krimet kundër shtetit mund të ngrihej padia nga çdo qytetar. Arkondi ishte personi i cili merrte padinë, bënte disa përgatitje, caktonte shqyrtimin gjyqësor dhe i'a dorëzonte çështjen gjykatës.

Trupi gjykues zhvillonte procesin e gjykimit ku shprehej dhe vetë procesi i të provuarit. Paditësi drejtonte akuzën duke i paraqitur gjykatës dëshmitarë dhe dokumenta. Më pas i pandehuri ose mbrojtësi i tij prezantonin dëshmitarët të cilët merreshin në pyetje. Pas kësaj procedure të provave të sërëvirur nga palët, gjyqtarët vendosin për fajësinë/pafajësinë e të pandehurit.

Në *Romën Antike*, rrjedha e procesit penal e në veçanti e procesit të të provuarit ka qenë e ndryshme në periudha të ndryshme. Në kohën e vjetër pushteti gjyqësor përqëndrohej në duart e prijësit ushtarak, por zhvillimi i procedimit të procesit të të provuarit zhvillohej nga magjistrati i

⁵A.Anastasi, "*Historia e Institucioneve*", fq. 72-73, Tirane 2004.

posaçëm. Pra, procesi i të provuarit dhe caktimi i fajësisë varehin nga provat dhe hetimi i prokurorit.

Në periudhën e Republikës procesi penal zhvillohej nga Kuestia, një gjyq i përbërë nga pretorët, persona para të cilëve paraqitej kërkesa për procedim. Bara e provës i takonte paditësit. Paditësi paraqiste dëshmitarët, të cilët vetë i merrte në pyetje si dhe dokumente përkatëse. Gjithashtu, mund të përdorej si provë edhe pohimi i të pandehurit, i cili merrej si i saktë pa u verifikuar, pasi supozohej se nëqoftëse i pandehuri pranonte fajin, kryerjen e veprës penale, çështja konsiderohej si e zbardhur.

Në periudhën e Perandorisë Romake, pushteti gjyqësor përqëndrohej në duart e Perandorit. E veçantë në procedurën penale të epokës perandorake është angazhimi i gjykatës në marrjen e provave, nëpërmjet pyetjes së të pandehurit dhe dëshmitarëve.

Në të *Drejtën Zakonore Shqiptare*, procesin penal e gjejmë të shfaqur në kanune si ai i Lekë Dukagjinit, i Maleve, i Skënderbeut dhe i Labërisë. Funkcionet gjyqësore kryheshin nga gjyqet e pleqve, por në raste të veçanta edhe nga krerët apo nga kuvendi. Në lidhje me mbledhjen e provave ndihmonte edhe fshati, në rastet e krimeve të pazbuluara. Hetime për fajësinë e të akuzuarit bënin edhe pjesëtarët e “*Porotes*”⁶ ose garantet për t’u siguruar për ndershmërinë dhe sinqeritetin e të akuzuarit. Në këtë rast nuk kërkoheshin prova të tjera.

Figura e “Kapucarit” si hetues i caktuar nga palët i njohur në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe si “kepuçëgrisuri” në Kanunin e Labërisë grumbullonte provat dhe i parashtronte ato në gjyqin e pleqve. Pleqtë merrnin pjesë aktivisht në procedimin, administrimin e provave, duke

⁶Ismet Elezi, “*Normat e së drejtës penale zakonore të mbledhura nga kanuni i Lekë Dukagjinit dhe kanune të vendeve të veçanta*”, fq. 10-11, Tiranë 1965.

pyetur si palët ashtu dhe dëshmitarët apo pjesëmarrësit e tjerë në proces. Pra, në bazë të provave të grumbulluara caktohej dhe vendimi i gjyqit të pleqve.

Pas pushtimit turk u vendos sistemi gjyqësor i sheriatit. Gjykatat e Kadiut zhvillnin procesin penal i cili fillonte me kërkesën e të dëmtuarit. Barra e provës i takonte paditësit i cili me padinë gojore që paraqet para gjyqtarit duhet të paraqesë edhe provat, por mund t'i takonte edhe të pandehurit, sidomos kur ai mohonte kryerjen e veprës penale. Si prova dhe mjete të provave në procedurë njiheshin: *pohimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, mendimi i ekspertit, kapucarit, ndjekja e gjurmëve, njohja e sendit, garantet, fjala e nderit, flagranca*. Gjithashtu, në procesin e të provuarit njiheshin dhe mjete të tilla të provës si: *beja, apo bartja e gurit në krah*. Beja lejohej kur nuk kishte prova ose për të rrëzuar një prezumim në dobi të palës tjetër. Kur i akuzuari e pohonte fajin, nuk merreshin prova të tjera. Beja bëhej në xhami ose në ndonjë vend të *shenjtë*⁷ dhe zbatohesh vetëm për të akuzuarit për vjedhje.

Për shkak të kushteve të veçanta të krijimit të shtetit shqiptar dhe të pushtimeve të njëpasnjëshme, legjislacioni procedural penal dhe sidomos ai që përcakton organet e hetimit dhe rregullat procedurale për fazën hetimore, ka pësuar ndryshime të shpeshta, shumë herë të kundërta me njëra-tjetrën.

Kodi i Procedurës Penale i vitit 1995 vendosi rregulla të përputhura, e standardet ndërkombëtare për hetimet paraprake. U njoh roli i Prokurorisë si organ i ndjekjes penale dhe u krijua Policia Gjyqësore, që deri atëherë nuk njihej as si emër.

Kjo situatë e re u përballua me shumë vështirësi. Duheshin ndryshuar rrënjësisht praktikat e ndjekura për një kohë të gjatë dhe konceptet e krijuara mbi bazën e tyre. Duhej hequr dorë nga fetishizmi i pohimit të të pandehurit, kur ai nuk është i shoqëruar me prova të tjera. Për rrjedhojë, duheshin zgjatuar hetimet me arsyetimin se do të arrihet në marrjen e pohimit nga i pandehuri. Po

⁷Halim Islami, “Demokratizimi i Legjislacionit Penal”, fq. 8-9, Tirane 2000.

kështu, duhej futur një mendësi e re për vlerën e provave materiale dhe kujdesi në marrjen e daklarimeve nga personat që kanë djeni për faktin ,që ato të jenë të plota dhe të sakta, sepse përndryshe e humbasin vlerën në debatin gjyqësor.

Nuk ka qenë e lehtë për të ardhur këtu ku jemi. U deshën shumë përpjekje për të krijuar dhe për të aftësuar Policinë Gjyqësore, për të krijuar e për të konsoliduar konceptet e drejta për rolin e prokurorit në hetimet paraprake, për raportet e tija me Policinë Gjyqësore dhe për përgjegjesinë për zbatimin e ligjshmerisë dhe rritjen e profesionalizmit në kryerjen e detyrave.

Duhet pranuar që, aktualisht faza e hetimeve paraprake është hallka më e dobët e procedimit penal. Kjo situatë shpjegohet me shumë shkaqe, por shkaku kryesor mbetet mungesa e një tradite legjislative të konsoliduar që do të favorizonte kuptimin dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit të ri, të bazuar në standardet demokratike.

2.2 Modeli inkuizitor, akuzator dhe modeli ‘mix’ i procesit penal.

Historia e shteteve europiane ka njohur dy lloje sistemesh procedurale penale dhe prevalenca e njërit apo e tjetrit sistem vinte në varësi të konceptit që kishte shoqëria mbi lirinë personale të individit. Shtetet totalitare ishin të interesuara ti jepnin një përgjigje të shpejtë dhe efikase në rastet kur ndodhte krimi, dhe këtë e bënin pavarësisht nëse çënoheshin të drejtat dhe liritë themelore të subjektit që procedohej.

Normat që rregullojnë procesin penal reflektojnë një terren që sistemi politik i jep raporteve midis “autoriteteve” dhe “lirise” ,duke pasur një përmbajtje që i përgjigjet vlerave që ekzistojnë në momentin kur publikohet. Në një sistem politik i karakterizuar nga një bindje e fortë autoritare,

sic ishte kodi i regjimit monist, i cili nuk interesohej aspak për të drejtat minimale të personit, passillte sundimin e interesit për shtypjen e veprave penale e cila duhej të vihej në praktikë me gjithë rrezikun e sakrifikimit të të drejtave të atij që procedohej dhe shuante çdo vëmëndje për këtë temë delikate.⁸

Sistemet autoritare të cilat kanë qeverisur shtetet europiane deri në mesin e shek.XIX kanë pasur si qëllim shypjen e krimit dhe duke sakrifikuar të drejtat themelore të shtetasve. Sistemet procedurale të shteteve autoritare ishin sisteme të mirfillta inkuizitore në të cilat figura e prokurorit dhe e gjyqtarit shkriheshin në të njëjtin person. Në këtë sistem aplikohet parimi i fajsisë së prezumuar dhe barra e proves biente mbi personin i cili akuzohej për një vepër penale.

Shprehje e një tradite të konsoliduar nga epoka e perandorisë romake, sistemi inkuizitor i cili ka arritur majat e zbatueshmërisë së tij në procesin kanonik⁹, strukturohej sipas kriterëve të konfuzionit në të njëjtin subjekt rolet e akuzuesit dhe gjyqtarit, në atribuimin e akuzatorit-gjyqtar të detyrës për të kërkuar burimet e provës dhe në pamundësinë e të akuzuarit për të marrë pjesë në aktivitetin e individualizimit dhe të sigurimit të burimeve të provave; përvetësimi i mënyrës së shkruar në marrjen e elementëve të provës; trajtimi në sekret i procesit; parashikimi i burgosjes *ante judicium*.¹⁰

Përpara gjykatësit-inkuizitor nuk mund të konceptohet barazia mes akuzës dhe mbrojtëjs as nuk mund të realizohet barazia e kundërshtisë mes palëve apo siç njehet ndryshe parimi i barazisë së armëve.¹¹

⁸ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.8.

⁹ Ne historin europiane çdo fuqizim i pushtetit të Shteti i korrispondonte një ulje e pushtetit të kishës dhe anasjelltas. Procesi kononik është procesi penal i cili zbatohet nga autoritetet e kishës katolike.

¹⁰ Shprehje latinie që nënkupton marrjen e një vendimi përpara se te procedohej gjyqësisht.

¹¹ H.Islami, A.Hoxha, I.Panda “*Procedura Penale*” Tiranë 2014.fq.18.

Nuk ekzistonte në këtë sistem e drejta për të heshtur por i pandehuri kalonte prova në disa raste edhe çnjëzore për të provuar pafajsinë e tij. Në një sistem i cili frymëzohet nga parimet e demokracisë, objektivi i rikonfirmimit të urdhrat juridik të shkelur nga konsumimi i një dispozite penale dhe mbrojtja e të gjithë shoqërisë duhet të vij si pasojë e respektimit të garancive të personit që procedohet penalisht.

Sistemi akuzator ashtu sic ishte strukturuar në epokën republikane të Romës në ndryshim nga ai inkuizitor, bazohet në modelin e kundërshtimit midis palëve, akuzuesi dhe i akuzuari vendoseshin përpara një të treti me funksionin e gjyqtarit.

Rregullat e procesit akuzator kërkonin domosdoshmërisht prezencën e një akuzuesi i ndryshëm nga gjyqtari, i cili vepronte në kushte të barabarta me të akuzuarin në kërkimin e elementeve të provës për të vendosur ato më pas në vlerësimin e gjyqtarit; panashmërinë e gjyqtarit, i thirrur, si subjekt i zhveshur nga funksione hetuese, të vendosi në bazën e provave të marra me iniciativë të palëve; prezumimi i pafajsisë së personit të akuzuar, deri në momentin kur vendimi i dënimit merr formë të prerë; mbrojtja e të drejtave themelore të të akuzuarit në pritje të procedimit; publiciteti i procedurës, pa u fragmentizuar nga aktivitete sekrete, për të lejuar kontrollin efektiv të shoqërisë.

Sistemi akuzator është shprehje e sistemit liberal-demokratik duke u bazuar në debatin mes palëve të kundërta dhe në pozita të barabarta përsa i përket të drejtave procedurale. Në këtë sistem aplikohen parimet e gjithpranuara procedurale penale të shtetit të rregullt ligjor ndër të cilat mund të përmendim: parimin e barazisë së armëve i cili nënkupton vendosjen e palëve në pozicione të barazlanguara nga gjyqtari dhe vënien në dispozicion të tyre instrumente të njëjtë

procedural pa favorizuar njërën palë në dëm të tjetrës; parimi i kontradiktoritetit gjen mishërim të plotë në sistemin akuzator pasi procedura kërkon domosdoshmërisht prezencën e palëve përpara gjyqtarit dhe formimin e provës në seancë gjyqësore duke ju dhënë mundësi subjekteve të interesuara të parashetrojnë kundërshtimet e tyre.

2.2.1 Modeli “miks” i procesit penal.

Pamundësia për të riprodhuar të njëjtat kushte social-ekonomike që në epokat historike respektive mundësuan formimin e sistemit akuzator dhe sistemit inkuizitor, që i ka dhënë jetë, në epoka historike pasardhëse modele procesi të karakterizuar nga elementët përbërës, si të njërit dhe të tjetrit sistem.

Më shumë se prevalenca e një sistemi mbi tjetrin, historia e procedimit penal ka regjistruar-si rezultat i kombinimeve të shumta të njërit model me tjetrin-lindjen e sistemit të ashtëquajtur “miks”, i zgjedhur,herë si instrument që vë në dukje parimet e sistemit akuzator, herë si mjet vlersues i rregullave të sistemit inkuizitor.

Diferenca strukturale të rëndësishme që kanë të bëjnë me rolet e subjekteve pjesmarrës: prokurori, i pandehuri, gjyqtari, viktima, sekretari, policia gjyqësore, eksperti, përkthyesi-nuk gjenden midis nje kodi qëllimisht akuzator dhe nje kodi qëllimisht inkuizitor. Dhe aktet, masat parandaluese,veprimet përgatitore të procesit, debati gjyqësor, ekzekutimi i vendimit, raportet me autoritetet gjyqësore të vendeve të huaja, vazhdojnë të paraqiten si institute dhe kategori të cilat janë përmbajtje minimale e disiplinës të çdo sistemi penal.

Ajo që dallon një kod nga një tjetër është arsyeja që vë në lëvizje iniciativat e subjekteve dhe projektimi dinamik i aktivizimit të tyre, mbi të gjitha duke pasur parasysh fazën përgatitore të gjykimit.

Konkretisht dallimi midis një kodi dhe një tjetri matet me raportin kohor nga momenti i “faktit” në momentin e “gjkimit” pra, dispozitat që dispijlojnë aktivitetin e subjekteve të procesit penal nga momenti i faktit që përbën vepër penale deri në momentin e fillimit të gjykimit janë ato të cilat vënë në dukje diferencat ndërmjet këtyre sistemeve.

Në mungesë të kontekstualitetit midis kohës së kryerjes së faktit dhe kohës së gjykimit të faktit, tërësia e veprimeve që kryen më parë mund të kenë fuqinë për të paraqitur fazën më domethënëse të procesit si një ndërhyrje verifikuese e një gjykimi tashmë të formuar dhe të kristalizuar në akte që në thelb janë detyruese, për të evituar këtë duhet të jemi të kujdesshëm në hartimin e dispozitave të cilat dispijlojnë momentin nga ndodhja e faktit deri në momentin e gjykimit duke evituar futjen e dispozitave me karakter inkuizitor të cilat do të paragjykonin subjektet që i nënshtrohen procesit penal.¹²

2.3 Dallimi midis “procedimit për hetimet paraprake” dhe “procesit”.

¹² A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.12.

Tërësia e veprimeve që paraprijnë “procesin” ka vlerën e hetimeve të cilat zhvillohen vetëm për qëllimin e bindjes së brëndshme të prokurorit në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale.¹³

Të finalizuara vetëm në bindjen e brëndshme të prokurorit në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale, hetimet paraprake rrjedhin të gjitha, pikërisht vetëm në këtë drejtim specifik, duke i lënë vendin ushtrimit të ndjekjes penale të gjitha ato herë kur “*notitia criminis*”¹⁴ përmban elementët e domosdoshëm dhe të mjaftueshëm për të formuluar një akuzë ose një kërkesë për pushim¹⁵, nëse, anasjelltas, “*notitia criminis*” nuk është e përbërë nga elementë të përshtatshëm për të mbështetur akuzën.

Mund të kenë një funksion shërbyes për procesin ose mund ta bëjnë atë të padobishëm kur rezulton që njoftimi për veprën penale është i pa bazuar, si rrjedhojë procesi nuk është i domosdoshëm. Hetimet bëjnë pjesë në atributet institucionale të prokurorit, mjetet e provës presupozojnë prezencën e gjyqtarit, të cilit prokurori i kërkon të vërtetojë faktet duke i propozuar rindërtimin e tij logjik dhe kronologjik të faktit që përbën veprën penale.

Procedimi për hetimet paraprake fillon me marrjen dijeni për veprën penale nga prokurori ose policia gjyqësore dhe vazhdon për të gjithë kohën e nevojshme për kryerjen e hetimeve. Pozicionin suprem ligji ja njeh prokurorit jo vetëm mbi policinë gjyqësore por edhe mbi subjektet e interesuara mbi zhvillimin e hetimeve (personi i cili i nënshtrohet hetimeve dhe viktima) e ngrejnë në “*dominus*” të vetë hetimeve.

¹³ Neni.277 K.Pr.P, Organet e ngarkuara për hetimet paraprake “*Prokurori dhe policia zhvillojnë brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale*”.

¹⁴ Togfjalësh latin i cili nënkupton marrjen dijeni nga autoritetet kompetente për faktin që përbën veprën penale.

¹⁵ Sic do të shihet më qartë në kapitullin e tretë, me ndryshimet e bëra në K.Pr.P nga ligji 35\2017 në kuadër të reformës në drejtësi, prokurori mund të vendos kryesisht pushimin e akuzës ose të çështjes në disa raste specifike të parashikuara në ligj, vetëm kur procedohet për kundravajtjet penale.

Rrjedhimisht në lidhje me marrjen dijëni të veprës penale është prokurori ai që individualizon verifikimet që duhen kryer duke filluar fazën investiguese, e cila mund të ketë një afat relativ dhe një kompleksitet variabël ose konstaton se hetimet janë të panevojshme.

Nuk bëhet fjalë për një procedim me “skemë fikse” i kushtëzuar nga kalime të detyrueshme, të gjithë të paelemueshëm kronologjikisht dhe logjikisht të lidhur zinxhirë: nëse plotësohen vetëm hetimet që në dukje janë të domosdoshme, gjerësia dhe entiteti i tyre varet nga veçoria e verifikimeve dhe nga zgjedhjet që, në ushtrimin e fuqisë së tij diskrecionale prokurori vendos të kryej, si në raport me llojin e hetimit që do të kryhet ashtu dhe në raport me rregullin sipas të cilit hetimet duhen kryer.

Ndryshe duhet thënë për “procesin”, i cili sjell “grykimin” nga gjyqtari dhe implikon prezencën e këtij të fundit për tu shprehur mbi rëndësinë penale të faktit dhe përgjegjësinë e subjektit të cilit fakti i atribuohet nga prokurori. Vetëm procesi është faza e destinuar për verifikimin e bazueshmërisë së arsyeve të akuzës dhe të atyre, konkretisht të formuluar nga mbrojtja, përpara një gjyqtari i cili në pozicion të barazlartuar-sa nga arsyet e akuzës aq dhe nga ato të mbrojtjes rindërton ngjarjen mbi bazën e argumenteve të ofruara nga palët.

Momenti i kalimit nga “procedimi për hetimet paraprake” në “proces” karakterizohet nga investimi i gjyqtarit. Është gjyqtari të cilit prokurori i drejtohet sa herë nuk zgjedh të kërkoj pushimin e çështjes dhe nga “*notitia criminis*” dhe kërkon “procesin”- vlen të theksohet grykimi juridiksional mbi thelbin e akuzës, duke promovuar atë aksion penal në ushtrimin e së cilës Kushtetuta dhe ligji procedural i japin në rrugë ekskluzive.

2.4 Garancitë e të pandehurit në Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut.

Në dekadat e para të shek.XX dy luftrat botërore sidomos ajo e dyta, ngujuan pretendimet minimale për mbijetesë dhe për dinjitet të personit në gjendje të tillë sa flitej për “vdekjen e të drejtës pozitive”. Ishte pikërisht urgjenca për një rikonfirmim solemn të dinjitetit njerëzor, i shkelur nga ideologjia nazi-fashiste, që vuri në lëvizje në ambientet e OKB-së, institimin e një komisioni të cilit i dha detyra të rishkruante Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut, e aprovuar dhe e shpallur, më 10 Dhjetorë 1948.

Në preambulën e saj, DUDNJ dënon mosnjohjen dhe nënvlersimin e të drejtave të njeriut si shaku i parë i akteve barbare që ofendojnë ndërgjegjen e njerëzimit dhe shpreh dëshirën për një botë në të cilën njerëzit gëzojnë të drejtën e fjalës e të besimit dhe janë të lirinë nga frika dhe nga nevoja,të mbrojtur nga normat juridike për të evituar rekursin, si instancë e fundit, në rebelim kundër tiranisë dhe shtypjes.

Duke theksuar në parim se të gjithë lindin të lirë dhe të brabartë në dinjitet, të pajisur me arsye dhe ndërgjegje, si të tillë meritojnë të kenë, në çdo vend, njohjen e personalitetit të tyre juridik, Deklarata rezervon një konsiderat të veçantë personit që i nënshtrohet procesit penal.

Konfirmimit që ndalon nënshttrimin në tortur ose në trajtime apo dënime të egra, çnjerëzore ose degraduese¹⁶ dhe parimin që e bën të pavdekshëm barazinë e të gjithëve përpara ligjit¹⁷ i bashkangjiten deklarata më specifike të vendosura për ti atribuar çdo individ fuqinë për t ju

¹⁶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni.5 “Asnjëri nuk duhet të nënshtrohet turturës, veprimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”.

¹⁷ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni.2 “Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrëfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose të vendit të cilit i përket ç do njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetë qeverisë ose që gjendet në çfardo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.”

drejtuar gjykatave kompetente kombëtare kundër akteve të cilat shkelin të drejtat e tij thelbësore¹⁸; e drejta për të pasur një mbrojtje efektive gjyqësore nëpërmjet “një proces të rregullt ligjor përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme” për “ përcaktimin e bazueshmërisë të çdo akuze penale që i atribuohet”¹⁹; e drejta për të pasur prezumimin e pafajësisë, derisa fajësia e tij nuk provohet ligjërisht në një proces penal publik²⁰.

Dënimi nuk mund të jetë në asnjë rast si pasojë e veprimit ose mosveprimit të cilët nuk parashikohen në ligj si vepër penale dhe masat ose llojet e dënimit nuk mund të mos jenë të pa parashikuara shprehimisht në ligj²¹.

Edhe pse nuk është e detyrueshme për shtetet aderuese sepse është nënkuptuar si program i qëllimit të asamblesë së përgjithshme të Organizatës, DUDNJ ka qënë dhe është platformë e sigurt e padyshimtë për konsiderimin efektiv të të drejtave të njeriut i cili i nënshtrohet procesit penal. Mbi bazën e saj ka lindur detyrimi domethënës i çdo shteti si në nivel të legjislacionit të brëndshëm ashtu dhe në rang mardhëniesh juridike ndërkombëtare, të laboroj mekanizma të përshtatshëm për të garantuar respektimin e të drejtave të personit që i nënshtrohet procesit penal. Përbëjnë pikën e mbërritjes së kësaj lëvizje ndër të tjera edhe KEDNJ tek e cila do të

¹⁸ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni.8 “Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme përpara gjykatave kompetente kombëtare për veprime me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta ose ligji.”

¹⁹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni.10 “Gjithkush gëzon njëllojë të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale”

²⁰ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni.11\1 “Kushdo që është i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe me një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vetë.”

²¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni.11\2 “Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprimeve që nuk përbëjnë një vepër penal sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim tjetër më i rëndë nga ai që ka qënë zbatuar në kohën që është kryer vepra penale.” Parashikim i till gjendet si në Kushtetut ashtu edhe në Kodin Penal.

ndalemi pasi të kemi analizuar parimet Kushtetuese që janë modifikuar pikërisht në funksion të përshtatjes me Kartën Europiane.

2.5 Procesi i rregullt ligjor në Kushtetutë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë u adoptua më 12 shtator 1988 përmes referendumit mbarëpopullor. E vendosur në krye të hierarkisë së burimeve të së drejtës, rilidh, të drejtat të cilat i njeh si të padhunueshme me parimin e barazisë së të gjithë qytetarëve përpara ligjit²². Për aktualizimin e këtij parimi është stabilizuar në nenin 31 pika ç të Kushtetutës që edhe personat që nuk janë të pajisur me mjete të mjaftueshme t' ju sigurohen mbrojtje falas. Barazia e trajtimit është objektivi që arrihet nëpërmjet parashikimeve ligjore të cilat përcaktojnë detyrat e organit që i jep impuls akuzës, rolin e subjektit të veshur me funksion juridiksional, pozicionin e të akuzuarit dhe rregullat e procesit. “Akuza”, “Mbrojtja”, “Gjykimi” paraqiten si polet kryesore të rregullave nga të cilat drejtohet procedimi penal dhe japin përmbajtje “procesit të rregullt ligjor”.

E drejta për një proces të rregullt ligjorë është një ndër garancitë kushtetuese e cila parashikohet shprehimisht në nenin 42 të Kushtetutës²³ i cili ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të shtetasve sepse juridiksioni në përgjithësi dhe ai penal në veçanti materializohet vetëm me anë të procesit të rregullt ligjor.²⁴

Përsa i përket prokurorit ai gëzon garancitë e parshikuara në mbrojtje të funksionit nga dispozitat kushtetuese, kodi i procedurës penale dhe ligje të tjera të veçanta. Në nenin 148 të Kushtetutës

²² Funksioni juridiksional bazohet në konfirmimin e parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, sipas të cilit “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, orientimit seksual, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”.

²³ Kushtetuta Neni.42\2 “*Kushdo...në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*”.

²⁴ L.Omari, A.Anastasi “*E Drejta Kushtetuese*” Dajti 2002, Tiranë 2017 fq.144

parashikohet se : “Prokurori ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokurori kryen dhe detyra të tjera të veçanta të caktuara në ligj”. Rezerva ligjore kushtetuese i referohet në veçanti K.Pr.P në të cilin parashikohen shprehimisht kompetencat e organit të akuzës.²⁵

Titullar i funksioneve të ndryshme dhe të ndara nga organi i akuzës, është gjyqtari, i cili ushtron funksione juridiksionale dhe administron drejtësinë në emër të Republikës²⁶ duke ju nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve²⁷ si “gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm”²⁸ duke dhenë vendimet të arsyetuara²⁹ e të shpallura në çdo rast publikisht³⁰.

“Pavarsia e gjyqsorit është një kusht paraprak për shtetin e së drejtës dhe një garanci thelbësore për një gjykim sa më të drejtë”³¹.

²⁵ K.Pr.P Neni 24, **Funksionet e prokurorit**

“Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë procedimin, të pushoj akuzën ose çështjen, t’i kërkojë gjykatës pushimin e akuzës ose çështjes, si dhe të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod. 3. Prokurori ka të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, të hartuara në zbatim të nenit 37/a, të këtij Kodi, dhe të dispozitave ligjore të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. 4. Prokurori mund të arrijë një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, në përputhje me nenin 406/d e vijues të këtij Kodi. 5. Prokurori mund të paraqesë në gjykatë kërkesë për miratimin e urdhrin penal sipas parashikimeve të këtij Kodi. 6. Kur nuk është i nevojshëm ankimi i viktimës, ndjekja penale ushtrohet kryesisht”.

Neni 277 **Organet e ngarkuara për hetimet paraprake**

“1. Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. 2. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.”

²⁶ Kushtetuta Neni 146\1 “Gjykatat japin vendimet në emër të Republikës”.

²⁷ Kushtetuta Neni 145\1 “Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”.

²⁸ Kushtetuta Neni 42\2 “Kushdo...ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...”.

²⁹ Kushtetuta Neni 142\1 “Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara”.

³⁰ Kushtetuta Neni 146\2 “Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”.

³¹F.Kola-Tafaj Shkolla e Magjistraturës “Jeta juridike” Revista juridike shkencore Nr.1,viti VII i botimit,Tirane,Botimet Morrava. Mars 2010 fq.85

Pavarsisht sa u paarashtrua më sipër “*në Shqipëri vihet re një ndërhyrje nga partitë politike në veprimtarinë e gjykatave*”³² por jo vetëm kaq, ndërhyrjet janë të përditëshme edhe nga ana e individëve të cilët duke paguar rryshvet ose duke shfrytëzuar njohjet e tyre arrijnë të përjashtohen nga dënimi ose të marrin masa dënimi më të buta duke shkelur kështu jo vetëm Kushtetutën dhe rregullat në fuqi por edhe duke paraqitur një rrezikshmëri konstante për shoqërinë.

Përsa i përket personit që i atribuohet vepra penale³³ (të drejtat e tij parashikohen nga nenet 25-37 dhe 42\2 i Kushtetutës) ka të drejtën për tu gjykuar sipas parashikimeve të nenit 42\2 të Kushtetutës dhe mbrojtja e tij është e pacënueshme në çdo gjëndje dhe shkallë të procedimit³⁴. Për të arritur këtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës, duhet të bëhet e mundur që personi të vihen në djeni menjëher dhe privatësisht, për natyrën dhe motivet e akuzës së ngritur kundrejt tij; të disponoj kohën dhe kushtet e domosdoshme për të përgatitur mbrojtjen; të ketë mundësinë përpara gjyqtarit të pyes persona të cilët japin deklarata në ngarkim të tij; të disponojë një përkthyes në rast se nuk flet gjuhën shqipe.

Çdo i akuzuar ka të drejtë “të ketë kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen”. Kjo është një shprehje disi e paqartë. Por ndoshta është hartuar për ti dhënë më shumë rëndësi idesë së procesit të rregullt ligjor.³⁵

³² H.Islami, A.Hoxha, I.Panda “*Procedura Penale*” Tiranë 2014.fq.46

³³ Vlen të sillel në vëmendje se nga Janari i vitit 2018 ka hyrë në fuqi ligji 37\2018 “*Kodi i drejtësisë penale për të mitur*” i cili aplikohet kur i pandehur është personi që nuk ka mbushur moshën 18 vjec.

³⁴ Kushtetuta Neni 31\ç “*Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikoj lirisht dhe privatisht me të si dhe ti sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme*”.

³⁵ J.Pradel, G.Corstens, G.Vermeulen “*E drejta Penale Europiane*” Tirane 2009.fq 374

Në zbatim të parimeve themelore të procesit akuzator ajo që vlen të theksohet është parimi i prezumimit të pafajsisë i sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës sipas të cilit “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Liria personale e të akuzuarit është e pacënueshme, janë të lejueshme format e burgosjes, kqyrjes, kontrollimeve personale ose çfardo lloj përfshirje në sferën e lirive vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji dhe vetëm me vendim të motivuar të gjyqtarit, i domosdoshëm edhe kur, në raste të jashtëzakonshme, nevojë dhe urgjence, autoriteti i sigurisë publike duhet të marrë vendime shtrënguese, kufizuese ose invazive të lirive individuale. Këto raste të jashtëzakonshme i komuniukohen brenda 48 orëve gjyqtarit, duke humbur vlefshmërinë në qoftë se nuk vlersohen brenda 48 orëve pasardhëse. Paraburgimi në përfundim nuk mund të tejkaloj, afatin e limiteve maksimale të cilat parashikohen nga K.Pr.P.

2.6 Garancite e të pandehurit në Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut e firmosur në Romë në 4 nëntore 1950 nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës e ratifikuar dhe e vënë në ekzekutim në Shqipëri me ligjin nr.8137, date 31.07.1996 dedikon një vëmëndje të veçantë të drejtave të subjekteve që i nënshtrohen procedimit penal duke vendosur që në fillim, në nenin 3, ndalimin absolut të torturës apo të dënimëve ose trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese.

KEDNJ është pjesë e rendit të brëndshëm juridik pasi thërritet në mënyrë eksplicite nga neni 17\2 Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.³⁶

Në nenin 7 të Konventes konfirmohet se askush nuk mund të dënohet për një veprim apo mosveprim i cili nuk përbën vepër penale në momentin kur është kryer , gjithashtu askush nuk mund të dënohet me një masë dënimi më të lartë nga ajo që aplikohet në momentin e konsumimit të veprës penale.

Konteksti i garancive del në sipërfaqe në veçanti në lidhje me të mirat juridike thelbësore të “lirisë” dhe “sigurisë” të çdo personi , duke parashikuar përsa i përket të parës, që, gjatë procedimit penal kufizimet e lirisë të të pandehurit janë të lejueshme në rastet dhe mënyrat e parashikuara në ligj.

Neni 5 i KEDNJ thërritet në mënyrë të shprehur nga nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës në të cilët ashtu siç u parashtrua më sipër përcaktohen rastet e një taksativiteti absolut për arsyet e kufizimit të lirisë individuale dhe të drejtat e personave të cilët janë privuar nga liria.

Prerogativa thelbësore dhe garanci specifike janë parashikuar më pas për gjykimin: i është njohur çdo të pandehuri e drejta për një proces të rregullt përpara një gjykate të pavarur, të paanshme, të caktuar me ligj për të vendosur mbi bazueshmërinë e akuzës së formuluar në ngarkim të tij.

Seanca është publike, por publiciteti ka limite për arsye “morali”, “sigurie publike ose kombëtare”. Aksesit në sallën e gjyqit mund të ndalohej përgjatë gjithë procesit ose në një pjesë të tij kur kërkohet nga “interesi i të miturit apo mbrojtja e privatisë së palëve” në procesin penal ose kur publiciteti mund të paragjykojë “interesat e drejtësisë”.

³⁶ E.Sulko “*The status of the ECHR in the Albanian Constitutional Order*” Avokatia, Periodike e pavarur, nr.19,Korrik 2016. fq.30.

Të drejta të tjera me rëndësi kushtetuese që përfshihen në KEDNJ janë: prezumimi i pafajsisë; barazia e armëve; e drejta për tu mbrojtur nga një avokat³⁷ edhe në rast pamundësie ekonomike; e drejta për të pyetur dëshmitarët në ngarkim, për të thirrur dëshmitar që e shfajsojnë; *ne bis in idem*; dhe për tu asistuar nga një përkthyes kur nuk kupton gjuhën.

2.7 Garancitë e të pandehurit në Bashkimin Europian

Duke filluar nga 1 Dhjetori 2009 mbrojtja e të drejtave thelbësore dhe të garancive “të procesit të rregullt ligjor në nivel Europian ka pësuar një përforsim me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës i nënshkruar nga përfaqësuesit e qeverive antare të Bashkimit Europian më 13 Dhjetor 2007. Me Traktatin e sipërcituar BE-ja mbi të gjitha ka aderuar në KEDNJ: konfirmohet në mënyrë solemne që të drejtat themelore të garantuara nga KEDNJ që rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve antare janë pjesë e të drejtës europiane duke qenë se përbëjnë parime të përgjithshme.³⁸

Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të shtetasve është integruar me Kartën e të drejtave themelore të BE-së të firmosur në Nicë më 7 Dhjetor 2000 të cilës i është dhënë e njëjta vlerë juridike me traktatet duke u bërë e detyrueshme për institucionet europiane dhe shtetet antare.

Për të mos qenë përsëritës vlen të theksojmë se të drejtat dhe liritë themelore të personit i cili i nënshtrohet procesit penal, të sanksionuara në legjislacionin e BE-së janë të njëjta me të drejtat e të pandehurit të parashikuara në KEDNJ si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

³⁷ I.Peçi Shkolla e Magjistraturës “Jeta juridike” Revista juridike shkencore” Nr.1, viti IX i botimit, Tirane, Botimet Morrava. Mars 2011 “*Ndihma ligjore falas sipas KEDNJ*”. fq.96. Sipas autorit neni 6 KEDNJ zbatohet gjithashtu në fazën e hetimeve paraprake nëse dhe për sa kohë që drejtësia e gjykimit ka të ngjarë të paragjykohe drejtësisht nga refuzimi i autoriteteve për ti dhënë akses një të akuzuari te avokati.

³⁸ Neni.6 pika 2\3 TBE.

2.8 Kontradiktoriteti si rregull i gjykimit.

I pandehuri është figura qendrore e verifikimeve penale pasi efektet e procesit ndikojnë në sferën e tij personale duke i prekur liritë themelore. Përkujdesja që Kushtetuta i rezervon të pandehurit është me të vërtetë maksimale dhe domethënëse sidomos përsa i përket të drejtës për të ndërhyrë në çështje duke i parashtruar gjyqtarit shfajsimet e tij të cilave në kontradiktoritet me palën tjetër kërkon t'ju japi vlerë, me qëllim që të meren në konsideratë në vendimin e gjyqtarit.³⁹

Argumentat që i paraqiten gjyqtarit të procesit penal kanë kontrast dhe ndryshojnë nga njëri tjetri në varësi të qëllimit që palët kerërkojnë të arrijnë: argumentet e akuzës janë të mbështetura në akte të cilat kërkojnë të provojnë paligjshmërinë e faktit dhe atribuimin e tij autorit; argumentet e mbrojtjes kanë si qëllim të kundërshtojnë, duke i minuar bazueshmërinë dhe mbështetjen, me mjete që kërkojnë të përjashtojnë paligjshmërinë e sjelljes ose të demostrojnë mungesën e lidhjes së të pandehurit me faktin kriminal, ose mungesën e kushteve për aplikimin e dënimit.

Esenca e funksionit juridiksional konsiston pikërisht në lejimin e çdo pale të “pohjë” dhe të “prapësojë” mbi çdo fakt ose mbi çdo element provues të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Pikërisht në këtë kontekst gjejnë kuptimin e tyre më domethënës parimi i kontradiktoritetit dhe paashmëria e gjyqtarit. E shprehur me togefjalshin latin “*audiatur ed altera pars*” në të cilin përmbledhej detyrimi për të mos vendosur pa dëgjuar më parë arsyet e të dyja palëve-

³⁹ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.121.

“paanshmëria” është kocept që imponon prezencën e subjekteve të ndryshëm nga gjyqtari që konfirmojnë dhe mbështesin pretendimet e tyre me argumenta të drejtuara për të bindur.

Në disiplinën e debatit gjyqsor është mëse frekvente thirrja e palëve për ti mbajtur të ndara pozicionet e tyre nga ajo e gjyqtarit kështu për shëmbull : Gjykata, pasi dëgjon palët jep vendim për marrjen e provave dhe vendos në bazë të pretendimeve që bëjnë palët në lidhje me marrjen e provave (neni 357 K.Pr.P); shqyrtimi gjyqsor mund të riçelet me kërkesën e palëve (neni 378\A K.Pr.P); vendimi merret menjëherë pas diskutimeve përfundimtare të palëve. Janë këto vetëm nje pjesë e shumë shembujve të dispozitave të kodit që parshikojnë ndarjen midis palëve dhe gjyqtarit.

Jo të gjitha subjektet proceduriale janë palë, pavarisist thirrjeve të vazhdueshme që u bën palëve, kodi nuk ju jep një përkufizim duke, ju dedikuar, në të kundërt një disiplinë të detajuar subjekteve midis të cilëve liston gjyqtarin, prokurorin, policinë gjyqësore, personin nën hetim, të pandehurin, paditësin ose të paditurin civil, viktimën, mbrojtësin. Dallimi midis palëve dhe subjekteve nuk përbëhet duke ju referuar përmbajtjes së pretendimit por duke ju referuar atij të cilit pretendimi i adresohet: kur i drejtohesh gjyqtarit je palë.⁴⁰

Prokurori dhe i pandehuri janë palë të domosdoshme pasi procesi duhet të regjistrojë domosdoshmërisht prezencën e një të akuzuari dhe akuzuesi.“I pandehuri nuk ka barrën e provës për ti treguar autoriteteve se ai nuk po përpiqej që ti shmangej drejtësisë, apo se mungesa e tij

⁴⁰ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.127. Sipas autorëve viktimat-i dëmtuar është subjekt i interesuar mbi hetimet e prokurorit gjatë fazës paraprake; është palë në proces sepse i kërkon gjyqtarit dënimin e të akuzuarit, dëmshpërblim ose kthimin në gjëndje të mëparshme. Ushtrimi i ndjekjes penale është akt për efekt e të cilit personi nën hetim zhvishet nga statusi i subjektit të procedimit penal dhe merr cilsinë e të pandehurit; është palë në proces sepse i kërkon gjyqtarit të njohi pafajsinë e tij mbi faktin që i atribuohet, në analogji e njejtat gje vlen dhe për prokurorin.

ishite pasojë e një *force majeure*".⁴¹ I padituri dhe paditësi civil janë palë eventuale pasi procesi mund të zhvillohet dhe në munges të tyre. Nga këtu bëhet dhe dallimi midis kotradiktoritetit të domosdoshëm dhe atij eventual.

Kur flitet për kotradiktoritetin nuk mund të limitohemi duke thënë se është përfaqësimi përpara gjyqtarit i arsyeve të palëve si parim që shprehet në fazën e debatit gjyqsor sepse fillon me ilustrimin e provave që kërkohen të merren në përgjigjen e pyetjeve specifike që mund të bëjë gjykata dhe vazhdon me paraqitjen e provave; kundërshtimin e provave të palës tjetër dhe përfundon me argumentat që secila palë parashtron në lidhje me rezultatet provuese të arritura. Parimi i kotradiktoritetit nuk mund të shihet i ndarë nga parimet e tjera siç është parimi i publicitetit; parimi i oralitetit; parimi i gjykimit brënda një afati të arsyeshmëm etj.

Që të realizohet në mënyrë efikase paraqitja e faktit përpara gjyqtarit duhet të finalizohen dy momente paraprake në lidhje me njohjen dhe marrjen e provave.

Tre aspekte të sipërcituara janë një kategori e pandarë: sa më komplet dhe i kryer në kohën të jetë aktiviteti i njohjes me aktet dhe produktiv ai i marrjes së provës, aq më shumë efikase do të jetë dimensionimi i përfaqësimit të faktit përpara gjyqtarit.

⁴¹ D.Kumbaro "*Versus Albania*" Jurisprudenca e Gjykatës Europiane Për të Drejtat e Njeriut" Tiranë,2015.fq7

Kapitulli III: ROLI GARANTUES I GJYQTARIT PËR HETIMET

PARAPRAKE: Vështrim krahesues

3.1 Pamundësia e eliminimit të një faze që paraprin gjykimin

Si fillim duhet të konstatohet një realitet që pa asnjë hije dyshimi, paraqitet si një e dhënë e paelemnueshme çdo herë që ndalet vëmëndja në procesin penal si eksperienc: ideja e një procesi që zhvillohet në respektim të plotë të parimeve natyrale të gjykimit - identifikuar në parimet e gjykimit të pa ndërprerë, oralitetit, publicitetit dhe kontradiktoritetit - nepërmjet një debati publik, në zhvillimin e të cilit, në pozicionet e kundërta dialektike midis palëve, gjyqtari rindërton, pa ndërprerë gjykimin, faktin që integron elementët e një akuze për të stabilizuar nëse bëhet fjalë vërtetë për një vepër penale dhe nëse për të duhet të përgjigjet subjekti të cilit i atribuohet, nuk mund të gjejë aplikim përveç se në raste përjashtimore.⁴²

Dhe Kodi në fuqi, pavarësisht karakterit të sistemit akuzator, pavarësisht sforcimeve të ligjvënësit për të mbajtur brënda fraksioneve kohore të mirë përcaktuara aktivitetin hetues të drejtuar në thellimin e njohurive mbi përmbajtjen e “*notitia criminis*”, ka dashur ti bëjë ballë nevojës për të parashikuar, sidoqoftë, një fazë, të nartyrës paraprake, e rezervuar për formulimin e akuzës.⁴³

Është e vërtetë se mund të jemi në kushtet e gjykimit të menjëhershëm siç ndodh në rastin e parashikuar në ligj kur aplikohet gjykimi i drejtpërdrejtë, që siguron një proces pothuajse absolutisht kontekstual në momenti e kryerjes së faktit që përbën vepër penale, por kjo mënyrë

⁴²M.Ferraioli “*Il ruolo di “grante” del giudice per le indagini preliminari*” Terza edizione, Cedam, Verona, 2006 fq.3

⁴³ Është e qartë influenza e ustruar nga KEDNJ që i njeh *do personi të drejtën e një procesi të rregullt logjorë brenda një afati të arsyeshëm, si* specifikohet dhe në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike (Ligji nr.7510 date 8.08.1991) mund “të gjykohej pa vonesë të pa justifikuar”.

verifikimi vazhdon të inspirohet nga kriteret taksativitetit të cilët përbëjnë rastin përjashtimorë të zgjidhjes.

Në shumicën e rasteve, akuza, e nënkuptuar si atribuimi ndaj një subjekti i një fakti me rëndësi penale nuk mund të mos maturohet veçse në përfundim të një pune verifikimi dhe bazueshmërie mbi “*notitia criminis*”, që në mënyrë të paevitueshme kërkon një hark kohor të përshtatshëm.

Faza ekziston dhe nuk mund të eliminohet nga llogjika e verifikimit penal, vlera që mund ti atribuohen asaj që është mbledhur, në momentin pasarsdhës të gjyqimit, mund të bëjë të mundur inkuadrimitin e një procesi inkuizitor apo akuzator.

Në mënyrë analoge nuk mundet të mos konceptohet prezenca e një gjyqtari në fazën paraprake, në kuptimin që do të rezultonte krejtësisht e gabuar në qoftë se prokurori do të kryente të gjitha veprimet të cilat mund të rezultonin dhe arbitrare dhe personi nën hetim të cilit i kufizoheshin të drejtat dhe liritë themelore nuk do ti jepej mundësia të ankimonte këtë fakt.

3.2 Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake në vende të ndryshme. Njëvështrim i shkurtër.

Në vendet që kanë adoptuar sistemin akuzator fillimisht kanë qenë privatët (normalisht viktima ose familjarët e tij) që i jepnin impuls fillimit të procesit gjyqësor. Në mënyrë graduale oranet e rendit publik (policia e shtetit) morën detyrën që të ishin ata të cilët do të zhvillonin hetimet paraprake nëse ishte kryer një veprë penale. Procedimin penal e fillon prokurori që normalisht gëzon pushtet diskrecional (prsh në Angli dhe në Galës), pra në këtë mënyrë vendos cilat çështje duhen çuar përpara gjykatës për shqyrtim. Atëherë kur procedimi penal ka

filluar, viktimë ose individë të tjerë (familjarët) nuk luajnë me asnjë rol përveçës si dëshmitarë të mundshëm.

Në sistemin inkuizitor hetimet paraprake fillojnë pikërisht nga policia (bëhet fjalë për një sektor special të forcave të rendit e quajtur Policia Gjyqësore dhe është nën varësinë e prokurorit) ose të viktimës (që paraqet një denoncim në polici) ose në mënyrë autonome nga prokurori në momentin që ai merr njoftimin që mund të jetë kryer një veprë penale. Në vendet si Gjermania e deri pak viteve më parë dhe Italia prokurori ka detyrimin që të fillojë hetimet paraprake menjëherë sa merr njoftimin e ‘*notitia criminis*’ dmth sapo merr dijeni për faktin që mund të jetë kryer një krim⁴⁴. Në qoftë se pasi janë kryer të gjitha hetimet paraprake ai mendon që janë të gjitha elementët e nevojshëm për ngritjen e akuzës penale atëherë ai është i detyruar ta ushtrojë këtë të fundit; me fjalë të tjera prokurori nuk gëzon normalisht pushtet diskrecional. Ky lloji pushteti diskrecional ekziston gjithsesi në shtete të tjera ku mund të përmendim Francën dhe Belgjikën. Në disa shtete si për shembull në Francë procedimet penale mund të nisnin edhe nga vetë viktimë ose nga ente private siç janë sindikatat ose shoqatat etj nëse ato vlerësojnë se janë dëmtuar nga ky krim dhe përdorin të ashtuquajturën *constitution de partie civile*, nëpërmjet të cilës i kërkojnë trupit gjykues penal një dëmshpërblim⁴⁵.

Në vitin 1975 figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake u hoq në disa vende të Europës Perëndimore. Përmendim këtu rastin e Gjermanisë. Po ashtu dhe Zvicra arriti të njëjtin rezultat, kohë kur hyri në fuqi Kodi i Procedurës Penale Federale në 1 janar 2011. Ndërkohë figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake është në fuqi në rendin juridik në Itali dhe në Francë, ku në këtë vend *Juge d'Instruction* është modeli prej të cilit janë inspiruar disa vende. Përmendim këtu

⁴⁴Shih për më shumë në lidhje me këtë argument Cassese, A., “*Lineamenti di diritto internazionale penale*”, Il Mulino, 2006, fq. 59-60.

⁴⁵Po aty.

përsëri rastin e Italisë dhe të Belgjikës. Në shtete të tjera si Spanja dhe Portugalia kjo figurë e veçantë ekziston por ka një rol të kufizuar, dhe mund të konsiderohet simbolik, pasi nuk ka një rol të mirëfilltë dhe aktiv në këtë fazë si në vendet e tjera të sipërpërmendura.

3.3 Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin italian. Nga gjyqtari hetues (giudice istruttore) në gjyqtarin e hetimeve paraprake (Giudice delle indagini preliminari).

Në vitin 1930 në Itali ekzistonte Gjyqtari Instruktur⁴⁶ i cili ishte i legjitimuar të kryente “të gjitha dhe vetëm aktet e nevojshme për zbulimin e së vërtetës. Në 1978 u reduktuan kompetencat e funksionit investigues të gjyqëtarit në fazën e hetimeve paraprake dhe u propozua emërtimi “*giudice degli atti di istruzione*“. Pasi u ristrukturua procesi penal sipas kritereve që reflektonin elementet akuzator ishte e detyrueshme shfuqizimi i figurës gjyqësore që në ushtrimin e funksioneve të tij shfaqte gjurme inkuizitore. Ligjvënsi italian duke konsideruar se subjektet e ngarkuara “*për kryerjen*“ e hetimeve paraprake janë O.P.GJ dhe prokurori emërtoj gjyqëtarin e kësaj faze si gjyqëtar i hetimeve paraprake dhe jo për hetimet paraprake.⁴⁷ Nëse do të emërtohej gjyqëtar “*për*“ hetimet paraprake dhe jo gjyqtarë “*i*“ hetimeve paraprake, mundësia për të ndërhyrë në kompetencat e subjekteve të ngarkuara “*për kryerjen*“ e hetimeve paraprake do të rritej në mënyrë eksponenciale duke rikthyer rrezikun e rishfaqjes së gjyqëtarit instruktur.

⁴⁶ Në fjalorin shqip termi instruktur do të thotë : “*Ai që udhëzon e jep mësim për të përvetësuar një mjeshteri; ai që drejton një stërvitje. Instruktur ushtarak. Instruktur fizkulture. Instruktori i togës. Instruktori i qendrës mësimore*”

⁴⁷ Sipas Relacionit mbi projektin paraprak të K.Pr.P Italian, GU 24/10/1988 nr 250.

Gjyqtari i hetimeve paraprake është një subjekt i procedurës penale që ka rol dhe funksion të caktuar në procedura të caktuara, gjatë fazës së hetimit paraprak, për të garantuar ligjshmërinë e veprimeve. Ai ushtron një juridiksion gjysmë të plotë me një funksion të veçantë. Figura e tij u fut në procesin penal italian për të zëvendësuar atë të gjyqtarit hetues (giudice istruttore) që qëndroi deri në hyrjen në fuqi të Kodit Vassalli, (emëruar sipas Giuliano Vassalli, ministri i drejtësisë në atë kohë) i cili është dhe kodi aktual i procedurës penale. Për të kuptuar më mirë këtë figurë të gjyqësorit bëjmë një hap mbrapa dhe shpjegojmë rolin dhe funksionin që ka patur gjyqtari hetues dhe cilat ishin detyrat e tij.

Në disa rrethet juridike të Civil Law, përfshirë këtu edhe Italinë që kemi marrë në analizë, gjyqtari hetues ishte një gjyqtar para të cilit zhvillohej gjithë veprimtaria hetimore, pra faza e parë e procesit të hetimit penal, një fazë kjo e cila ka karakteristikat e modelit inkuizitor.

Është prokurori në fakt ai që mbledh provat, nëpërmjet edhe një organi tjetër ndihmës, ai i policisë gjyqësore. Në përfundim të hetimeve, dhe shqyrtimit të dosjes së sjellë nga prokurori, gjyqtari vendos për pafajësinë ose dërgimin e çështjes në gjyq nëpërmjet formulimit të akuzës. Procedura vazhdon tashmë përpara një gjyqtari tjetër që është gjyqtari i seancës paraprake, një procedurë që ka karakteristikat tipike të sistemit akuzator dhe një figurë kjo që do të merret në analizë në paragrafët në vijim.

Figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake, ashtu sikurse është theksuar edhe më parë në këtë punim ka qenë prezent në sistemin procesual penal Italian deri në vitin 1989, vit kur hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, pikërisht më 24 tetor 1989. Në dispozitat aktuale të këtij Kodi gjejmë një figurë tjetër, atë të gjyqtarit të hetimeve paraprake por edhe të një ndryshimi në gjithë sistemin e procedurës penale sepse procesi mori ngjyrat e një sistemi të pastër akuzator.

Këtu mori formëdhe përmabjtje figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake e cila është një figurë e veçantë e sistemit procedural Italian por pa fuqi dhe kompetenca për të filluar procesin e mbledhjes së provave (hetimet paraprake). Qëllimi kryesor dhe i përgjithshëm i kësaj figure në çdo fazë dhe në çdo veprimtari të ndërmarrë nga organet e akuzës ishte mbi të gjitha garantimi i individit të të drejtave dhe lirive themelore, ato kushtetuese dhe sidomos ato që kishin të bënim me cënimin e lirisë dhe sigurisë së personit të dyshuar.

Gjyqtari hetues kishte më shumë kompetenca dhe gëzonte një pushtet më të madh lidhur me procesin e mbledhjes dhe këqyrjes së provave. Në gjykatat e mëdha dhe të qyteteve të mëdha kishte një numër më të madh gjyqtarësh hetues të cilën në organigramë ishin nën mbikqyrjen e Këshilltarit.

Gjyqtari i hetimeve paraprake nuk ndërmerr iniciativen për të mbledhur provat në një proces, pra në kuadër të funksioneve që i janë dhënë ai nuk kryen funksione hetimi, por vendos mbi bazën e kërkesave që mund t'i paraqiten nga ana e prokurorit, personit nën hetim apo personit të dëmtuar nga vepra penale. Pikërisht për këtë arsye mund të thuhet se ai ka një funksion *gjysmëtë plotë*. Aktet juridike për të cilat ai përgjigjet, ose ato që ai vendos janë të specifikuara në mënyrë taksative nga ligji, pra qëndron në fuqi parimi i ligjshmërisë. Ky gjyqtar nuk ka asnjë dosje të procesit, pra nuk disponon një fashikull të vetin, ndryshe dhe nga gjyqtari i seancës paraprake që e disponon një të tillë.

Aktet, materialet dhe gjithçka që gjyqtari merr dijeni i vijnë nga prokurori i çështjes. Në këtë rast janë ato materiale (dokumentacion si psh. provat dhe akte të ndryshme) të cilat prokurori vendos t'i bashkalidhë dosjes, dmth kërkesës që ai i parashton gjyqtarit të hetimeve paraprake. Për shembull, lidhur me kërkesën që parashton prokurori për masat e sigurisë, vetë prokurori vendos çfarë dokumentacioni dhe çfarë aktet do i bashkalidhë kërkesës. Detyrimi i vetëm që ka

prokurori në këtë rast është që medoemos duhet të bashkalidhë të gjitha ato elemente të provave që janë në favor të personit të dyshuar.

Funksionet që i janë dhënë gjyqtarit të hetimeve paraprake janë listëzuar në një mënyrë të tillë që të predispozojnë garanci individit të dyshuar gjatë gjithë fazës së hetimeve paraprake, dhe një nga këto është pikërisht vendimi për masën e sigurimit që kërkohet nga prokurori. Gjyqtari rast pas rasti dhe pasi shqyrton gjithë dokumentacionin e bashkëlidhur nga prokurori vendos pranimin ose refuzimin e kërkesës së prokurorit.

Një ndër funksionet kryesore të gjyqtarit të hetimeve paraprake është pikërisht disponimi/vendimi në lidhje me kërkesat për caktimin e masave të sigurimit gjatë hetimeve paraprake⁴⁸. Theksohet se kërkesa për caktimin e masave të sigurimit kryhet nga ana e prokurorit dhe vendosja e tyre bëhet me anë të vendimit (ordinanza cautelare) të gjyqtarit të hetimeve paraprake.

3.3.1 Roli dhe rëndësia e tij në sistemin procedural penal italian.

Mund të thuhet se juridiksioni i ushtruar nga gjyqtari i hetimeve paraprake është një juridiksion “*gjysmë i plote*”, pasi gjyqtari i hetimeve paraprake nuk drejton procedimin si dhe nuk disponon të drejta të cilat mund t’i ushtrojë me pavarësi përse i përket marrjes së provave, por kufizohet vetëm të vendosë në rastet e parashikuara nga ligji dhe mbi bazën e kërkesës së prokurorit dhe të palëve private. Gjyqtari i Hetimeve Paraprake nuk kryen funksione hetimi, por vendos mbi bazën e kërkesave që mund t’i paraqiten nga ana e prokurorit, personit nën hetim apo personit të

⁴⁸ Në lidhje me caktimin e masave të sigurimit kompetent është edhe Gjyqtari i Seancës Paraprake (G.U.P), por vetëm në rastet kur kërkesa për caktim mase bëhet gjatë seancës paraprake.

dëmtuar nga vepra penale. Ndryshe, gjyqtari i hetimeve paraprake quhet dhe gjyqtar i cili nuk disponon fashikull (*giudice senza fascicolo*), pasi dosja e hetimeve paraprake mbahet dhe disponohet vetëm nga prokurori. Juridiksioni i gjyqtarit të hetimeve paraprake, nga ana tjetër, mund të përkufizohet si një *juridiksion garantues* i të drejtave të personit nën hetim apo tëpersonit të dëmtuar nga vepra penale përkundrejt kërkesave të paraqitura nga prokurori⁴⁹. Një moment i rëndësishëm kur nderhyn gjyqtari i hetimeve paraprake është dhe rasti i sigurimit të provës (*incidente probatorio*). Kështu, gjatë fazës së hetimeve paraprake, prokurori dhe personi nën hetim mund të kërkojnë sigurimin e provës si në vijim: a) në marrjen e dëshmisë së një personi kur ka arsye të bazuara se nuk mund të merret dëshmia e tij në gjykim për shkak të paaftësisë apo ndonjë pengesë tjetër të rëndë shëndetësore; b) në marrjen e dëshmisë së një dëshmitari, kur ka arsye të bazuara se ky i fundit mund të jetë objekt dhune, kanosjeje apo kur mund t'i ofrohet ndonjë shpërblim në të holla; c) në ballafaqimin midis disa personave të cilët në një seancë të mëparshme të sigurimit të provës kanë kryer deklarime kontradiktore midis tyre; d) në kryerjen e një ekspertimi apo të një eksperimenti gjyqësor, në rast se veprimet e sipërcituara kanë për objekt persona apo vende gjendja e të cilëve mund të jetë objekt ndryshimi të pakthyeshëm.

Gjyqtari i hetimeve paraprake dhe gjyqtari i seancës paraprake mund të zgjidhej nga radhët e gjyqtarëve të gjykatës së zakonshme të cilët kishin së paku dy vjet eksperiencë pune si gjyqtarë të zakonshëm (*giudice del dibattimento*⁵⁰). Gjykatat e zakonshme të cilat përbëhen nga seksione të ndryshme, duhet të kenë të paktën një seksion të gjyqtarëve të ngarkuar për dhënien e

⁴⁹Disa autorë e përkufizojnë këtë gjyqtar jo si gjyqtar të hetimeve paraprake por si gjyqtar për hetimet paraprake, në kuptimin që është organi garantues i veprimeve të kryera në përputhje me ligjin nga ana e prokurorit. Kërkesa të paraqitura nga ana e prokurorit mund të jenë kontrollet, përgjimet, hapja e korrespondencës etj.

⁵⁰ *Giudice dibattimentale* është gjyqtari i themelit.

vendimeve në fazën e hetimeve paraprake dhe për seancën paraprake(neni 46 paragrafët 3 e 5 të Rregullores së Gjyqësorit).

Gjykatat të cilat janë të ndara në seksione duhet patjetër të përfshijnë një seksion të gjyqtarëve të cilët duhet të merren me marrjen e masave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për fazën e hetimeve paraprake dhe për seancën paraprake.Në këtë sesion mund të përfshihen edhe më pak se 5 gjyqtarë.(neni 46,paragrafi 3 dhe 5 i rregullores së gjyqtarëve).

Sipas doktrinës italiane është përcaktuar që juridiksioni i ushtruar nga gjyqtari i hetimeve paraprake ka këto karakteristika:

a) juridiksion pa veprim, sepse në fazën e hetimeve paraprake dhe në rastin e kërkesës për arkivim (pushimin e akuzës ose çështjes) edhe pas përfundimit të tyre ajo ushtrohet kur prokurori nuk e ka nisur procedimin penal. Dihet që prokurori e dërgon çështjen në gjyq vetëm kur në përfundim të hetimeve paraprake vlerëson që i ka mbledhur të gjitha elementet e duhura për të ngritur akuzën .Ai i kërkon gjyqtarit të hetimeve paraprake dërgimin e çështjes në gjyq ose në gjykatën e krimeve të rënda bashkë me fashikullin e hetimeve.

b) Një juridiksion gjysmë të plotë për shkak se gjyqtari i hetimeve paraprake nuk kryen një procedim dhe nuk disponon pushtet autonom për marrjen e provave por kufizohet vetëm në prononcimin(bazuar në nenin328,paragrafi 1.),që parashikon që gjyqtari i hetimeve paraprake vendos vetëm për ato masa që janë të parashikuara nga ligji,bazuar në kërkesën e prokurorit, të subjekteve private dhe personit të dëmtuar.

c) Një juridiksion që quhet garanci,sepse në bazë të kërkesës së subjekteve të lartpërmendur gjyqtari i hetimeve paraprake vendos përgjatë fazës së hetimeve paraprake në mbrojtje të të drejtave të personit në hetim dhe të personit të dëmtuar nga vepra penale,në përballje me

iniciativet dhe kërkesat e prokurorit dhe në mbyllje të hetimeve paraprake, në rast të kërkesës për pushimin e çështjes prononcohet në funksion të garancisë të respektimit të parimit të detyrimit për procedim, për këtë arsye nga shumë studiues dhe ekspert të fushave të ndryshme është theksuar që ky gjyqtar është emërtuar nga ligji jo gjyqtar i hetimeve po për masat që merren në fazën e hetimeve paraprake.

Kjo ka ardhur për shkak se ai nuk kryen hetimet paraprake por kufizohet të ndërhyjë në raste të veçanta dhe të parashikuara kur kërkohet nga prokurori nga subjekti nën hetim dhe nga personi i dëmtuar. Kjo figurë e veçantë gjyqtari në fakt është përcaktuar të jetë një gjyqtar pa fashikull (dosje), sepse duke mos kryer asnjë veprim që përbejnë hetimet paraprake, ai nuk disponon një fashikull në të cilin gjendet gjithë dokumentacioni që mblidhet përgjatë fazës së hetimeve paraprake. Fashikulli i hetimeve paraprake mbahet vetëm nga prokurori. Një diskutim krejtësisht ndryshe bëhet për atë gjyqtar që i takon të mbajë seancën paraprake, gjyqtari ushtron këtë lloj kompetence pasi është ngritur nga prokurori kërkesa e tij për fillimin e procedimit penal, ndërkohë ai zhvillon një procedim të vetin dhe e ka tashmë një fashikull që i është dhënë nga prokurori në momentin që ka prezantuar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykatë.

Një ndër funksionet kryesore të gjyqtarit të hetimeve paraprake, dhe ndoshta me i rëndësishëm, është disponimi në lidhje me kërkesat për caktimin e masave të sigurimit gjatë hetimeve paraprake⁵¹. Kuptohet se kërkesa për caktimin e masave të sigurimit kryhet nga ana e prokurorit dhe vendosja e tyre bëhet me anë të vendimit (ordinanza cautelare) të gjyqtarit të hetimeve paraprake. Seanca e vleftësimit (*udienza di convalida*) zhvillohet në dhomën e këshillimit me pjesëmarrjen e detyrueshme të mbrojtësit të të arrestuarit apo të ndaluarit. Prokurori tregon arsyet e arrestimit apo ndalimit dhe i argumenton ato. Gjyqtari i hetimeve

⁵¹ Në lidhje me caktimin e masave të sigurimit kompetent është edhe Gjyqtari i Seancës Paraprake (G.U.P), por vetëm në rastet kur kërkesa për caktim mase bëhet gjatë seancës paraprake.

paraprake procedon me pyetjen e të arrestuarit apo të ndaluarit. Në rast se kostatohet se arrestimi apo ndalimi është kryer në mënyrë të ligjshme atëherë nxirret vendimi i vleftësimit të arrestimit apo ndalimit. Kundër vendimit (ordinanza di convalida) mbi vleftësimin ose jo të arrestimit apo ndalimit, prokurori apo i arrestuari apo i ndaluari mund të bëjnë rekurs në Gjykatën e Lartë. Në rast se kostatohet se arrestimi apo ndalimi nuk janë kryer në mënyrë të ligjshme atëherë nxirret vendimi i lirimit të menjëhershëm të të arrestuarit apo të ndaluarit. Vendimi për caktimin e masave të sigurimit duhet të jetë i bazuar në fakte dhe në ligj.

Një rast tjetër i ndërhyrjes së gjyqtarit të hetimeve paraprake gjatë fazës së hetimeve është dhe ai i përgjimeve telefonike. Në bazë të nenit 267 të k.p.p. të Italisë, prokurori (për veprat penale të kryera me dashje për të cilat ligji parashikon dënim me burgim të përjetshëm ose me burgim në maksimum mbi 5 vjet, apo për vepra të kryera në dëm të administratës publike për të cilat parashikohet dënim jo më i vogël në maksimum se 5 vjet) mund t'i kërkojë gjyqtarit të hetimeve paraprake autorizimin për përgjimin telefonik. Autorizimi jepet me dekret të motivuar në rastet kur ekzistojnë të dhëna të rëndësishme të cilat krijojnë dyshime arsyeshëm të kryerjes së veprave penale të sipërpërmendura. Dekreti duhet të tregojë mënyrat si dhe afatin kohor të kryerjes së përgjimit

3.3.2 Diskutimet mbi rolin dhe zgjerimin e funksioneve të gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin italian

Akuza, e kuptuar si atribuim ndaj një subjekti të një fakti të rëndësishëm penalisht, del nga përfundimi i një pune verifikimi dhe bazueshmërie e *notitia criminis*, e cila kërkon padyshim në

raste të përgjithshme një periudhë kohe të përshtatshme për hetimet paraprake , gjatë së cilës prania e një gjyqtari është thelbësore jo vetëm për shkak se hetimet përfundojnë duke prekur sferat e lirisë të garantuara me kushtetutë, por edhe sepse vendimi i prokurorit për të mos filluar procedimin ka një karakter juridiksionar dhe duhet të jetë gjyqtari që vendos nevojën për një gjykim mbi themelin.

Në nenin. 46 të ligjit italian për organizimin dhe funksionimin e sistemin gjyqësor parashikonte shprehimisht që: *“Në cdo gjykatë të zakonshme të përbërë në seksione, ngrihet një seksion gjyqtarësh përgjegjës për disponimet e parashikuara nga kodi i procedurës penale për fazën e hetimeve paraprake dhe për seancën paraprake”*⁵²

Gjyqtari i hetimeve paraprake është një figurë e veçantë e procedimit penal italian. Me kërkesë të palëve⁵³ ai ndërhyt në disa procedura të përcaktuara në fazën e hetimeve paraprake me qëllim që të sigurojë mirëfunksionim dhe ligjshmërinë e tyre duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të personit që i nënshtrohet procesit penal nëpërmjet kontrollimit të veprimtarisë së prokurorit dhe policisë gjyqësore. Në këtë mënyrë ai ushtron një juridiksion garancie. Kjo figurë është futur nga rendi juridik italian, procedural penal, me qëllim që të zëvendësonte figurën e një gjyqtari tjetër që quhej gjyqtari instruktur (giudice istruttore). Gjyqtari i hetimeve paraprake

⁵² Neni 7-bis i të njëjtit ligj përcakton kushte specifike për caktimin e detyrave të GIP, duke vendosur që ato mund t'u jepen vetëm magjistratëve që kanë kryer detyrat e gjyqtarit të themelit për të paktën dy vjet duke vendosur gjithashtu një afat kohor për kryerjen e këtyre funksioneve në gjashtë vjet rresht, me mundësinë e zgjatjes vetëm për procedurat në lidhje me përfundimi e akteve në process.

⁶Në KPP italiane ekziston një gjendje e procedurës në të cilën GIP është i detyruar të vendosë, si subjekt natyror i kërkesës së prokurorit për arkivimin e akteve, ndryshe nga çfarë ndodh në K.P.P tonë, e cila, siç do ta shohim më vonë, i jep këtë kompetence në gjyqtarit të seancës paraprake dhe vetëm në rastet kur procedohet për krime.

vepron në rastet e parashikuara nga ligji mbi bazën e kërkesave që i bën prokurori, personi nën hetim, viktima dhe palët private. Shembuj të thjeshtë në këtë drejtim mund të përmendim: kontrollin e kohëzgjatjes së fazës së hetimeve paraprake kur del me vendimin mbi ankesën e shtyrjes së afateve; marrjen e masave të sigurisë, revokimin, modifikimin ose zgjatjen me kërkesë të prokurorit ose të personit nën hetim të masave parandaluese (misure cautelari) të cilat ndikojnë në lirinë ose pasurinë e personit nën hetim; vendimin për konvalidimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit të realizuar nga oficerët e policisë gjyqësore ose prokurori etj. Gjyqtari i hetimeve paraprake ushtron në këtë mënyrë një funksion garantues të lirisë personale si dhe të kontrollit të legjitimitetit të të gjitha veprimeve të ngritura nga akuza. Në të vërtetë prokurori është titullar ekskluziv i akuzës penale dhe fazës së hetimeve paraprake, por legjislatori italian ka parshikuar mundësinë që për çdo fazë të procesit të kontrollohet dhe të apelohej te një organ gjyqësor i tretë dhe i paanshëm.

Gjyqtari i hetimeve paraprake nuk ka kompetenca të vetat për zhvillimin e hetimeve paraprake, por vepron vetëm në bazë të kërkesave të të interesuarëve, dmth një juridiksion gjysmë i plotë. Aktet juridike të tij janë të parashikuara në mënyrë taksative nga ligji dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e cila ka ndërhyrë në disa raste për të përcaktuar rastet kur ky gjyqtar mund të ndërhyjë gjatë hetimeve paraprake.

Gjyqtari i hetimeve paraprake në fakt nuk ka asnjë fashikull (dosje) në ndryshim nga gjyqtari i zakonshëm. Aktet që njih gjyqtari i hetimeve paraprake janë ato që zakonisht prokurori vendos që t'i bashkangjitet aktakuzës që ai paraqet. P.sh bashkë me kërkesën për vendosjen e një urdhëri prokurori vendos se cilat akte mund t'i bashkangjisë kësaj kërkesë, megjithatë prokurori duhet patjetër të bashkëlidhë të gjitha ato akte që tregojnë elementë që janë në favor të personit nën

hetim. Funkcionet dhe kompetencat që i janë dhënë gjyqtarit të hetimeve paraprake janë parashikuar dhe rregulluar në menyrë të tillë që ta garantojnë të dyshuarin në të gjithë fazën e hetimeve paraprake.

Është një sipërmarrje mjaftë e vështirë të përpiqësh të listosh rastet kur gjyqtari i hetimeve paraprake mund të thirret për të vendosur⁵⁴ por ndër masat më të rëndësishme që gjyqtari i hetimeve paraprake merr janë: vendimi për marrjen e një mase parandaluese mbi bazën e kërkesës së bërë nga prokurori; gjyqtari i hetimeve paraprake vendos ta pranojë ose jo kërkesën për pushimin e çështjes së bërë nga prokurori si edhe autorizimin për konvalidimin e mjeteve për marrjen e provës, për përgjimet telefonike, etj.

Ndërkohë është gjithashtu kompetent edhe për disa procedime të tjera si p.sh gjykimi i shkurtuar nëse hiqet dorë nga gjykimi i drejtëpërdrejtë, dhënia e dënimit mbi kërkesën e palëve (*pateggiamento*)⁵⁵ dhe gjykimi me marrëveshje (*decreto penale di condanna*)⁵⁶.

Neni 328 i Kodit të Procedurës Penale italiane i dedikohet pikërisht Gjyqtarit të hetimeve paraprake; ky nen është i përbërë nga tre paragrafe, por paragrafi më i veçantë është ai i pari: "*Nei casi previsti dalla legge, sulle richieste del pubblico ministero, delle parti private (che sono: l'imputato, l'indagato, il danneggiato dal reato, il responsabile civile per il fatto dell'imputato - cioè chi è chiamato a rispondere per la condotta posta in essere dall'imputato oggetto del*

⁵⁴ Gjykata Kushtetuese italiane ka nderhyre shpesh here per te percaktuar permbajtjen e veprimtarise se gjyqtarit te hetimeve paraprake, nder vendimet me te spikatura mund te permendim: Corte Costituzionale, vendim nr.496, dt.26.10.1990; Corte Costituzionale, vendim nr.241, dt.9-17 qershor.1999; Corte Costituzionale, vendim nr.502, dt.19-30 dhjetor.1991; Corte Costituzionale, vendim nr.371, dt.17.tetor-02.nwntor.1996. Corte Costituzionale, vendim nr.432, dt.6-15 shtator 1995.

⁵⁵ Gjykata Kushtetuese me vendimin e datës 20.05.1996 vendosi që nuk mund të disponoj aplikimin e dënimit me kërkesë të palëve GIP i cili ka urdhëruar një masë sigurie personale, apo e ka modifikuar, zëvendësuar ose revokuar atë, ose ka refuzuar një kërkesë për aplikim, modifikimi, zëvendësimi ose revokimi të kësaj mase. Duhet të konsiderohet se jashtë rasteve të ndërhyrjes në lirinë personale të të dyshuarit, G.I.P mund të vendosë për kërkesën për zbatimin e ndëshkimit të rënë dakord nga palët.

⁵⁶Siracusano et al. "*Diritto processuale penale*" ,Torino,Giuffrè editore,1996..

processo penale -, il civilmente obbligato per la pena pecuniaria - ossia chi è chiamato a risarcire i danni derivanti dal reato al danneggiato -) e della persona offesa dal reato (che è colei sulla quale ricade materialmente l'azione presuntivamente illecita dell'imputato), provvede il giudice per le indagini preliminari."

Dy paragrafët e tjerë specifikojnë rolin dhe funksionet e tij, duke iu referuar rasteve specifike të veprave penale, organeve, ndarjes së kompetencave etj. Por pyetja kryesore në këtë drejtim është: kur ndërhyt në mënyrë specifike gjyqtari i hetimeve paraprake?

Gjithsesi duhet thënë së pari që gjyqtari në fjalë ka raste edhe nuk ndërhyt fare ose nuk "thirret" në asnjë moment në gjithë fazën e hetimeve paraprake. Më këtë specifikoj që gjyqtari i hetimeve paraprake hyn "në lojë" me kushtin e vetëm dhe të domosdoshëm që një prej subjekteve të sipërpërmendur t'i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një kërkesë pasi nevojitet një gjykim mbi një procedurë ose ankesë, ose një veprim/leje për të proceduar: kjo do të thotë që, për t'i dhënë individit garanci, në fazën e hetimeve paraprake, një faze që është tepër delikate dhe e komplikuar, legjislatori ka parashikuar ndërhyrjen e një subjekti/organi të pavarur dhe të paanshëm, sic thuhet ndryshe "i tretë" ndërmjet akuzuesit (prokurorit) dhe të akuzuarit (I dyshuari, personi nën hetim).⁵⁷ Këtu nevojitet një tjetër sqarim pikërisht lidhur me konceptin dhe fazën e hetimeve paraprake.

57 Sipas autores M.Ferraioli në librin "Il ruolo di "garante del Giudice per le Indagini Preliminari". Terza edizione, "Cedam" 2006. Fq.69, Par.5: "Juridiksioni, si respektimi i formave, nënkupton dialogun midis mbajtësve të interesave të kundërta në ndjekjen penale të fakteve të paligjshme kriminale dhe garantimin e së drejtës së mbrojtjes para një gjyqtari i cili, nga ai dialog, duhet të nxjerrë arsyet e bindjes së tij, në mënyrë që të vendosë ndaj një kërkesë për konfirmimin apo jo të përgjegjësisë penale. Sa herë prokurori hap hetimin e tij për pjesëmarrje mbrojtëse, duke e vendosur veten në një pozitë kontradiktore në lidhje me ata që kanë interes liriye, kushtet për rëndësinë juridiksionale të një veprimtarie të tillë janë përmbushur. Nëse, atëherë, rezultati i veprimtarisë i nënshtrohet vlerësimit të një gjyqtari, garancitë juridiksionale janë në gjendje të shprehen në tërësinë e tyre."

Kjo quhet një fazë paraprake, instrumentale ku përcaktohet qëndrimi i një prokurori lidhur me ngritjen e akuzës ose jo ndaj një individi i cili akuzohet se është përfshirë në një rrethanë, veprim ose moseveprim me rëndësi nga pikëpamja penale, pra rreth një akti ose fakti që konsiderohet vepër penale.

Kuptohet që edhe individi i cili dyshohet të ketë kryer ose jo këtë vepër penale, ka të drejtën që t'i drejtohet një organi tjetër, i ndryshëm nga ai që e akuzon: një gjyqtar i hetimeve paraprake (GjHP), pikërisht për të mbrojtur veten e tij dhe pozicionin e tij ndaj kësaj rrethane.

Kuptohet gjithashtu që edhe organi i akuzës, prokurori e ka të nevojshme që ti drejtohet një organi të tretë, pra gjyqtarit të hetimeve paraprake, atëherë dhe sa herë që duhet t'i kufizojë individit të drejtat themelore kushtetuese, sidomos në lidhje me të drejtat themelore të lirisë personale, edhe në momentin kur nuk kemi një vendim fajësie të gjykatës mbi figurën e veprës penale për të cilën akuzohet.

Problematikat kryesore në këtë drejtim nuk janë me natyrë teorike por praktike.

Ato mund t'i vijëzojmë dhe përmbledhim si më poshtë:

Nevoja për t'iu drejtuar një organi të tretë dhe të paanshëm nga ana e legjislatorit është i drejtë, por praktika në këto vitet e fundit ka treguar që paanshmëria dhe pavarësia e këtij organi nuk është në nivel të kënaqshëm sidomos në Itali. Gjyqtari është dhe konsideron koleg me prokurorin, dhe nga pikëpamja morale dhe etike mund të bejnë gabime nëse nuk kushtëzohen nga sjellja deontologjike.

Sipas disa autorëve, paraqitet edhe këtu më se e domosdoshme përfshirja e tre gjyqtarëve, pra e një trupi gjykues dhe jo një, pasi tre mendohet që janë më të arsyeshëm dhe bëjnë më pak gabime se një. Kjo zgjidhje mbështetet shumë edhe me argumentin se gjyqtari i hetimeve paraprake duhet të lexojë dhe të studiojë qindra faqe vetëm dhe të arrijë në një konkluzion të

vetëm. Tendencat e fundit janë pikërisht për shtrirjen dhe zgjerimin e kompetencave të tij, si dhe për përfshirjen e më shumë kolegëve në fazën e hetimeve paraprake për rastet e vështira.

Gjithsesi, gjyqtari i hetimeve paraprake qëndron i tillë gjatë gjithë fazës së hetimeve paraprake.

Me mbylljen e hetimeve paraprake përfundon edhe roli dhe funksioni i gjyqtarit të hetimeve paraprake. Ky gjyqtar, atëherë kur është përfshirë në fazën e hetimeve paraprake, nuk mund të jetë nga pikëpamja institucionale gjyqtari i seancës paraprake (GUP) as gjyqtar themeli, apeli apo antarë në trupën gjykuese në Gjykatën e Kasacionit.

Nga ana tjetër, gjyqtari i hetimeve paraprake mund të jetë gjyqtar i seancës paraprake nëse ai është kufizuar në marrjen e masave të parashikuara nga ligji pa lidhje me vlerësime mbi themelin e ccështje, siç janë autorizimet shëndetësore, leja për takime, rivendosje në afat, deklarimi i ikjes ose disponimet në lidhje me sigurimin e provës⁵⁸.

Mund të pohohet se që gjyqtari "për" hetimet të mund të vazhdojë të merret me procedurën dhe të shprehë vlerësime "mbi" hetimet varet nga dy kushte: lloji i masës që duhet të merret dhe natyra e ndërhyrjes që ai ka provuar gjatë hetimit.

Kur flasim për gjyqtarin e hetimeve paraprake, ne i referohemi gjyqtarit që ndjek zhvillimin e hetimeve të prokurorit - duke miratuar masat e kërkuara nga vetë prokurori ose nga personi nën hetim ose nga viktimi – dhe të gjyqtari i cili, ka pa marrë masa në fazën e hetimeve, zhvillon

⁵⁸ Neni 34, paragrafët 2-ter dhe 2-quater, K.P. Penale italian. Neni në fjalë me titull "Papajtueshmëria e përcaktuar nga veprimet e kryera në procedurë" paraqitet si rregull që në vend të renditjes së rasteve individuale të papajtueshmërisë, shpall rastet e papajtueshmërisë në terma të përgjithshëm që lejon një interpretim të gjerë për të identifikuar situatat analoge përtej rasteve individuale të papajtueshmërisë të renditura

seancën paraprake, dhe të gjyqtari i cili, pasi hetimet kanë përfunduar, mbështet nismat e palëve që synojnë përfundimin e përsheptuar të procedurave penale.⁵⁹

Me përfundimin e hetimeve, përfundon procedura për hetimet paraprake, por jo mundësia e ndërhyrjes nga gjyqtari për hetimet paraprake, i cili menaxhon një pjesë të procesit të konstituuar për shembull, nga dënimi i zbatimit të penës të rënë dakord nga palët, o të dekretit të dënimit penal ose kryerjen e gjykimit të shkurtuar (pas heqjes dorë nga gjykimi i menjëhershëm)

3.4 Diskutimet mbi ecurinë e figures së gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe të gjyqtarit të seancës paraprake në legjislacionin kosovar

Kohët e fundit, jo vetëm në Kosovë, po shohim ndryshime të shpejta në legjislacionin e procedurës penale pothuajse në të gjitha shtetet e Europës Perëndimore. Këto ndryshime janë në drejtim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave individuale dhe përsheptimit të procedurës penale. Karakteristikë e këtyre ndryshimeve është nxjerrja e Kodit të Përkohshëm Penal dhe atij të Procedurës Penale të Kosovës⁶⁰, për herë të parë në vitin 2004 nga Parlamenti i Kosovës, me qëllim që sistemi gjyqësor të jetë më funksional në krahasim me atë që ishte sipas të sistemit të kaluar. Me fillimin e zbatimit të KPPK-së, filloi një qasje krejt ndryshe e rolit të organeve të Drejtësisë, Policisë, Prokurorive dhe Gjykatave, meqë u bë një kalim prej sistemit inkuizitor në atë akuzator.

⁵⁹ M.Ferraioli *“Il ruolo di “garante” del Giudice per le Indagini Preliminari”*. Terza edizione, “Cedam” 2006.

⁶⁰Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2003/26, të datës 06.07.2003 dhe ka hyrë në fuqi më datën 06.04.2004 KPPK është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-003, të datës 03.11.2008, për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

Një nga ndryshimet kryesore në këtë drejtim është pa dyshim figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake, roli dhe përcaktimi i pozitës juridike dhe rolit të veçantë të tij. Në legjislacionin kosovar ai emërtohet saktësisht gjyqtari i procedurës paraprake. Karakteristikë themelore në procedurën paraprake është se gjyqtari i procedurës paraprake, nuk ndërmer asnjë veprim ex officio, me ndonjë ndryshim deri diku të rëndësishme, por përherë sipas propozimeve të arsyeshme ligjore të prokurorit dhe palëve. Të gjitha këto raste duhet të jenë parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës në fuqi dhe në zbatim që nga data 1.01.2013. (Hulaj, Beqiri; 2015). Gjithsesi këto veprime të gjyqtarit të hetimeve kanë pa dyshim një rol të veçantë në vendoset për lirinë dhe sigurinë e individëve, për të drejtat dhe liritë themelore të personave, dhe saktësisht për kufizimet e këtyre lirive kushtetuese. Nga ana tjetër, edhe veprimet e prokurorit dhe ato të policisë gjyqësore, fitojnë një legjitimitet në këtë drejtim.

Bazuar nënenin 101 par. 4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, prokurori kur vendos që të nisë hetimet për rastin që i vjen pranë shqyrtimit e kallëzimit penal, atëherë kur në përmbajtje ekziston dyshimi i bazuar që ndaj të paraqiturit ekzistojnë elementet se e ka kryer një veprë penale, ai fillon veprime të caktuara dhe merr një vendim me shkrim mbi fillimin e fazës së hetimeve. Në këtë rast, një kopje të këtij vendimi i'a përcjell gjyqtarit të procedurës paraprake. Këtu është momenti fillestar ku gjyqtari njihet me rastin konkret. Në fakt ky akt ka një rëndësitëveçantë, pasi ky është momenti, pra data që do të llogaritet dhe kohëzgjatja e periudhës së hetimeve. Kështu që prokurori nëse nuk paraqitet e nevojshme në vijim të fazës së hetimeve, ka kohë gjashtë muaj nga dita e marrjes së këtij vendimi për të mbyllur fazën e hetimeve paraprake. Për zgjatjen e afatit të fazës së hetimeve paraprake nevojitet një vendim i gjyqtarit të procedurës paraprake (GJPP). Prokurori detyrohet gjithashtu që të njoftojë GJPP për shtrirjen

dhe zgjerimin e hetimeve bazuar në nenin 157 par. 5 KPPK si dhe me faktin e pezullimit të hetimeve në mbështetje të nenit 159 par.2 KPPK⁶¹. Në ato raste kur hetimet nuk kanë përfunduar brenda periudhës dy vjeçare nga data e fillimit të tyre prokurori ka detyrimin që të paraqesë një kërkesë me shkrim GJPP së bashku me arsyet e zgjatjes së hetimit⁶².

GJPP është një subjekt me rol dhe rëndësi të veçantë në procedurën penale kosovare, pra në radhën e subjekteve procedurale. Roli dhe pozita juridike e GJPP, kompetencat dhe autorizimet ligjore të përcaktuara mund të themi se janë një dëshmi e qartë e kësaj pozite në një fazë të avacuar të kontrollit të ligjshmërisë së veprimeve që ndërmerr policia dhe prokuroria gjatë fazës delikate të hetimeve paraprake.

Autorë të ndryshëm kanë theksuar se në këto pak vite aktiviteti i këtij organi (vetëm 3 vjet) mënyra e shfrytëzimit dhe aplikimit të masave është bërë një dukuri e zakonshme sidomos në kallëzimet penale në prokuroritë e Kosovës. Po ashtu kanë konsideruar se në situata të tilla ekziston arsyeshmëria (Hulaj - Beqiri). Momenti i fillimit të aplikimit të masave të fshehta për herë të parë në Kosovë është bërë në vitin 2004, pasi një gjë e tillë në rendin juridik Kosovar ka munguar. Instituti i gjyqtarit të procedurës paraprake edhe nga vetë emërtimi, roli dhe funksioni që i kanë dhënë paraqitet si një risi, një subjekt që balancon ligjshmërinë e kërkesave të palëve që Kodi Penal ua njeh. Ky institut hedh dritë mbi shumë rrethana dhe fakte të cilat me parë nuk gjenin terren të përshtatshëm për zbatim dhe shumë vepra penale ende sot e kësaj dite nuk janë zbardhur. GJPP paraqitet në legjislacionin aktual Kosovar një subjekt garantues të të drejtave themelore të përcaktuara me ligj për palët. Në këtë këndvështrim duhet theksuar se roli i GJPP është shndërruar në një rol shumë më pak aktiv gjatë procedurës së hetimeve paraprake, ndërkohë që është rritur roli dhe përgjegjësitë e palëve të tjera në këtë fazë.

⁶¹Në mbështetje të nenit 157 paragrafi 4 të kpk.

⁶²Nenin 159 paragrafi 2 i kpk.

Gjithsesi duhet theksuar se ashtu si dhe në vendet e tjera, e sidomos edhe në Itali, në pothuajse të gjitha rastet Gj.h.p firmosin kërkesat e sjella nga prokurorët duke i shndëruar këto kërkesa në puro formalitet. Kërkesat në radhë të parë duhet të jenë profesionale, të jenë shqyrtuar më parë nga vetë prokurorët dhe jo vetëm nga stafi mbështetës. Pra duhet evituar sidomos niveli i formalitetit të aprovimit.

KAPITULLI IV: LINDJA DHE NEVOJAT PËR KONSOLIDIMIN E FIGURËS SË GJYQTARIT TË HETIMEVE PARAPRAKE NË LEGJISLACIONI PROCEDURAL PENAL SHQIPËTAR.

4.1 Vështrim historik mbi figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake në legjislacionin procedural penal shqipëtar.

Në vendin tonë deri në vitet 1990 është zbatuar një sistem procedural i bazuar tërësisht në elementet inkuizitorial. Gjykata i siguronte provat pa bërë një administrim të drejtpërdrejtë të saj në seancën gjyqësore. Ajo mjaftohej vetëm me leximin e deklarimeve të dhëna në organet që merreshin me hetimet. Kjo ndodhë pas në një sistem të tillë mungon publiciteti dhe oraliteti, si dhe barazia e palëve para gjykatës, pra parimet themelore të procedurës penale.

Më pas me konsolidimin e shtetit demokratik, u miratua Kodi Procedural Penal i vitit 1995, i cili u orientua më tepër drejt sistemit akuzator në procedurën penale, duke njohur kështu barazinë e palëve në proces, parimin e oralitetit, pozicionin e gjykatësit, etj. Adoptimi i elementëve të sistemit akuzator në procedimin penal ka futur nocione të reja dhe ka sjellë ndryshime përsa i përket marrjes, vlerësimit dhe çmuarjes së provave. Të gjitha këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e parimeve të reja të cilat u sanksionuan në kod, si parimi i prezumimit të pafajësisë, pavarësia e gjykatës si dhe parime që do të trajtohen në vijim.

Përsa i përket hetimeve paraprake, ato synojnë gjetjen dhe fiksimin e provave materiale, të dokumentave dhe të sendeve që lidhen me veprën penale, të cilat e ruajnë vlerën e provës dhe në fazat e tjera të procedimit. Ndryshe nga sistemi inkuizitor prova nuk e merr vlerën e saj që në hetimet paraprake, por vetëm në debatin gjyqësor i cili i jep mundësi palëve të marrin pjesë

aktivisht në shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre. Roli aktiv i të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në debatin gjyqësor, sanksionon shkëputjen nga sistemi inkuizitor.

Në sistemin akuzator prova formohet në debatin gjyqësor. Mbledhja e provave në fazën e hetimit synon gjetjen dhe fiksimin e provave materiale, objekteve të ndryshme që gjenden në vendngjarje dhe lidhen me veprën penale, të cilat ruajnë vlerën e provës dhe në fazat e mëvonshme të procedimit. Këto të dhëna që mblidhen i paraqiten gjykatës për shqyrtim me qëllim që të marrin vlerën e provës. Barra e provës është ekskluziviteti i akuzës, i pandehuri mund të ofrojë prova për pafajësinë e vet, dhe roli i gjykatës është pasiv.

Sistemi akuzator garanton në një shkallë të lartë barazinë e palëve në procesin penal. *Në këtë sistem gjykata e fillon shqyrtimin gjyqësor me një njohje të përgjithshme të çështjes të bazuar në aktet që përmban fashikulli gjyqësor, ndryshe nga mënyra e procedimit në sistemin inkuizitor, ku ajo disponon të gjitha veprimet e kryera që në hetimet paraprake dhe bën vetëm verifikim e tyre*⁶³.

Kodi ynë Procedural, nuk mund të themi se ai ka tiparet e një sistemi të pastër akuzator. Sigurisht ai ka një natyrë mbizotëruese akuzatore e cila ka në thelb barazinë e palëve, rolin e debatit, etj., por ende ai ruan tipare të një kodi me sistem inkuizitor, sidomos lidhur me të drejtat e palëve dhe funksionet e gjykatës, sidomos në rolin aktiv që ajo merr referuar rasteve kur kryesisht vendos për marrjen e provave të reja, në pyetjet që shtron për zgjidhje eksperteve, në pyetjen e dëshmitareve, sidomos të personave të mitur etj. Pra, mund të themi se është një sistem i përzier, me tipare akuzatore dhe inkuizitore. Pra, me fjalë të tjera Kodi i Procedurës Penale ka më shumë karakteristikat e një sistemi procedural të një natyre mbizotëruese akuzatore, duke pasur parasysh barazinë në thelb, të palëve të procesit (Prokuror dhe i pandehur, rolin qëndror të

⁶³ Komentari i Kodit të Procedurës Penale, fq. 25.

debatit dhe oralitetin e tij, pozicionin e të tretit që mban gjykatësi të cilit i janë hequr të drejtat e hetimit dhe i janë dhënë ekskluzivisht të drejta vendimmarrëse mbi palët).

Ndërsa në Europë, ku ka lindur konflikti penal sistemi inkuizitor është përmirësuar vazhdimisht në drejtim të demokrtizimit dhe modernizimit të tij, duke u përshtatur me progresin e përgjithshëm dhe me legjislacionin ndërkombëtar të pranuar në Konventat dhe aktet e tjera ligjore. Përmirësime të rëndësishme janë bërë veçanërisht në zbutjen e diferencave midis palëve, sidomos gjatë hetimit paraprak ,në rritjen e rolit të mbrojtësit të të pandehurit dhe në forcimin e debatit në gjykim. Me këto ndryshime dhe përmirësime është krijuar i ashtuquajtur “sistemi inkuizitor i garantuar”, i cili siguron realizimin e të drejtave të individit në procesin penal. Prirja për t’u mbështetur në sistemin akuzator rrjedh nga tendenca e përgjithshme e zhvillimit demokratik të shoqërisë shqiptare, nëpërmjet rritjes së personalitetit dhe të dinjitetit të individit.

I bazuar në sistemin akuzator, Kodi i ri ndryshon rrënjësisht mënyrën e zhvillimit të hetimit paraprak dhe vlerën e të dhënave të grumbulluara nga organi procedues. Të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit paraprak formohen si provë vetëm kur administrohen në debatin gjyqësor. Hetimet paraprake nuk arrijnë në formimin e provës, por i japin mundësi prokurorit të marrë informacion për provat e akuzës dhe të përpilojë aktet për rrethanat dhe faktet që nuk mund të përsëriten (kontrollimet, sequestrimet, përgjimet etj). Fashikulli që i paraqitet gjykatës nga prokurori përmban vetëm aktet kryesore dhe ato pak prova që lejohet të merren nga prokurori dhe Policia Gjyqësore, në rastet e parashikuara në Kod.

Në sistemin akuzator merr rëndësi të veçantë debati në shqyrtimin gjyqësor. Debati është shprehje e parimit të kontradiktoritetit, në bazë të të cilit mbledhja dhe paraqitja e provave bëhet nga palët, kurse gjykata drejton polemikën dhe zgjidh çështjen mbi bazën e provave të administruara në debat. Me fjalë të tjera ,ai që ngre një akuzë i parashtron gjykatës faktin mbi të

cilën bazon kërkesën si dhe provat për të vërtetuar këtë fakt, kurse pala tjetër ka të drejtë të kundërshtojë faktin dhe të paraqesë prova kundër këtij fakti.

Roli i palëve në debat është vendimtar. Janë ato që kërkojnë dhe paraqesin provat për të vërtetuar pretendimet e tyre ,që fillojnë pyetjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve të kërkuar prej tyre ,që debatojnë për vlerën e provës etj. Debati drejtohet nga gjykata , e cila ndërhyt sa herë që palët shkelin rregullat e debatit. Në Kodin e ri të Procedurës Penale është pranuar që gjykata të jetë me shumë se një arbitër, të ketë iniciativë në gjykim dhe, në raste të domosdoshme, të marrë edhe prova kryesisht. Në debatin e gjykimit zbatohet metoda gojore e administrimit të provave, duke proceduar në dëgjimin e drejtpërdrejtë të deklamimeve nga dëshmitarët, të pandehurit, ekspertët etj, si dhe në leximin e akteve dhe të provave të marra gjatë hetimit paraprak kur ato nuk mund të përseriten. Këto raste janë parashikuar në nenet 369 dhe 370 të Kodit të Procedurës Penale,ku tregohen edhe rregullat si bëhet ky lexim.

Me fjalë të tjera, ndryshimi i sistemit procedural kërkon të ndryshojë konceptet, mendesitë dhe praktikatat e vjetra, të formohen koncepte të reja bashkëkohore për vendin dhe rolin e pushtetit gjyqësor, për nevojën e demokratizimit të mëtejshëm të procedimit penal.

Ndërhyrja e gjykatës bëhet me kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit, paditësit dhe të paditurit civil vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Është fjala për miratimin apo konvalidimin nga gjykata të disa akteve proceduriale si edhe për shqyrtimin e ankimeve ndaj akteve të marra nga prokurori gjatë hetimeve paraprake. Kështu, masat e sigurimit, kontrollimet, sekuestrimet e përgjimet caktohen nga gjyqtari me kërkesën e prokurorit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të ankohen në gjykatë për kohëzgjatjen e paraburgimit dhe zgjatjen e

afateve të hetimit paraprak nga prokurori. Viktima mund të ankohet në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin ose pushimin e procedimit penal.

Kërkesat e prokurorit për miratimin nga gjykata të akteve më të rëndësishme dhe shqyrtimi i ankimeve në gjykatë kundër akteve të prokurorit, bëhen në gjykatën që ka kompetencën lëndore dhe tokësore për gjykimin e çështjeve penale, në të cilat përfshihen këto akte.

Para ndryshimeve të bëra me ligjin 35/2017 ato shqyrtoheshin nga gjyqtari i caktuar për çdo rast konkret dhe jo nga gjyqtari i ngarkuar vetëm me këtë detyrë, që tashmë legjislacioni procedural e quan “ gjyqtari për hetimet paraprake”, i cili ka të drejtë të vendosë për kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake. Figura procedurale e një gjyqtari të tillë ka qenë dhe është e diskutueshme dhe përgjithësisht ajo kritikohet me arsyetimin se ai bëhet si pjesë e krahut të ndjekjes penale dhe i interesuar për mënyrën e përfundimit të hetimeve. Prandaj, zgjedhja që ishte bërë bërë në Kodin tonë të Procedurës Penale konsiderohej më e pranueshme parimisht dhe plotësisht e përshtatshme për kushtet e vendit tonë me ndarje territoriale të vogla, ku një gjyqtar i tillë supozohej se nuk do të kishte ngarkesën e nevojshme në punë.

Me ligjin nr 8813, datë 13.06.2002, në nenin 278 u shtua një paragraf me këtë përmbajtje : *“Të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”*. Ky përcaktim nuk ishte i saktë, së pari sepse nuk është fjala për shqyrtimin e veprimeve, por të kërkesave, të cilat mund të jenë edhe të pandehurit apo të viktimës si dhe të palëve të tjera private. Kritikat e këtij niveli bënë të mundur që ligjvënsi të reflektoj dhe me ligjin 35/2017 të riformuloj edhe këtë dispozit duke nxjerr në pah për herë të parë figurën e gjyqtarit të hetimeve paraprake. Pas ndryshimeve të raportuara nga ligji 35/2017 paragrafi i tretë i nenit 278 përcakton se: *“Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata. Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1, të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.”* Në këtë mënyrë dispozita në fjalë është më

gjithpërfshirë dhe garanton të drejtat e palëve që kanë një interes në zgjidhjen e çështjes që ti drejtohen një subjekti të tret kundër objektit të gjykimit I cili në dialektikën midis tyre të vendos mbi kërkesën që i parashtrohet.

4.2 Rëndësia e fazës së hetimeve paraprake

Hetimet paraprake janë faza e parë dhe shumë e rëndësishme e procedimit penal dhe shërbejnë si premisa për zhvillimin e mëtejshëm të tij. Në këtë fazë zgjidhen një varg problemesh të procedimit penal, si fillimi i procedimit, caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës, merren provat që nuk mund të përsëriten, kryhen kontrollime, sekuestime dhe përgjime, bëhen këqyrje, eksperimente dhe eksperimentime, grumbullohen të dhënat e nevojshme për përcaktimin e veprës penale dhe individualizimin e atij që ka kryer veprën⁶⁴.

Hetimet paraprake kryhen nga prokurori dhe Policia Gjyqësore, në përputhje me kompetencat e caktuara në Kodin e Procedurës Penale në bazë të nenit 25 të Kodit të Procedurës Penale, funksionet e prokurorit në hetimet paraprake ushtrohen nga prokuroret pranë gjykatave të shkallës së parë.

Sic është theksuar më sipër ekzistonte një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në bazë të paragrafit 3 të nenit 277, të shtuar me ligjin 8813, datë 13.06.2002, “Për veprat penale që gjykohen në shkallë të parë nga Gjykata e Lartë, procedohet nga Prokuroria e Përgjithshme por kjo dispozitë u shfuqizua me ligjin 35/2017 duke u hequr kështu përfundimishtë juridiksioni villeshtarë në Gjykatën e Lartë..

⁶⁴ A. Islami, A. Hoxha, I. Panda, “*Procedura penale*” 2007: fq.440

Prokurori ka rol të dorës së parë. Ai kryen vetë hetime dhe drejton e kontrollon Policinë Gjyqësore e cila, sipas nenit 277 të Kodit të Procedurës Penale, është në dispozicion të tij. Ai vihet në djeni për çdo vepër penale dhe ka kompetencë të disponojë për çdo gjë që lidhet me hetimet paraprake. Urdhrat dhe porositë e tij janë të detyrueshme për oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore. Ato jepen nga drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e tjerë. Urdhrat dhe porositë jepen me shkrim ose me gojë, sipas rastit dhe rëndësisë së tyre. Ai që do t'i zbatojë ka të drejtë të kërkojë që urdhri apo porosia të jepen me shkrim. Edhe pse në ligj nuk është parashikuar, kuptohet se çdo urdhër mund të ankimohet tek drejtuesi i prokurorisë, kurse urdhërat e këtij të fundit tek Prokurori i Përgjithshëm, por ankimi nuk e pezullon zbatimin e urdhërit.

Ka shumë rëndësi të kuptohet që bashkëpunimi i Prokurorisë me Policinë Gjyqësore është kusht i rëndësishëm për zhvillimin dhe përfundimin e suksesshëm të hetimeve paraprake. Ky bashkëpunim duhet të jetë konkret, i vazhdueshëm dhe efektiv. Ai mund të jetë i tillë vetëm kur prokurori informohet rregullisht dhe në kohë për veprimet e kryera nga Policia Gjyqësore, kur njihet në vazhdimësi me aktet e procedimit, i kontrollon ato dhe jep detyra konkrete për plotësimin e boshllëqeve dhe ndreqjen e të metave .

Janë të gabuara qëndrimet që e dëmtojnë këtë bashkëpunim, si në rastet kur prokurori hyn me vend e pa vend, duke penguar veprimtarinë me iniciativë të Policisë Gjyqësore, ashtu edhe kur ai qëndron larg saj dhe komunikon vetëm me shkresa dhe akte delegimi.

Veprimet hetimore të kryera nga prokurori dhe Policia Gjyqësore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë djeni për to. Por, në raste të veçanta, kur ruajtja e sekretit është e domosdoshme për vazhdimin e hetimeve, prokurori mund të urdhërojë që, për akte të caktuara,

sekreti të ruhet deri në përfundim të hetimeve, kur i pandehuri njihet detyrimisht me të gjitha veprimet e kryera gjatë hetimeve paraprake.

Në rekomandimet e Këshillit të Europës “Për Prokurorinë”, të datës 02.10.2000, theksohet detyra e Prokurorisë për kontrollin e ligjshmërisë së hetimeve të policisë dhe forcimin e bashkëpunimit midis tyre në plotësimin e detyrave të caktuara me ligj.

Vartësia e Policisë Gjyqësore nga prokurori dhe raportetmidis tyre janë normuar hollësisht në Kodin e Procedurës Penale, në ligjin “Për Policinë Gjyqësore” dhe nëudhëzimin e përbashkët të minisrtit të Rendit dhe Prokurorit të Përgjithshem, nr.23 datë 12.02.2003 “Për funksionimin e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe saksionin e Prokurorisë”.

Në nenet 30 dhe 33 të Kodit të Procedurës Penale janë sanksionuar rregullat e varësisë së Policisë Gjyqësore nga prokurori dhe konkretisht:

-Oficeri që shërben në Policinë gjyqësore përgjigjet para prokurorit për veprimtarinë e kryer prej saj gjatë procedimit penal. (neni33/1 k.p.p)

- Policia Gjyqësore kryen detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe e njofton atë menjëherë mbi rezultatin e tyre. (neni 33/2 k.p.p)

Në pikën 1 të udhëzimit të përbashkët saktësohet: *“Hetimet paraprake kryhen nga Policia Gjyqësore me inisiativë ose me urdhër të prokurorit. Veprimtaria e Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit realizohet nga shërbimet e ngritura në këtë polici. Në përputhje me sistemin e ri procedural dhe konventat ndërkombëtare, në nenin 278 të Kodit të Procedurës Penale është pranuar kontrolli i gjykatës mbi hetimet paraprake,si garanci për zbatimin e lirive dhe të të drejtave të individit në këtë fazë të procedimit.”*

4.3 Konsiderata introductive mbi vepritarinë me iniciativën e policisë gjyqësore

Objektivi që kërkon të arrij ligjënsi është zhvillimi i një hetimi të unifikuar nën drejtimin e prokurorit. Ky objektivi nxirret nga detyrimi i prokurorit dhe pol.gjyq të zhvillojnë hetimet ‘brenda kompetencave të caktuara’. Vlera e togëfjalëshit ‘kompetenca të caktuara’ nxirret nga normimet dhelbëzore që rregullojnë raportet midis dy organeve.

Pol.Gjyq është një subjekt i vecant i procedimit penal, me rol⁶⁵ dhe funksione të përcaktuara⁶⁶ të cilat ushtrohen sidomos në fazën e hetimeve paraprake.

Edhe pse prokurori rezulton të jetë titullar/*dominus* i hetimeve paraprake pol.gjyq ka një autonomi të qartë dhe të padyshimtë e cila deduktohet nga dispozitat që përcaktojnë ushtrimin e aktivitetit të pol gjyq me iniciativën e vet. “Autonomia e ushtrimit të funksionit hulumtues nuk mund të përkthehet në autonomi funksional pas qëndron gjithmonë në ngarkim të pol.gjyq detyrimi për të vënë në dispozicion të prokurorit gjithë veprimtarinë e kryer me iniciativën e saj dhe ajo asnjëherë nuk mundet që në përfundim të hetimeve të ngrej dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq në emër të shtetit.

Parimisht pol.gjyq mund të përmbush të gjitha veprimet e nevojshme të tipizuara apo jo të përcaktuara në Pjesën e Parë të K.P.P ajo me iniciativën e saj mund të përmbush vetëm ato që Kreu IV Titulli VI normon.⁶⁷ Gjithë veprimtaria e zhvilluar gjatë hetimeve paraprake që nuk

⁶⁵ Neni 30, k.p.p Funksionet e policisë gjyqësore “1. Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dënimin për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. 2. Policia gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori. 3. Funksionet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, të këtij neni, kryhen nga oficerët policisë gjyqësore. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë statusin e oficerit të policisë gjyqësore”.

⁶⁶ Neni 277 pika 1 k.p.p: “...policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale”

⁶⁷ Neni 294/a Veprimet simuluese; Neni 294/b Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal; Neni 294/c Dorëzimi i kontrolluar; Neni 299/a Ruajtja e përsheptuar dhe mirëmbajtja e të dhënave kompjuterike; Neni 299/b Ruajtja e

është disiplinuar në Kreun e IV K.P.P, titulluar: “*Veprimtaria me iniciativë e policisë gjyqësore*” janë veprime që mund të kryhen vetëm me autorizim apo urdhërim paraprak të prokurorit.

Njoftimit mbi faktin që përbën veprë penale merret zakonisht nga pol.gjyq, e cila duhet të zhvilloj verifikimet e nevojshme, dhe sapo të ket rindërtuar edhe vetëm në linja të përgjithshme, një fakt penalisht të rëndësishëm, duhet të informoj zyrën e prokurorisë pranë së cilës qëndron regjistri i shënimit të veprave penale⁶⁸. Kufizimi i kohës së ndërhyrjes së prokurorit në fillim dhe që në rastin e verifikimeve të ngutshme në vend, nuk duhet të shihet si një tentativ për të ‘mbytur’ veprimtarinë me iniciativën e pol.gjyq, por si një mundësi për të bërë efektive varësin funksionale kundrejt autoritetit gjyqësor. Ka qen gjithnjë prezente nevoja për të mos mbajtur largë për një kohë të gjatë kontrollin e pol.gjyq nga zyra e prokurorit, për të evituar tejkalimin e pushtetit ose kryerjen e veprimeve të drejtuara jo vetëm në individualizimin dhe marrjen e burimeve të provës, por edhe në verifikimin e besueshmërisë së tyre.

Për të përbushur të dyja nevojat e mësipërme u studjua një zgjidhje që respekton detyrat institucionale të pol.gjyq dhe lejon prokurorin magjistrat të drejtoj efektivisht hetimet.⁶⁹

Me marrjen dijani për veprën penale, pol.gjyq duhet ti komunikoj prokurorit elementet thelbësorë të faktit dhe elementet e tjerë të mbledhur, duke i treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera. Detyrimi bie mbi cdo njoftim pavarësisht mënyrës se si e është marrë, agjenti ose oficeri i pol.gjyq duhet të njoftoj me shkrim prokurorin magjistrat ‘pa vonesë’ por jo më

përshpejtuar dhe zbulimi i pjesshëm i të dhënave kompjuterike megjithëse gjenden në Kreun e IV K.P.P, titulluar: *Veprimtaria me iniciativë e policisë gjyqësore*, janë veprime që mund të kryhen vetëm me autorizim paraprak të prokurorit.

⁶⁸ Neni 287 pika 1 k.p.p “*Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale*”

⁶⁹ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.525.

vonë se 72 orë dhe në rastin e urgjencës dhe për krime të rënda njoftimi me shkrim duhet të paraprihet nga një njoftim i menjëhershëm me gojë.⁷⁰

Sigurimi i burimeve të provave⁷¹ konsiston në veprimtarinë me iniciativën e policisë gjyqësore edhe pas referimit të veprës penale te prokurori dhe është indikator i qartë i mosvarësisë tërësore të pol.gjyq nga urdhrat apo direktivat e prokurorit .

Është e qartë se në kuadrin e në kuadrin e ushtrimit të detyrës ‘parandaluese’ të veprave penale⁷² veprimtaria e pol.gjyq kryhet me iniciativën e vetë, veprimtari e cila vazhdon e nuk ndërpritet edhe me marrjen dijeni të veprës penale e kështu pas kryerjes së saj duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit.

Pasi ka përcaktuar në mënyrë të përgjithshme veprimet që pol.gjyq duhet të kryejë pasi ka ndodhur vepra penale, ligjvënësi sipecifikon drejtimet kryesore në të cilat organi procedues në fjalaë duhet të orjentohej. Ecanërisht ajo orjentohej në kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe gjurmëve të veprës penale, në ruajtjen e vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo është e domosdoshme. Po ashtu pol.gjyq drejtonë veprimtarinë e sajë në identifikimin dhe më pas pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, jo vetëm për sa i përket rindërtimit llogjik dhe kronologjik të faktit për të cilin ka filluar procedimi por edhe për të shmangur pasojat e mëtejshme apo për të penguar lehtësirat e mundshme të kryerjes së veprave penale të tjera. Autonomia e veprimtaris së pol.gjyq e

⁷⁰ Në bazë të nenit 293 k.p.p vec njoftimit me gojë, Brenda 72 orëve pol.gjyq është e detyruar të referoj me shkrim “elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit” si dhe ditën, orën dhe vendin ku ka ndodhur ngjarja.

⁷¹ Neni 294 k.p.p, Sigurimi i burimeve të provave “1. Edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit. Ajo procedon sidomos: a) për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme; 163 b) për kërkimin dhe pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit; c) për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese. 2. Pas ndërhyrjes së prokurorit, policia gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, si dhe kryen me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës. 3. Kur kryen veprime që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, me iniciativën e saj ose të deleguara nga prokurori, policia gjyqësore mund të caktojë ekspertë, të cilët nuk mund të refuzojnë detyrën e ngarkuar, pa shkaqe të ligjshme”

⁷² Neni 17, pika 1 shkronja b, e ligjit LIGJ Nr. 108/2014 ” Për policinë e shtetit”

disiplinuar në këtë mënyrë mund të orjentohej në pista të tjera apo kanal të dyfishtë të hetimeve që sidoqoft duhet të orjentohej në të njëjtin drejtim me hetimet e kryera nga prokurori dhe nuk mund të jenë të kundërta e të papërputhura.⁷³

Në të gjitha rastet “...kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore⁷⁴” ligji lejon poli.gjyq që me iniciativën e vetë të caktoj një ekspert⁷⁵ i cili edhe pse më pas duhet të shpreh mendimin e tij në seancë gjyqësore⁷⁶ shërben për poli.gjyq si burim prove duke e siguruar atë në dispozicion të prokurorit.

Në kuadër të aktivitetit **të identifikimit të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet** poli.gjyq “...kryen të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë edhe rievimet daktiloskopike, fotografike dhe antropometrike⁷⁷” si dhe “Kur ai refuzon të identifikohet ose jep gjeneralitete apo dokumente identifikimi që dyshohet se janë të rreme, policia gjyqësore e shoqëron në zyrat e saj dhe e mban atje për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin, por jo më tepër se dymbëdhjetë orë⁷⁸”

Pol gjyq nuk mundte që me iniciativën e vetë në kuadër të nevojës për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, te ndër marr masa mjekësore apo marrjen me detyrm të

⁷³ Ligji i jep në dorë prokurorit mundësinë për të shmangur cfardolloj papërputhshmërie apo paralelizmi të hetimeve nga ana e poli.gjyq. Neni 33 pika 2 k.p.p përcakton se “Policia gjyqësore kryen detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe e njofton atë menjëherë mbi rezultatet e tyre”, ndërsa L I G J Nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” në nenin 4 përcakton se “ Në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të saj, policia gjyqësore është në varësi dhe drejtohet e kontrollohet nga prokurori”

⁷⁴ Neni 178 k.p.p

⁷⁵ Neni 294 pika.3 k.p.p.

⁷⁶ Neni 366 k.p.p.

⁷⁷ D.Lara në veprën “Koment mbi Proceduren Penale” Botimet Morava, Tiranë 2019 në fq 945 shprehet se: “ ... në të drejtën procedural penale, rievimi përfaqëson tërësinë e veprimeve që arrijnë deri në paraqitjen në letër apo në çfarëdolloj mbajtëse tjetër (për shembull, në procesverbal, fotografi apo planimetri) të vendit, sendeve dhe gjurmëve të veprës penale, e përmbushur nëpërmjet kërkimit, njohjes, fiksimit, grumbullimit dhe marrjes së të dhënave, me qëllim sqarimin, i përmbushur me studim, rindërtim, rivlerësim apo krahasim”

⁷⁸ Neni 295 pikat 2 dhe 4 k.p.p.

kampionëve biologji pasi këto veprimtar mund të kryhen vetëm me iniciativën e prokurorit i cili nëse e sheh të arsyeshme paraqetë kërkesë gjyqtares të hetimeve paraqetë.⁷⁹

Në kushtet kur legjislativi jonë penal ka njohur edhe përgjegjësinë penale të personave juridik, pol.gjyq me iniciativën e sajë mund të kryhej të gjitha veprimet e nevojshme edhe për identifikimin e tyre.

Ligjvënsi legjitimon oficerët e pol.gjyq që me iniciativën të **“marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet”** duke respektuar detyrimin për ta paisur atë me letrën e të drejtave si dhe të drejtën e subjekti për të qenë i asistuar nga mbrojtësi i tijë sidoqoftë i zgjedhur apo i ckatuar në këtë fazë nga prokurori.⁸⁰

Parashikohet mundësia e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet që të paraqitet vetë dhe të bëjë përpara pol.gjyq deklarime të pa nxitura nga pyetjet e kësaj të fundit nëpërmjet të cilave kërkon të provoj përpara këtij organi procedues shfaqësimet e tijë përkundrejt faktit objekt hetimi. Normohet se këto të dhëna *“nuk mund të përdoren në gjykim me përjashtim të rastit kur kundërshtohet përmbajtja e deklaramit të bërë para gjykatës”*⁸¹

Përjashtim nga rregulli që detyron pol.gjyq të marrë në pyetje në prani të mbrojtësit personi nën hetim, përbën rasti i parashikuar në pikën 2 të nenit 296 k.p.p i cili legjitimon pol.gjyq që *“Në vendin e ngjarjes ose menjëherë pas konstatimit të faktit oficerët e policisë gjyqësore, edhe pa praninë e mbrojtësit, mund të marrin nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, qoftë edhe i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar, të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimeve”* Të dhënat e marra në këtë mënyrë, në baz të përcaktimeve ligjore nuk mund të dokumentohen dhe aq më pak të përdoren në gjykim.

⁷⁹ Neni 295 pika 3 k.p.p *“Kur identifikimi përfshin marrjen e kampionëve biologjikë, policia gjyqësore procedon sipas nenit 201/a të këtij Kodi”*

⁸⁰ Pasi pranija e mbrojtësit gjatë këtij veprimi siguron rrespektimin e nenit 38 pika 2 k.p.p, që ka të bëjë me ndlimin e përdorimit të metodave apo teknikave, qoftë edhe me pëlqimin e personit nën hetim, që ndikojnë mbi lirinë e vullnetit apo ndryshojnë aftësinë e kujtesës të vlerësimit të fakteve.

⁸¹ Neni 296 pika 3 k.p.p.

Po ashtu normohet e drejta e pol.gjyq që me iniciativën e vet të marrë të dhëna nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, duke rrespektuar rregullat që vlejnë për pyetjen e dëshmitarit parashikuar në nenet 155 deri 160 k.p.p.⁸². Bie mbi personin e marrë në pyetje “detyrimi që tu përgjigjet me vërtetësi pyetjes që i bëhet pasi në të kundërt fakti parashikohet nga ligji si vepër penale.⁸³

Nëse personi që mund të tregojë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit është i mitur “sigurohet prania e prindit ose kujdestarit, ose e një personi të rritur, të zgjedhur nga i mituri, si dhe prania e psikologut”⁸⁴

Edhe pse në kushte të zakonshme pasi cënonë privatësinë dhe kufizonë lirinë personale urdhërohet nga gjykata⁸⁵, një tjetër veprim i një rëndësie të vecantë dhe që mund të kryhet me iniciativën e pol.gjyq është **kontrolli**.

Që të jetë i ligjshëm kontrolli me iniciativën e pol.gjyq nuk është e majftueshme vetëm gjendja e flagrancës apo ndjekja e personit që është duke ikur por kërkohet gjithashtu “arsye të bazuara të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin ose që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të 168 caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur”⁸⁶

Nga sa më sipër, si arsyet e vecanta të urgjencës ashtu edhe arsyet ashtu edhe arsyet e bazuara që bëjnë të mendohet se fshihen, zhduken apo humbasin sende apo gjurmë të veprës penale, duhet

⁸² Janë dispozitat që kanë të bëjnë me: (neni 155) Zotësia për të dëshmuar; (neni 156) Papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit; (neni 157) Detyrimet e dëshmitarit; (neni 158) Përrjashtimet nga detyrimi për të dëshmuar; (neni 159) Ruajtja e sekretit profesional; (neni 160) Ruajtja e sekretit shtetëror.

⁸³ Neni 305/ b, k.p Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore.

⁸⁴ Neni 297 pika 3 k.p.p.

⁸⁵ Neni 202 k.p.p, “Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale gjykata merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës”.

⁸⁶ Par. 1 i nenit 298 k.p.p.

të jenë pjesë integrale e process verbalit në të cilin tregohen veprimet e kontrollit të pol.gjyq objekt i vlerësimit të prokurorit⁸⁷.

Subjektet të kontrollit personal apo i vnedit a lokalit ku ata ndodhen janë; personi që kapet në kushtet e flagrancës; personi i ikur apo e thënë ndryshe i larguar nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm; personi i ndaluar si me urhër të prokurorit ashtu edhe me iniciativën e pol.gjyq; i hetuari ndaj të cilit është urdhëruar masa e sigurimit, arrest në burg, arrest në shtëpi apo shtrim i përkohshëm në spital psikiatrik; dhe personi i dënuar kur ndaj tij duhet të ekzekutohet një vendim dënimi.⁸⁸

Procesverbali i veprimeve të kryera i dërgohet menjëherë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontroll, i cili brenda brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson kontrollin dhe sekuestron eventuale, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara gjithmonë nëse sekuestrime për qëllim prove ka pasur gjatë kontrollit.⁸⁹

Pol.gjyq kur është fjala për **sekuestron e korespondencës apo të plikove** nuk ka asnjë kompetencë për ta vendosur atë por vetëm mund të pezulloj dërgimin dhe të njoftojë prokurorin.⁹⁰

⁸⁷ D.Lara “Koment mbi Proceduren Penale” Botimet Morava, Tiranë 2019

⁸⁸ Kontrolli, si në raste kur procedohet me vendim të gjykatës sipas nenit 202 k.p.p ashtu edhe kur procedon pol.gjyq me iniciativën e vetë sipas nenit 289 k.p.p nuk mund të kryhet nga agjentët e pol.gjyq por vetëm nga oficerët e pol.gjyq.

⁸⁹ Nenet 298 pika 4 dhe 301 pika 2 k.p.p, mosrespektimi i të cilëve nuk passjell pavlefshmërinë e veprimeve të kryera përveçse mund të përbëj shkeleje të disiplinës.

⁹⁰ Neni 299 Marrja e plikove dhe e korespondencës “1. Kur është e nevojshme për qëllimet e procedimit që të merren pliko të vulosura ose të mbyllura me ndonjë mënyrë tjetër, oficeri i policisë gjyqësore ia dërgon ato prokurorit të paprekura për sekuestro eventuale. Në qoftë se ka shkaqe të bazuara për të menduar se plikot përmbajnë të dhëna që mund të humbasin për shkak të vonësës, oficeri i policisë gjyqësore informon me mjetin më të shpejtë prokurorin, i cili mund të autorizojë hapjen e menjëhershme. 2. Për letrat, zarfet, pakot, vlerat monetare e pasurore, telegramet ose mjetet e tjera të korespondencës, për të cilat lejohet sekuestroja, oficerët e policisë gjyqësore, në raste të ngutshme, urdhërojnë atë që kryen shërbimin postar të pezullojë dërgimin. Në qoftë se brenda dyzet e tetë orëve nga urdhri i policisë gjyqësore prokurori nuk vendos sekuestron, objektet e korespondencës dërgohen në destinacion”

Oficerët dhe agjentët e pol.gjyq, në rastin e veprave penale të dukshme apo e thënë ndryshe në rastin e veprave penale me vendngjarje kanë të drejtën/detyrimin të kryejnë **verifikime të ngutshme në vend**.⁹¹ Në pjesën më të madhe të rasteve veprat penale me vendngjarje paraqiten ato me rrezikshmëri të lartë shoqërore që sit ë tilla detyrojnë pol.gjyq të njoftojë menjëherë prokurorin me gojë pa e përjashtuar nga detyrimi për ta njoftuar me shkrim.

Ehde në rast se prokuri ka njoftuar pjesëmarrjen fakti nuk përjashton nga detyrim pol.gjyq që të procedojë me fiksimin apo caktimin e palëvishëm dhe ruajtjen nga humbja apo prekja e sendeve dhe gjurmëve të vendngjarjes.

Në mungesë të prokurorit apo në vonesë të tijë kur kjo mund të sjell dëm hetimeve, lind e drejta e pol.gjyq për të procedojë me **sekustron provuese** kur provat material dhe sendet që lidhen me veprën penale janë të domosdoshme për verifikimin e fakteve. Sekuestro mund të vendoset simbi sendet e luajtëshme ashtu edhe mbi sendet e paluajtëshme të cilët më pasë u nënështrohen regjimit të vulosjes dhe ruajtjes disiplinuar nga nenet 214 deri 216 k.p.p.

Sekuestro provuese e vendosur nga pol.gjyq dhe e vleftësuar nga prokurori ka të njëjtat vlera me sekuestron e parashikuar në nenin 208 k.p.p. Normohet detyrimi i pol.gjyq të përpiloj procesverbalin e sekuestrimit duke elenuar shkaqet që cuan në një veprim të till dhe detyrimin për ti dhënë një kopjo personit që i sekuestrohen sendet.⁹²

⁹¹ Neni 300 Verifikimet e ngutshme në vend “1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë. 2. Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale.”

⁹² Neni 301 Vleftësimi i sekuestron “1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja”

Legjitimohet personi nën hetim dhe mbrojtësi i tijë, personi të cilit i janë sekuestruar sendet si dhe vetë pronari i sendit të ankimojë brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni, vendimin e prokurorit që vleftësonë sekuestrimin e sendeve nga pol.gjyq gjatë verifikimeve të ngutshme në vend. Ligji nuk ka disiplinuar ndonjë procedurë të vecantë për zhvillimin e gjykimit por ai duhet të zhvillohet me dyer të mbyllura, përpara gjyqtarit të hetimeve paraprake në prani të palëve duke u mbështetur në veprime shkresor dhe në procesverbalin e pol.gjyq që ka ekzekutuar sekuestrimin. Po ashtu kundër vendimit të gjyqtarit të hetimeve paraprake lejohet ankim në gjykatën e Apelit.

Pol.gjyq ka detyrimin që të **dokumentoj veprimet e kryera**, minimalisht nëpërmjet proceverbaleve, të gjitha veprimet e kryera me iniciativën e vetë apo të deleguara nga prokurori, qoftë në mënyrë të përmbledhu,r dhe kur është e mundur, aktet e kryera duhet të dokumentohen nëpërmjet rregjistrimit audio ose audioviziv. Përpara një disiplinim kompleks që siguronë detyrimin e plo.gjyq për te nxfotuar apo për të bër me dije të prokurori, cdo verpim që ajo merr me iniciativën e vet është e paarsyeshme dhe e palejuar mundësia e përmbushjes së vecuar dhe paralele. Duke konsideruar faktin se procesverbalet e kontrolleve apo verifikimeve të ngutshme në vend, ku në këto të fundit mund të përfshihen, fiksimi dhe ruajtja e vendit të ngjarjes, si dhe veprimet e nevojshme hetimore qe mund te kenë të bëjnë me grumbullimin, përcaktimin dhe përfitimin e të dhënave dhe treguesve që ndodhen në vendin e ngjarjes të domosdoshme për rileveimet, dhe sekuestrimeve provuese, duhet të depozitohen në sekretarinë e prokuroit brenda 3 ditëve nga bërja e tyre, atëherë behet edhe më eficient aktiviteti i mbrojtësit i cili edhe pa vënë

në lëvizje prokuroi ka të drejtë të shqyrtoj këto akte dhe të nxjerr kopjo të tyre ende pa përfunduar faza e hetimeve paraprake.⁹³

Nuk duhet të harrojmë që “*Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të ti*”⁹⁴ dhe se prokurori ... “*kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*”⁹⁵

4.4 Prokuroi si ‘dominus’ i hetimeve paraprake: shkurtimisht mbi veprimtarinë me iniciativën e tij

I angazhuar për të pasur rolin e kundërshtarit të të pandehurit, gjatë kontradiktoritetit në proces, prokurori përdor fazën e hetimeve paraprake për të mbledhur elementet e domosdoshëm që i përfaqësojnë gjyqtarit arsyet e akuzës së formuluar në ngarkim të të pandehurit.

Faza e hetimeve paraprake ka si qëllim parësor ti bëj të mundur prokurorit, titullar i pushtetit të veprimtarisë dhe *dominus* i kësaj faze, verifikimin mbi bazueshmërinë e ‘*notitia criminis*’ dhe për këtë qëllim është parashikuar se ai kryen “*çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm*” duke përfshirë edhe veprimet që materializohen në “*verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*”⁹⁶

Në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave institucionale që i janë atribuar, prokurori disponon pushtet të gjerë.

⁹³ Neni 309 k.p.p Caktimi dhe ndihma e mbrojtësit pika 3. “Procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe nga policia gjyqësore, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, depozitohen në sekretarinë e prokurorisë brenda tri ditëve nga kryerja e veprimit, me të drejtën për mbrojtësin që t’i shqyrtojë dhe të nxjerrë kopje.”

Neni 302 k.p.p Ndhimja e mbrojtësit “Mbrojtësi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet ka të drejtë të asistojë, pa pasur të drejtën që të lajmërohet që më parë, në kontrollimet dhe verifikimet e ngutshme në vend, përveç rasteve të hapjes së menjëhershme të plikos të autorizuar nga prokurori”.

⁹⁴ Neni 8/a pika 2 k.p.p.

⁹⁵ Neni 304 pika 1 k.p.p.

⁹⁶ Neni 304 pika 1 k.p.p.

Ka fakultetin të **delegoj policinë gjyqësore** – që mund të ngarkohet me kryeren e veprimeve hetimore të posaçme- ose mund të **delegoj që veprimi hetimor të kryhet nga një tjetër zyrë prokurorie** nëse veprimi duhet të kryehet jashtë kompetencës territoriale të gjykatës pranë se cilës prokurriushtron funksionet.

Kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore, **prokurori mund të caktojë ekspert** i cili nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të ligjshme pasi në të kundërt mban përgjegjësi penale.⁹⁷

Për më tepër **prokurori udhëron shoqërimin e viktimës ose të subjekteve të tjerë** që do të dëgjoj, pasi mund të jenë të aftë të referojnë të rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit: personi thirrur nuk mund ti shmanget ftesës.

Përsa i përketë lirisë personale, aim und të urdhëroj masën par-siguruese të ndalimit, nëse ekzistojnë kërkesat ligjore dhe mund ti kërkoj gjyqtarit aplikimin e masave të sigurimit.⁹⁸

Duke qen se viprimi që i jep impuls procedimit paraprak është marrja dijen për veprën penale detyrimi i parë që duhet të përmbush prokurori është **shënim në rregjistër i përmbajtjes së njoftimit** pasi prokurori mbanë përgjegjësi për afatin e hetimeve që sic e dimë nuk janë *sine die*. Është kjo arsyeja pse prokurori duhet të shënoj menjëherë në rregjister cdo njoftim për veprë penale që i vjen apo merr me iniciativën e vet dhe kontekstualisht apo nga momenti që rezulton edhe emrin e personit të cilit i aribuohet vepra penale.⁹⁹

⁹⁷ Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit “*Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit, pa shkaqe të arsyeshme ose mospranimi prej tyre për të kryer detyrat e caktuara nga organi i ndjekjes penale ose gjykata, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.*”

⁹⁸ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010.

⁹⁹ Regjistrimi nuk është i pandrshueshëm pasi mund të ndodhë gjatë zhvillimit të hetimeve të ndryshoj cilësimi ligjorë i faktit apo rrethanat në të cilat ai ka ndodhur. Në këtë rast nuk bëhet një regjistrim i ripor përditësohet regjisstrimi.

Sepse është i lejuar të përfitoj cdo lloj prove – të tipizuar apo jo të rregulluar me ligj- që jep njohje mbi faktin penal dhe autorin e mundshëm, prokurori është i lejuar të përdor për të kërkuar e përfituar ato, përvecse të mjeteve tipike sic qyryja, kontrolli, sekuestro, përgjimet, inviltirimi dapo dorëzimi i kontrolluar, edhe cdo veprim apo instrument tjetër që nga ligji nuk është rregulluar.¹⁰⁰

Veprimet e marrjes në pyetje dhe ato për të cilat kërkohet me domosdo prezenca e të hetuarit sic mund të jetë qyryjet apo ballafaqimet, janë veprime hetimore që kërkojnë prezencën e detyrueshme të mbrojtësit dhe për këtë *“I pandehuri që nuk ka mbrojtës njoftohet nga prokurori se ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar kryesisht...”*¹⁰¹. Mungesa e mbrojtësit në raset kur me ligj mbrojtja është e detyrueshme passjell pavlefshmërinë absolute të veprimit të kryer sipas nenit 128/a k.p.p , ndaj **“organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të.”**¹⁰²

Neni 309 pika 3 normon se *“procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe nga policia gjyqësore, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, depozitohen në sekretarinë e prokurorisë brenda tri ditëve nga kryerja e veprimit, me të drejtën për mbrojtësin që t’i shqyrtojë dhe të nxjerrë kopje”* . Është detyrim i organit procedues të depozitojë procesverbalet e veprimve në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë në sekretarinë e prokurorit por ligji nuk parashikon ndonjë detyrim njoftimi për depozitimimin e tyre ndaj është mbrojtësi që duhet të interesohet pranë

¹⁰⁰ D.Lara *“Koment mbi Proceduren Penale”* Botimet Morava, Tiranë 2019.

¹⁰¹ Neni 304 pika 1 k.p.p.

¹⁰² Neni 49 pika 1 k.p.p, Mbrojtja e detyrueshme *“1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur: a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç; b) nuk dëgjon dhe nuk flet; c) është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes; 35 ç) është akuzuar për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim; d) akuzohet për një vepër penale, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi; dh) është deklaruar i ikur ose në mungesë, me vendim gjykate; e) merrret në pyetje personi i arrestuar ose i ndaluar; ë) në rastet e parashikuara nga paragrafi 5, i nenit 205, ose paragrafi 1, i nenit 296, të këtij Kodi; f) në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.”*

sekretarisë së prokurorit. Duke qën se behet fjalë për veprime hetimore në të cilat i pandehuri dhe mbrojtësi kanë të drejtë të asistojnë do të thotë se veprimet hetimore nuk janë më sekrete pasi i pandehuri duhej të kishte marrë dijeni për to dhe gjen zbatim neni 105 k.p.p “*gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.* Megjithëse mbrojtësi nuk duhet të pengohet të njihet me procesverbalet e mbajtura gjatë kontrollit ushtruar me iniciativën e pol.gjyq, gjatë verpimeve të ngutshme në vend apo dokumentimet e veprimeve të prokurorit në të ilat prezenca e mbrojtësit është e detyrueshme, kjo nuk e shmang ndalimin e publikimit të akteve të kryera gjatë hetimeve paraprake.

“Prokurori, **kur do të kryejë kontroll ose sekuestrim** njofton të pandehurin që të jetë i pranishëm së bashku me mbrojtësin e zgjedhur dhe, kur nuk e ka këtë, cakton një mbrojtës kryesisht.”¹⁰³

Edhe pse nga përmbajtja e dispozitës kuptohet se kontrollet dhe sekuestrimet e urdhëruara nga prokurori nuk karakter urgjent dhe befasues, për të bër të mundur këtë, nëse do ishte e nevojshme, ligjvënsi nuk ka parashikuar as afat për njoftimin e mbrojtësit dhe të pandehurit dhe as objektin e njoftimit.

Në referim të nenit 311 k.p.p¹⁰⁴ dhe të pikës 5 të nenit 167 k.p.p¹⁰⁵ prokurrit i është dhën atributi të marrë në **pyetje të pandehurin në një procedim të lidhur** pavarësisht nëse personi në procedimin e lidhur po të pabashkuar ka statusin e të pandehurit apo të hetuarit.

Procedimi quhet i lidhur *kur vepra penale për të cilën zhvillohet procedimi është kryer nga disa persona në bashkëpunim ndërmjet tyre ose kur disa persona në mënyrë të pavarur kanë*

¹⁰³ Neni 310 pika 1 k.p.p

¹⁰⁴ Neni 311 k.p.p 1. “Personi i marrë si i pandehur në një procedim të lidhur merret në pyetje nga prokurori në format e parashikuara nga neni 167.”

¹⁰⁵ Neni 167 pika 5 k.p.p “Dispozitat e paragrafëve të mësipërm zbatohen edhe gjatë hetimit paraprak ndaj personave të marrë si të pandehur për një vepër penale të lidhur me atë për të cilën procedohet”.

*shkaktuar veprën; kur një person akuzohet për disa vepra penale; kur një person akuzohet për disa vepra, nga të cilat një pjesë janë kryer për të realizuar ose për të mbuluar të tjerat ose për t'i siguruar fajtorit apo të tjerëve përfitime të paligjshme ose mosdënimin.*¹⁰⁶ Gjithashtu do të quen të lidhura procedimet edhe në rastet kurligjvënsi nuk jep ndonje sugjerim bashkimi por parashikohet bashkërendimi I punëve ndërmjet prokurorive, *kur është fjala për vepra penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit; kur prova e një vepre penale ose e ndonjë rrethane të saj ndikon mbi provën e një vepre penale tjetër ose të një rrethane tjetër; kur prova e disa veprave penale rrjedh, edhe pjesërisht, nga i njëjti burim.*¹⁰⁷

Veprim tjetër që mund të kryhet nga prokurori është **njohja** e cila ka për objekt personat sendet ose cdo gjë tjetër që mund të perceptohet nga shqisat. Në shumicën e rasteve njohja ka për objekt personin fizik i cili do të njihet nga një person i tretë apo i jashtëm që drejtëpërdrejtë e ka perceptuar atë nëpërmjet shqisave . Për njohejen e kryer nga prokurori gjatë hetimeve paraprake ligjvënsi ka përcaktuar një ndryshim thelbësor përsa të njëjtit veprim të kryer nga gjykata pasi ajo mund të përmbushet jo vetëm me paraqitjen e vetë personit, sendit apo objektit që do të njihet por edhe nëpërmjet tregimit 'me figurë'.¹⁰⁸

Megjithse veprimtaria e njohjes së kryer nga prokurori nuk është parashikuar në mënyrë të detajuar, ligjvënsi ka parashikuar rrethanën kur mund të cënohet vullneti I lirë I atij që do të bëjë njohjen dhe për këtë *“kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të ketë druajtje ose ndikim tjetër nga prania e atij që duhet të njihet, prokurori*

¹⁰⁶ Neni 79 k.p.p sugjeron bashkimin e çështjeve që qëndrojnë në të njëjtën gjendje dhe shkallë para të njëjtës gjykatë dhe kur nuk dëmtohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre.

¹⁰⁷ Neni 306 pika 2 k.p.p.

¹⁰⁸ Neni 313 pika 2 k.p.p *“Personat, sendet dhe objektet e tjera i paraqiten ose i tregohen me figurë atij që duhet të bëjë njohjen”*

*merr masa që veprimi të kryhet pa u parë nga ai që duhet të njihet” Masa të cilat konsistojnë në vendosjen e pasqyrave optike që bëjnë të mundur që pesoni që do të njihet most ë shoh personin që do të bëj njohjen, apo në shmangjen e qëndrimit të personave në të njëjtin vend.*¹⁰⁹

Prokurori mund të autorizoj oficeret e polgjqy ose persona të tjerë të kryejn një **veprim të simuluar** me objekt shitjen ose blerjen e *“sendeve që janë të ndaluara për t’u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, apo sende që rrjedhin nga një krim, ose simulimin e një akti korruptiv ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar dhe mbledhur prova për personat e dyshuar për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie”*¹¹⁰ Qëllimi i veprimtarisë së sipërcituar lidhet me nevojat e hetimit për të zbuluar prova material si dhe për të lehtësuar apo ndërprerë paojat e krimit apo për të parandaluar a penguar kryerjen e veprave të tjera penale, nëpërmjet asgjesimit të burimeve financiare dhe pasurore. Normohet se *“Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret”*¹¹¹. Duke ju referuar anës objektive të figurës së veprës penale që kryhet nëpërmjet veprimit të simuluar, nëse vërtetohet se shkak i pasojave apo i mundësisë së ardhjes së tyre është veprimi i simuluar atëherë nuk do të ekzistonte lidhja shkakësor midis veprimit dhe mosveprimit të autorit të dyshuar dhe pasojës, dhe subjekti i implikuar në veprimtarinë kriminale nëpërmjet veprimit simulues nuk do të mund të lidhet me përgjegjësi penale.

Duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë e lartë shoqërore që kanë veprat penale të kryera në kuadër të fomave të vecanta të nashkëpunimit ligjvënsi ka normuar mundësinë e **infiltrimit në**

¹⁰⁹ D.Lara *“Koment mbi Proceduren Penale”* Botimet Morava, Tiranë 2019.

¹¹⁰ Neni 294/a pika 1.

¹¹¹ Neni 294/a pika 3.

përbërjen e një grupi kriminal¹¹² të oficerit apo agjentit të pol.gjyq duke fshehur identitetin e tyre. Është i detyrueshëm autorizimi i prokurorit, mungesa e të cilit përbën një shkelje dhe passjell papërdorshmërinë e provës së marrë në këtë mënyrë. Qëllimi I infiltrimit në përbërjen e një grupi kriminal është për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hetimin.

Duke ju referuar anës objektive të figurës së veprës penale që kryhet gjatë infiltrimit, nëse vertetohet se shkak i pasojave apo i mundësisë së ardhjes së tyre është vet subjekti I infiltruar atëherë nuk do të ekzistonte lidhja shkakësor midis veprimit dhe mosveprimit të autorit të dyshuar dhe pasojës, dhe subjekti i implikuar në veprimtarinë kriminale nëpërmjet subjektit të infiltruar nuk do të mund të lidhet me përgjegjësi penale.

Neni 294/c normon se **“Dorëzimi i kontrolluar”** *autorizohet nga prokurori që drejton hetimet paraprake, me kërkesë të autoriteteve të huaja*”. Vepritaria në fjalë jo vetëm kryhet me autorizim të prokurorit dhe asnjëherë me iniciativën e pol.gjyq, por ajo ndalon veprimtarinë e pol.gjyq e cila në rrethana të zakonshme ishte e detyruar të procedonte me arrestimin në flagrancë.

Dorëzimi i kontrolluar mund të autorizohet në rastet kur personat që dyshohet se janë përfshirë në transportin e paligjshëm të lëndëve narkotike, armëve, sendeve të vjedhura, materialeve eksplozive ose bërthamore, materialeve radioaktive, shumave të parave dhe të ardhurave të tjera produkte të veprës penale ose të sendeve të përdorura si mjet për kryerjen e veprave penale, nuk mund të identifikohen ose arrestohen në mënyra të tjera, si dhe kur identifikimi apo arrestimi i tyre do të dëmtonte hetimet ose do të rrezikonte sigurinë e personave apo dëmtimin ose humbjen

¹¹² Neni 294/b k.p.p.

e sendeve që transportohen dhe kur zbulimi i veprave penale dhe marrja e provave është i pamundur ose i vështirë për t'u kryer në mënyra të tjera.

Parashikohet se vendoset nga prokurori dorëzimi i kontrolluar me kërkesë të autoriteteve të huaja, që do të thotë se është në vazhdim një hetim i përbashkët me to e për këtë prokurori që ka detyrën është i detyruar të shënoj në regjistrin e veprave penale.¹¹³

Nenent 299/a dhe 299/b disiplinonë përkatësisht **ruajtjen e përshpejtuar dhe mirëmbajtjen e të dhënave kompjuterike dhe ruajtjen e përshpejtuar dhe zbulimin e pjesëshëm të të dhënave kompjuterike**, megjithëse gjenden në Kreun e IV K.P.P, titulluar: Veprimtaria me iniciativë e policisë gjyqësore, janë veprime që mund të kryhen vetëm me autorizim paraprak të prokurorit i cili përcakton ruajtjen e të dhënave që ende qëndrojnë në mbajtëset magnetike të pasekuistruar duke 'deroguar' kështu nga rregulli i përgjithshëm për ruajtjen e sendeve të sekuestruara parashikuar në nenin 214 k.p.p.¹¹⁴

Dokumentimi i veprimeve të prokurorit bëhet për aq sa është e mundur sipas rregullave të dokumentimit të senacës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv dhe kur kjo nuk është e mundur bëhet nëpërmjet dorëshkrimit a shtypshkrimit. Veprimet dokumentohen gjatë kryerjes së tyre, që do të thotë se kontekstualisht me kryerjen e veprimit duhet të përpilohet edhe procesverbali materializues por nëse ka rrethanë që bëjnë të pamundur dokumentimin e veprimit kontekstualisht me veprimin ky i fundit dokumentohet menjëherë pasi rrethanat të jetë zhdukur. Çdo veprim i kryer nga prokurori materializohet në procesverbal dhe formon fshikullin e

¹¹³D.Lara "Koment mbi Procedurën Penale" Botimet Morava, Tiranë 2019.

¹¹⁴ Neni 214 Ruajtja e sendeve të sekuestruara 1. "Sendet e sekuestruara ruhen në sekretari. Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen në një vend tjetër, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes. 2. Gjatë veprimit të dorëzimit, ruajtësi paralajmërohet për detyrimin e ruajtjes dhe të paraqitjes së sendeve kur kërkohen nga organi procedues, si dhe për dënimin e parashikuar nga ligji penal për atë që shkel detyrimin e ruajtjes"

prokurorit, në të cilin përfshihen edhe të gjitha veprimet e kryera nga pol.gjyq, këkresat dhe memoriet e mbrojtësit, viktimës dhe aktet e kryera përpara apo nga gjyqtari i hetimeve paraprake.

4.5 Gjyqtari i hetimeve paraprake si organ i pushtetit gjyqësor.

Edhe pse subjekti në procesin penal, gjykata qëndron mbi palët, apo ‘*super partes*’ pasi qëllimi i sajë është të kontrolloj dhe garantoj ligjshmërinë e verpimeve të palëve përgjatë gjithë rrugëtimit të procesit penale dhe ta përmbylla atë me vendim.¹¹⁵ Ligji nr. 98\2016, datë, 06.10.2016 “*Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” nuk e parashikon në mënyrë specifike gjyqtarin e hetimeve paraprake si organ i veçantë pranë gjykatës penale, gjithsesi ai ka funksion juridiksional dhe ky funksion nxirret nga vet dispozitat e K.Pr.P.

Gjatë hetimeve paraprake kërkesat e palëve shqyrtohen nga gjykata në kompozim monokratik sin ë rastin e procedimeve që zhvillohen para gjykatës së zakonshme ashtue edhe në raastin e atyre të zhvilluar para Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Orgnizuar dhe, në të dyja rastet gjykata nuk ka si atribut të shprehet mbi fajësinë/pafajësinë e personit hetim.

Ligjvënsi ka arritur në konkluzionin se, gjyqtari që vlerëson kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprakë, nese do të vazhdoj të merret me procedimin do të ndikohet mbi trajtimin e të pandehurit si në seancë paraprakë ashtu edhe në gjyqin e themelit. Në mënyrë që të respektohet parimi i paanësisë së gjykatës, si një nga parimet bazë të procesit të rregullt ligjorë është

¹¹⁵ Autori G.Mercone, në veprën e tijë “*Diritto processuale penale*”, XI edizione, Simone editore 2003, ne Kap.10 të titulluar ‘*Giudice super partes*’, shprehet se: “*Karakteri instrumental i gjykatës është qëndror dhe i pazavendësueshëm , pasi ajo mbart pushtetin si për të vendosur mbi zbatimin e normave procedural/jus dicere procedural, ashtu dhe të normave të ligjit material/ius dicereresostanziale.*”

disiplinuar se “nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim” dhe “gjyqtari që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit të seancës paraprake në të njëjtin procedim”.¹¹⁶

Gjithastu është subjekt gj.h.p dhe për rrjedhojë duhet të jap dorëheqjen të gjitha rasteve ku për shkak të një lidhje familjare, gjinije a krushqie; për shkak të pozicionit që ka përkundrejt palëve; për shkak të shfaqjes së menimit mbi përfundimin e gjykimit përpara se ky të përfundojë, bëjnë të mendohet se ai është ‘*judex suspectus*’.¹¹⁷

Gjyqtari për hetimet paraprake është gjyqtari i gjykatës së zakonshme, asaj të posaçme¹¹⁸ si dhe gjyqtari i seksioneve të veçanta për të mitur, të cilit sipas rregullave të k.p.p i janë atribuar funksionet e gjyqtarit të ngarkuar me detyrimin për të vendosur mbi kërkesat e palëve në fazën e hetimeve paraprake. Karakteri eventual i ndërthurjes së gjyqtarit është shprehje e fakti që ai është i tretë në lidhje me hetimet paraprake pasi nuk mund të marrë drejtimin etyre dhe nuk mund të kërkojë burime prove. Nëse do të ishte edhe ai i përfshirë në hetimet paraprake nuk do të mund të vlerësonte me objektivitetin që pritet të ketë një ‘organ i pavarur’, kërkesat e prokurorit dhe të subjekteve që kanë interes në hetime.

Nuk e përgënjeshton këtë qëndrim as dispozita që lejon gj.h.p të të urdhërjohet prokurorin të rregjistrojë procedimin dhe të kryej hetimet e nevojshme kur pranohet ankimi i viktimës që

¹¹⁶ Neni 15 pika 2 k.p.p.

¹¹⁷ Për cka, aplikohen që në rastin kur duhet të vendoset mbi kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake edhe dispozitat që kanë të bëjnë me: Papajtueshmërinë për arsye lidhjeje familjare, gjinije ose krushqie; Heqjen dorë të gjyqtarit; Përrjashtimin e gjyqtarit.

¹¹⁸ Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

kundërshton vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit pasi në këtë rast ai pa u përfshirë në hetime bën gjyqësi në gjendjen që janë aktet.¹¹⁹

Në këto kushte, gj.h.p është i pajisur me pushtet të gjerë vendimarrës, por nuk ushtron asnjë funksion ‘mbështetës’ së akuzës duke u limituar të kontrolloj vetëm që prokuroi ti përbahet rigorozisht dispozitave ligjore.

Juridiksioni, implikon dialogun midis titullarëve të interesave të kundërta për ndjekjen e fakteve penalisht të jashtëligjshëm dhe për tutelimin e të drejtës së mbrojtjes përpara një gjyqtari që nga ai dialog, duhet të nxjerrë arsyet e bindjes së tij.

Sa herë që prokurori hap hetimet për pjesmarrjen e mbrojtjes duke u vendosur në pozicione kundërshtuese me mbajtësin e një të drejte të garantuar nga Kushtetuta , përmbushen kushtet e domosdoshme që kjo veprimtari të ketë karakter juridiksional, nëse kjo veprimtari më pas i nënshtrohet vlerësimit të një gjyqtari garancitë juridiksionale kanë mënyrë që të shprehen tërësisht.

Nëse jemi përpara një kërkesë drejtuar gjyqtarit pavarësisht përmbajtjes dhe palës që e parashtron, që implikon kontradiktoritetin dhe vendimi që do të jepet për ti dhënë përgjigje kërkesës nuk mund të mos jetë një vendim me karakter juridiksional pasi gjyqtari është thërritur të “*jus dicere*”, duke ushtruar kështu një funksion që i përket vetëm atij.

¹¹⁹ Neni 291 Vendimi për mosfillimin e procedimit “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. 3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura. 4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre. 5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve.”

4.6 Roli garant dhe funksioni kontrollues i gjyqtarit në hetimet paraprake.

Neni 278 i K.Pr.P është një dispozitë e vendosur midis normave që disiplinojnë hetimet paraprake dhe seancën paraprake dhe kufizohet të stabilizoj se *përgjatë hetimeve paraprake në rastet e parashikuara në ligj mbi kërkesën e prokurorit të pandehurit, të dëmtuarit dhe palëve private, vendos gjykata.*

Duke qenë organ i legjitimuar të vendos mbi kërkesën e palëve, si të prokurorit ashtu dhe të palëve të pekura nga hetimet, ka një gamë të gjerë kompetencash.

Përtej fushave të lirisë personale (**masa sigurie me karakter personal ose real**) dhe në përdorimin **të mjeteve të kërkimit të provës** (raste në të cilat paraqiten nevoja për mbrojtjen e të drejtave kushtetues të cilat e bëjnë të paevitueshme prezencën e një gjyqtari) ndërhyrja e gjyqtarit të hetimeve paraprake lëviz në një fushë shumë të gjerë¹²⁰ dhe do ishte një sipërmarrje me të vërtet e vështirë të tentoj të rendisë të gjithë rastet në të cilat gjyqtari mund të thirret për tu shprehur.¹²¹

Gjyqtari i hetimeve paraprake merr rolin e garantit pasi është subjekt i vetëm i cili mund të vendos për lirinë personale,¹²² dhe përsa i përket përgjimit të komunikimeve,¹²³ si në njërin rast

¹²⁰ Neni 201/a Marrja me detyrim e kampionëve biologjikë ose kryerja e procedurave mjekësore të detyruar; Neni 201 Këqyrja e vendeve dhe e sendeve; Neni 202/a Vendimi për lejimin e kontrollit; Neni 208/a Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike etj.

¹²¹ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.525.

¹²² Neni 244 Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit.

“*Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar*”

¹²³ Neni 222 Vendimi për lejimin e përgjimit

ashtu edhe në tjetrin mund të vleftësojë masën e marë eventualisht me urgjencë nga organet e policisë gjyqësore apo nga prokurori.

Funksioni kontrollues mbi veprimtarinë e organit të akuzës është i evidentueshëm në aktivitetin që ushtron në fazën e vlerësimit, të kundërshtimit të personit nën hetim ose të viktimës kundër **vendimit të prokurorit për të zgjatur afatet e përcaktuara për zhvillimin e hetimeve paraprake.**¹²⁴

Kompetecat që i janë dhënë, gjyqtarit të hetimeve paraprake, kur thërritet nga palët e legjitimuara për të kundërshtuar **vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit** penal mund të cilesohen si fuqi kontrolluese.¹²⁵

Gjyqtari i hetimeve paraprake funksionet e garancisë dhe të kontrollit mund ti vër në praktikë vetëm nëse vihet në lëvizje nga palët e interesuara. Atij mund të mos i parashtrohet asnjë kërkesë sepse, mund të ndodhë që nuk duhet të merren gjatë hetimeve paraprake, masa sigurie që kufizojnë lirinë e personit nën hetim, sepse subjekti i interesuar nuk kundërshton vendimin e prokurorit për zgjatjen e hetimeve apo vendimin për mosfillimin e procedimit apo, prokurori mendon mos të përdor mjetet e kërkimit të provës ose nuk paraqitet nevoja për sigurimin e provës.¹²⁶

“Me kërkesën e prokurorit, për rastet e lejuara në paragrafin 1, të nenit 221, gjykata autorizon përgjimin me vendim të arsyetuar, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale”

¹²⁴ **Neni 325 Ankimi për zgjatjen e afatit të hetimeve**

“I pandehuri dhe viktimja kanë të drejtë, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve”.

¹²⁵ **Neni 291 Vendimi për mosfillimin e procedimit**

Pika 2 “Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”.

¹²⁶ **Neni 320 Disponimi mbi kërkesën për sigurimin e provës**

Doktrina dhe jurisprudenca Italiane¹²⁷ bën ndarjen në gjyqtarin “për” hetimet paraprake ne raset kur miraton kërkesën e prokurorit për lejimin e përgjimeve apo për të ushtruar kontroll banese dhe për gjyqtarin “mbi” hetimet paraprake, kur thirret të vendosi mbi ankimin e palës kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit sipas parashikimeve të nenit 291 të K.Pr.P, në këtë rast është pa diskutim gjyqtar themeli që vendos mbi hetimet sepse duhet të stabilizoj nëse ekzistojnë kushtet për mosfillimin e procedimit ose duhet të thellohen hetimet duke përcaktuar drejtimin e tyre.

Rol tjetër i rëndësishëm i gjyqtarit të hetimeve paraprake ka të bëj me realizimin e **të drejtave kushtetues që kanë të bëjnë me mbrojtjen e personit nën hetim**, në rastet kur veprimtraia e pol.gjyq dhe prokurorit nuk përputhet me parashiket e dispizitave të k.p.p.

Në eventualitetin kur procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe nga policia gjyqësore, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, nuk depozitohen në sekretarinë e prokurorisë brenda tri ditëve nga kryerja e veprimit edhe pas kërkesave të mbrojtësit të të pandehruti, ky i fundit duhet të ketë mundësinë të vër në lëvizje gj.h.p për të realizuar të drejtën e tijë ligjore që ti që t’i shqyrtojë këto veprime dhe të nxjerrë kopje.¹²⁸

Moment tjetër i një rëndësie të vecant ku kërkohet ndërhyrja e gj.h.p për të garantuar të drejtat kushtetuese që mund të shkelen nga veprimtaria e pol.gjyq dhe prokurorit ka të bëj me sekuestrimet provuese. Në këtë rast, gjimon mbi ankimin e palës së legjitimuar, dhe pasi prokurori të ketë vendosur dhe njoftuar vleftësimin e sekuestros provuese, gj.h.p duhet të vendos

“Brenda dy ditëve nga ardhja e përgjigjes për marrjen e njoftimit për kërkesën për sigurimin e provës, gjykata merr vendim, me të cilin pranon ose rrëzon kërkesën për sigurimin e provës”.

¹²⁷ Gjykatës Kushtetuese Italiane i është dashur të ndërhyjë shumë herë në kohë për të identifikuar sistemin e papajtueshmërive, duke konsoliduar pozicionin e gjyqtarit për hetimeve paraprake. I referohem vendimit nr: Corte.Cost 20 maggio 1996 nr 155, Corte.Cost 9-17 giugno 1999, nr 241.

¹²⁸ Neni 309, pika 3, k.p.p,

nëse dobishmëria e sendit të sekuestruar për nevojat e hetimit pravalonë mbi interes pasurore të subjekteve të cilëve u sekuestrohen sendet.¹²⁹

K.p.p përcakton vetëm një rast në të gjen përjashtim rregull të përgjithshëm sipas së cilit gj.h.p ndërhyt në fazën e hetimeve paraprake vetëm me kërkes të palëve dhe ka të bëj me lirinë personale të personit nën hetim. Prokurori cdo dy muajt nga zbatimi i masës së sigurimit paraburgosëse ka detyrimin të njoftoj gj.h.p me shkrim mbi veprimtarinë hetimore të kryer dhe nevojat e sigurimit. Është normuar se *“kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, **gjykata verifikon nevojat e sigurimit ... kryesisht**”*¹³⁰ duke ju hapur rruga kështu gj.h.p në të verifikoj kryesisht ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të nevojshme për vazhdimin e aplikimit të masës së sigurisë ‘arrest në burg’, ‘arrest në shtëpi’ apo ‘shtrim i përkohshëm në spital psikiatrik’. Në këto rrethana, gjykata kur vren se kanë rënë shkaqet që kanë cuar në paraburgim të hetuarin urhdëron drejtëpërdrejtë drejtuesin e institucionit të paraburgimit për të liruar të hetuarin nga gjendja e izolimit. Senaca gjyqësore e nevojshme për verifikimin e nevojave të sigurimit zhvillohet sipas procedurës për marrjen në pyetje të personit të arrestuar.¹³¹

¹²⁹ Neni 212 k.p.p “Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit”.

¹³⁰ Neni 246 k.p.p “Zbatimi i masave të sigurimit”.

¹³¹ Neni 248 Marrja në pyetje e personit të arrestuar *“1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre. 2. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjkata depoziton vendimin e arsytuar brenda 48 orëve. 3. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës. 4. Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë. 5. Kur pyetja e të arrestuarit duhet të bëhet në gjykatën e një rrethi tjetër, gjykata kërkon që pyetja të bëhet nga një gjyqtar i asaj gjykate. 138 6. Prokurori nuk mund të marrë në pyetje personin e arrestuar përpara se gjykata të procedojë, sipas paragrafit 1 të këtij neni”*

Nëse në fazën e hetimeve paraprake evidnetohet mundësia se burimi i një prove të caktuar për shkaqe objektive apo subjektive nuk mund të arrij në process, mundet që të përfitohet vetë prova duke ruajtur garancitë e kontradiktoritetit përpara një gjyqtari të pavarur e të paanshëm.

Për të arritur në një rezultat të tillë kërkohet vendimi i gj.h.p për pranimin e kërkesës mbi **sigurimin e provës** gjithnjë duke evidentuar provën që duhet marrë, verifikuar rëndësinë e sajë dhe bazueshmërinë e shkaqeve që bëjnë të pamundur marrjen e provës gjatë gjykimit.

Me vendimin që pranon kërkesën gjykata cakton objektin e provës dhe personat e interesuar për marrjen e saj dhe datën e senacës, pastaj sepse provat merren sipas rregullave të caktuara për shqyrtimin gjyqësor, ato merren nga e njëjta gjykatë që do të gjykojë çështjen .¹³²

4.7 Perfundimi i hetimeve.

Hetimet paraprake në lidhje me ushtimin e ndjekjes penale përmbushen nga prokuroi edhe Policia Gjyqësore pasi prokurori i vetëm do të kishte pamundësi objektive ti përmbyllte ato.

Për nga pikpamja sasiore dhe cilësore ato përmbushen aq sa janë ‘të nevojshme’- gjithënjë brenda afatit të hetimeve parashikuar nga neni 323/1 K.Pr.P apo atij te zgjatur parashikuar nga neni 324 K.Pr.P, për të arritur në një vendim pushimi për kundërvajtje apo kërkesën pushimi për krime nëse verifikohet një nga kushtet e parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 328 K.Pr.P apo në ushtrimin e ndjekjes penale me anë të kërkesës për miratimin e urdhërit penal, gjykimin e drejtëpërdrejtë, gjykimin me marrëveshje ose me anë të kërkesës për dërgimin e çështjes në

¹³² Rregulla të detajuara mbi rastet e sigurimitë të provës, elementet e kërkesës dhe paraqitjen e saj, disponimi mbi kërkesën për sigurimin e provës mënyrën e marrjes së saj, marrjen e proves; efektet e provës së siguruar; dhe përdorimin e provave të marra, përcaktohen në mënyrë të detajuar në nenet 316-322 k.p.p.

gjyq, kur ka prova qe, në gjykim të prokurorit janë të mjaftueshme për mbështetje e akuzës në gjyq kur besohet se ka gjasa që në gjykim të merret një vendim fajësie.

Për cka, si vendimi i pushimit të çështjes për kundravjate apo kërkes për pushimin e akuzës për krime ashtu dhe kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, janë shprehje e vullnetit të prokurorit si konkluzion i vlerësimit të veprimeve hetimore, pra nuk mund të cilësohen ato veprime hetimore, që synojnë zbulimin e së vërtetës.¹³³

Si nje nga dy organet e ngarkuara, në përfundimi të veprimeve të nevojshme hetimore, policia gjyqësore është e detyruar që së bashku me të gjitha veprimet e tyre, materializuar në procesverbal, të dergojë tek prokurori edhe nje relacion shpjegues për fakin edhe provat si edhe sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit te hetimeve.¹³⁴

Është e kuptueshme se ky detyrim qëndron për pol.gjyq e organizuar ne ‘seksione’ si zyrë pranë prokurorisë dhe edhe jo e asaj të organizuar në ‘shërbime’ apo dhe ‘organe te përgjithshme’ pranë Policisë së Shtetit. Nëdrsa *relacioni* ka te bëjë me përmbushjen e drejtimeve te hetimit dhe justifikues i përmbushjes së të gjitha veprimeve të nevojshme, *sugjerimi* ka të bëjë me opinionin e saj për zgjidhjen e çështjes në ‘pushime’ apo me ‘dërgimin në gjykate.

Është përcaktuar se ‘dokumentacioni i veprimeve të policisë gjyqësore dhe provat materiale edhe sendet qe lidhen me veprën penale vihen në dispozicion të prokurorit’ që e është zontues-

¹³³ Nenet 8/a dhe 304 të K.Pr.P vënë këtë konkluzion në një kritik të forte pasi organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajsojnë të pandehurin, ashtu edhe ato janë në favor të tij dhe se prokurori– kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime cka tregon se gjithnjë e me shumë se prokurori drejtohet në zbulimin e së vërtetës dhe jo në dënimin e të hetuarit

¹³⁴ D.Lara “*Koment mbi Proceduren Penale*” Botimet Morava, Tiranë 2019.

dominues i hetimeve, duke drejtuar dhe pasur ne dispozicion policinë gjyqësore, me aftësinë që të përmbushë edhe ai vetë veprime hetimore, nuk është i detyruar te ndjek këto sugjerime, përvec se kur ato gjejnë përputhje edhe me opinionin e tij të vlersimit të veprimeve të përmbushura.¹³⁵

Ndërsa nga pikëpamja kohore, duke ditur që prokurorit i nevojitet një kohë e arsyeshme për të shqyrtuar veprimet dhe për të përcaktuar disponimin e tij mbi vazhdimin e procedimit, dërgimi i relaacionit dhe sugjerimeve nga ana e policisë gjyqësore është e kuptueshme se i kryhet jo ekzaktesisht në fund të hetimeve, por ende para përfundimit të afatit të tyre.

Në situatën e përmbushjes së të gjitha veprimeve të nevojshme, prokurori ka dy alternativa , e para të pushoje çështjen për kundravajte apo të kërkojë ta pushojë ta pushoje akuzën për krime edhe e dyta ta dërgoj atë në gjykatë. Por para se të vazhdoj rrugën e mëtejshme të të procedimit, për të siguruar mbrojtjen e të hetuarit, që sepse gëzon të drejta dhe garancitë e parashikuar për të pandehurin dhe njësoj si ai ka te drejten te mbrohet vet ose me ndihmen e nje mbrojtësit, si dhe për te siguruar të drejta e viktimës, prokurori njofton për përfundimin e hetimeve të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe viktimën.¹³⁶ Prokurori, që sic është përmendur më sipër se ka përvec të tjerave, në posedim të gjitha veprimet e hetimit, në rast në rast moazbatimi, sjell si pasojë pavleshmërinë relative të kërkesës së tij për dërgimin e çështjes në gjyq. Këtij detyrimi, i korrespondon e drejta e jo vetëm e të hetuarit apo e mbrojtësit të tij për tu njohur me veprimet e përmbushura si nga policia gjyqësore ashtu edhe nga prokurori por edhe e drejta e viktimës apo e trashgimtarëve të saj. Prokuroi para se të vendosi përfundimin e hetimeve, ka detyrimin që të bëj të gjitha përpjekjet e nevojshme për të siguruar njoftimin e të hetuarit.

¹³⁵ Po Aty.

¹³⁶ Neni 327/2 K.Pr.P

Njoftimi i përfundimit të hetimeve duhet të përmbajë vec gjeneraliteteve të të hetuarit, edhe përmbledhjen e faktit për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes si dhe cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje.

Në fakt e drejta për tu njohur me aktet dhe për të marrë kopje qëndron edhe më herët, gjatë fazës së hetimeve paraprake për aktet që përmbajnë veprime në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistoj, dhe për aktet e tjera në këtë fazë është prokurori ai që vendos se cilat akte ruhen nga sekretari hetimor.

Neni 331 K.Pr.P përcakton pavlefshmërinë relative të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq nëse nuk përmbushen dhe zbatohen me korrektësi elementet e aktit për përfundimin e hetimeve.¹³⁷ Dispozita në fjalë do të merrte një rëndësi të jashtëzakonshme në rastin kur kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq depozitohet në sekretarinë e gjykatës në limitet e përfundimit të afateve të paraburgimit dhe do të rezultonte se nuk janë respektuar pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 327 k.p.p. Në këtë rast, gjyqtari magjistrat që vetëm subjekt i ligjit është, ka detyrimin të deklaroj pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, të kthejë aktet prokurorit dhe të

¹³⁷ Konkretisht, kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyqë duhet të deklarohet e pavlefshme nga gj.s.p dhe aktet të kthehen prokurorit nëse ai "brenda afatit të parashikuar nga neni 324, i këtij Kodi, nuk njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehur, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit; Nëse njoftimi nuk përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje; nëse i pandehuri nuk njoftohet gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje dhe kur i pandehuri kërkon të pyetet dhe prokurori nuk procedonë me pyetjen e tij.

konstatohet humbjen e fuqisë së masës së sigurimit¹³⁸ nëse gjatë kohës së nevojshme për caktimin e senacës paraprake ato kanë përfunduar.

Gjithashtu akti për përfundimin e hetimeve ashtu si normohet në nenin 327 K.Pr.P, i jep te pandehurit *“të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t’i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje”*¹³⁹

Kërkesa e të hetuarit për kryerjen e hetimeve shtesë është në diskrecionalitetin e prokuroit i cili mund të mos e përmbush atë dhe të vendos brenda 15 ditëve me vendim të arsytuar, ndërsa mosrespektimi i kërkesës së të hetuarit për tu pjetur shkaktojnë pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim. Sipas autorit D.Lara, afati 10 ditor në dispozicion të të hetuarit për tu njohur me aktet koincidon me afatin brenda së cilit i hetuari ka të drejtë të ngrej para prokuroit të gjitha pretendimet mbi pavlefshmërinë e kateve të kryera jo në prezenc të tijë dhe nëse nuk i ngre në këtë moment i hetuari humbet të drejtën për ti ngritur përpara gjyqtarit të seancës paraprake. Pra, që i hetuari të legjitimohet të ngrej pretendime lidhur me pavlefshmërinë e akteve në senacë paraprake, ai duhet të ngrej këto kërkesa para prokurorit dhe ky i fundit të mos i marrë parasysht. Autori e bazon qëndrimin e tijë në nenin 129/2 të K.Pr.Penale spas të cilit *“Kur pala është e pranishme, pavlefshmëria një akti duhet të kundërshtohet para se ai të bëhet ose, kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi të bëhet”*, dhe në nenin 130/5 K.Pr.P sipas të cilit *“Gjatë hetimeve paraprake, cmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori dhe nëse nuk kryhet nga ky i fundit cmohet nga gjyqtari i senacës paraprake”*

Me këtë qëndrim jemi plotësisht dakort pasi edhe pse neni 129/3 K.Pr.P disiplinon se *“Pavlefshmëria lidhur me aktet e hetimeve paraprake dhe me ato të kryera për sigurimin e*

¹³⁸ Neni 261 k.p.p, Shuarja e masave të sigurimit.

¹³⁹ E drejta për të paraqitur memo apo për të bërë deklarimeqë në momentin që i personi nën hetim merr dijeni për fillimit të hetimeve. Këto të drejta burojnë nga nenet 34, 110, 111 K.Pr.P

provës duhet të kundërshtohet në seancë paraprake ose në seancë gjyqësore përpara se të filloj shqyrtimi gjyqësor, sipas nenit 355 të këtij kodi” ai duhet te interpretohet ne menyre sistematike me nenet pararendes dhe per rrjedhoj nese pavlefshmeria e akteve te hetimeve paraprake nuk ngrihet sapo pala ka pasur mundësi apo efektivishte ka marrë dijen për veprimin e kryer gjate hetimeve paraprake, ajo humbet te drejten per te ngritur kete pavlefshmeri ne senacen paraprake.

Kështu përfundimi i hetimeve formohet si një garanci më shumë mbrojtëse për të hetuarin pasi parashikohet një lloj kontradiktoriteti midis mbrojtësit të të hetuarit dhe prokurorit ende pa disponuar ky i fundit për mënyrën e përfundimit të hetimit.

Njoftimi i përfundimit të hetimeve rezulton të jetë i aplikueshëm jo vetëm kur prokurori është i prirur për dërgimin e çështjes në gjyq por edhe kur ai do të disponoj pushimin e çështjes kur procedon për kundravajtje apo kërkesën për pushimin e çështjes kur procedon për krime vecse në këto rastet moszbatimi i njoftimit për përfundimin e hetimeve nuk passjell asnjë pasoj për procedimin.

4.8 Disponimi i prokurorit pas përfundimit të hetimeve.

Pasi ka përfunduar tërësinë e veprimtarisë hulumtuese për kërkimin dhe gjetjen e burimeve të provës dhe, sipas pikës 1 të nenit 151 të vetë provës, përpara prokurorit shfaqen disa alternative mbi mënyrën e vazhimit të procedimit. Në këtë moment nuk pranohen diskriminime dhe nuk mund të përdoren mënyra vlerësimesh të ndryshme në situatë objektivist të ngjashme pasi është në lojë rregulli i rëndësishëm për demokracinë që përcakton ushtrimin të ndjekejs penale.

Prokurori magjistrat ka diskrecionalitet vetëm kur disponon hetimet paraprake, organizon punën hulumtuese dhe 'impenjon' policinë gjyqësore pasi rendi juridik nuk pëcakton në mënyrë të detajuar në cilën mënyrë, duhet të orjentohet prokurori kur paraqitet një situatë hipotetike e njoftimit të një veprë penale dhe të interesave publik apo privat të përfshira në të.

Kur duhet të bëjë një zgjedhje në përfundim të hetimeve, limit i pushtetit diskrecional që përket prokurorit konsiston në përcaktimet e normave procedurale penale. Rezultatet e arritura gjëra në atë moment shëndërrohen në një normë kushtëzuese për sjelljen e mëpasshme dhe nga përfundimi i hetimeve duhet të nxjerr elementet orjentues në zgjedhjen e ushtrimit apo mos ushtrimit të ndjekejes penale. Sepse Kushtetuta parashikon se *“prokuroria ushtron ndjekjen penale..”*¹⁴⁰ nuk implikon detyrimin për prokurorin që të ushtroj ndjekje penale sa her mer dijnei për një veprë penale, pasi duhet të verifikoj nëse ajo është e bazuar. Ndjelja penale ushtrohet në të gjitha rastet kur nuk dalin element që legjitimojnë mosfillimin e procedimit, pezullimin e tijë apo pushimin e çështjes. Një gjë është të thuhet se prokurori mund të zgjedhi nëse do të ushtroj apo jo ndjekjen penale dhe një gjë tjetër është të qartësosh se organi i akuzës ka detyrimin të ushtroj ndjekje penale dhe se ky detyrim nuk qëndron në të gjitha rastet kur nga ekzaminimi njoftimit të veprës penale i kryer në përfundim të hetimeve paraprake rezultojnë kërkesat ligjore që legjitimojnë pushimin e akuzës ose çështjes apo pezullimin e hetimeve.

Është normuar në pikën 6 të nenit 327 k.p.p se *“në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori ... vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i*

¹⁴⁰ Neni 148 pika 1 Kusht. *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.”*

Kodit” ose “i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi”¹⁴¹

4.8.1 Pushimi i akuzës ose çështjes në procedimet për kundërvajtje penale.

Prokuroi vendos pushimin e akuzës ose çështjes¹⁴² kur porcedon për kundërvajtje penale dhe konstaton padobishmërinë e procesit ose pamundësinë e mbështetjes së akuzës në gjyq.

Përcaktimi në rrafshin normative i kërkesave që legjitimojnë prokurorin të vendosi pushimin e akuzës ose çështje konfirmon përjashtimin nga cdo vlerësim i lirë, pasi edhe në rast konstatimi të pamjaftueshmërisë së elementeve për të mbështetur akuzën në gjyq nuk passjell automatikisht autorizimin e prokurorit për të vendosur pushimin e akuzës ose çështjes.

Megjithse ligjvënsi parashikon se “Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes...”¹⁴³ nuk do të thotë të pritët përfundimi edhe në rastet kur një nga rrethanat që legjitimojnë pushimin konstatohet që në fillim të hetimeve. Kështu psh do të ishte totalisht i padobishëm vazhdimi i hetimeve nëse qysh nga fillimi rezulton se “me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën veprë penale”¹⁴⁴.

¹⁴¹ Arrihet në përfundimin se kapërcehet seanca paraprake dhe shkohet drejtëpërsedrejtë në gjykimin e themelit kur procedohet sipas nenit 400 k.p.p që disiplinon rastet e gjykimit të drejtpërdrejtë; sipas nenit 406/a, k.p.p që disiplinon kërkesaën për miratimin e urdhrin penal, dhe sipas nenit 406/dh k.p.p që parashikon shqyrtimin nga gjykata të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit të arritur ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit, në këtë rast gjatë hetimeve paraprake.

¹⁴² Nëse ekziston një nga rrethanat e parashikuara në nenin 328 k.p.p për të pushuar procedimin vetëm ndaj një të akuzuari, është rasti që prokuroi të vendos *pushimin e çështjes*. Ndërsa kur është rasti për pushimin e procedimit kundrejt faktit në tërësi jemi përpara *pushimit të akuzës*. Megjithse ligjvënsi përdor termin ‘*pushimi i akuzës*’ nuk është përdorim i duhur teknik i termit pasi akuzat ngrihet në gjyq dhe në këtë faz kemi atribum të veprës penale.

¹⁴³ Neni 328 k.p.p.

¹⁴⁴ Neni 328 pika 1 gërma e k.p.p.

Duke krahesuar rrethanat qe nuk lejojne fillimin e procedimit te parashikuara ne neni 290 k.p.p.¹⁴⁵ me rrethanat qe legjitimojne pushimin e akuzes ose ceshtjes parashikuar ne nenin 328 k.p.p mund te thuhet se te parat jane te perceptueshme pa asnje mundim/*ictu oculi* dhe verifikohen brenda 15 deteve nga momenti qe ne rregjistrin e prokurorit eshte shenuar *notita criminis*. Ndersa rrethanat qe legjitimojne pushimin e akuzes ose ceshtjes nuk mund te perceptohen menjehere dhe eshte e nevojshme per zbulimin e tyre kryerja e disa veprimeve qe nevoj per kohen kanë. Rrethanat tipike qe legjitimojne vendimin e prokurorit per psuhimin e akuzes ose ceshtjes kur procedon per kundervajtje penale jane : a) *del qarte se fakti nuk ekziston*, pra mungon nana objective e figurës së veprës penale; b) *fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale*, ekziston veprimi apo mosveprimi si dhe pasoja por ato nuk mund te inkuadrohen ne një nga faktet tipik te parashikuara ne k.p; c) *viktima nuk ka bere ankim ose heq dorë nga ankimi ne rastet qe procedimi fillon me kerkesën e tij*, ne kete rast mungon një kusht per procedim; ç) *personi nuk mund te merret si i pandehur ose nuk mund te denohet*, rasti kur person ka kryer veprën ne prezencë te një shkak te perligjur sic mbrojtja e nevojshme; d) *ekziston një shkak qe e shuan veprën penale ose per te cilin ndjekja penale nuk duhej te fillohej ose nuk duhet te vazhdojë*, sic mund te jete rasti i parashkrimit te ndjekjes penale; dh) *del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet qe e ka kryer ai*, ne kete rast pushohet akuza por ceshtja vazhdon pasi vepra ka ndodhur por me shumë mundësi ose me siguri i pandehuri nuk e ka kryer atë; e) *me vendim te formes së prerë i pandehuri eshte gjykuar per te njëjtën vepër penale*, ne respektim te parimit *ne bis in idem* procedimi duhet te psuhoj; ë) *i pandehuri vdes*, rast qe nuk ka nevoj per koment; f) ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.

¹⁴⁵“ Procedimi penal nuk mund te filloje kur: a) personi ka vdekur; b) personi eshte i papergjegjshem ose nuk ka mbushur moshen per pergjegjesi penale; c) mungon ankimi i viktimës ose ajo e terheq ankimin; ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qarte qe fakti nuk ekziston; 161 d) vepra penale eshte shuar; dh) eshte dhene amnisti; e) ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga ligji”

“Vendimi i pushimit për kundërvajtje penale nga prokurori është një nga ato raste ku legjislacioni procedural penal ka përshtatur në gjirin e tij apo thelbin e tij parime të sistemit inkuizitor me një prokuror-gjykatës”¹⁴⁶

Normohet në pikën 2 të nenit 328 se *“prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”*

Ankimi *“kundër vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga marrja dijani para gjyqtarit të seancës paraprake”¹⁴⁷*

Gj.s.p shqyrton ankimin në gjendjen që janë aktet dhe ka në dispozicion, vendimin e pushimit, ankimin e palës së interesuar dhe *“kopje të akteve dhe provave që përmban fashikulli i hetimeve paraprake, duke përfshirë edhe vendimet e marra nga gjyqtari i hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër”¹⁴⁸*

Gj.s.p mund të çmojë sipas rastit se hetimet e kryera nga prokurori janë të paplota ose se ato janë të plota. Në rast se konstaton se hetimet e prokurorit janë të paplota ai disponon kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, ..., *duke përcaktuar drejtësitë e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë”¹⁴⁹*

¹⁴⁶ D.Lara në botimin e tijë *“Koment mbi procedurën penale”* Botimet Morava Tiranë 2019.

¹⁴⁷ Neni 329, pika 1, k.p.p.

¹⁴⁸ Neni 329 pika 2 k.p.p.

¹⁴⁹ Neni 329, pika 3, shkronja b, k.p.p.

Në rast se konstaton se hetimet e prokuroit janë të plota, gj.s.p në mënyrë alternative ose “lënien në fuqi të vendimit të pushimit...”¹⁵⁰ ose nëse konstaton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes...”¹⁵¹

“Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime...” duke u detyruar kështu prokurori të shënoj në rregjistrin e veprave penale faktin apo personin kundrejt të xilëve duhet të zhvillohen hetime. Në asnjë rast gj.s.p nuk mund të detyroj prokurorin të kërkojë dergimin e çështjes në gjyq për persona emri i të cilëve nuk është rregjistruar në rregjistrin e prokuroit sipas përcaktimeve të nenit 287 k.p.p.¹⁵²

Gj.s.p, si në rastet kur i kthen aktet prokuroit ashtu edhe në rastin kur e detyron ate të kryej hetime për vepra apo persona që rezultojnë nga aktet e procedimit, ushtrimi i funksioneve të prokuroit nuk duket se është në lartësinë e duhur, ndaj njofton drejtuesin e prokurorisë.¹⁵³

Nuk parashikohet detyrimi i gj.s.p të shpall vendimin në prani të palëve ndaj në respektim të nenit 113 k.p.p “origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim.”

Kundër vendimit të gj.s.p që lë në fuqi vendimin e prokuroit për pushimin e akuzës ose çështjes “mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit i pandehuri dhe viktima” ndërsa kundër vendimit që kthen aktet prokurorit dhe e detyron të plotësojë hetimet apo kundër vendimit që i kthen aktet

¹⁵⁰ Neni 329, pika 3, shkronja a, k.p.p.

¹⁵¹ Neni 329, pika 3, shkronja c, k.p.p

¹⁵² Neni 329, pika 4, k.p.p.

¹⁵³ Neni 329, pika 5, k.p.p.

prokuroit dhe e detyron të formuloj kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, apo që detyron prokuroin të filloj hetimet për vepra apo persona të tjer, “*mund të bëj ankim prokurori*”.¹⁵⁴

Gjykata e apleti mund të disponoj sipas katër formulave: pranimin e ankimit të të pandehurit duke ndryshuar disponimin e vendimit të pushimit me një formulim më të favorshëm¹⁵⁵; pranimin e ankimit të viktimës dhe urdhërimin e vazhdimin të hetimeve;¹⁵⁶; pranimin e ankimit të viktimës dhe urdhërimin e dërgimit të çështjes në gjyq;¹⁵⁷ dhe së fundmi kur vendos pranimin e ankimit të prokurorit vendos lënjen në fuqi të vendimit të tijë për pushimin e akuzës ose çështjes.

Nuk parashikohet detyrimi i gj.s.p të shpall vendimin në prani të palëve ndaj në respektim të nenit 113 k.p.p “*origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre*”.

Disponimi i gjykatës së Apelit, si kur lë në fuqi vendimin e prokuroit për pushimin e çështjes, ashtu edhe kur le në fuqi vendimin e gj.s.p që ndryshon disponimin e prokurorit, është i lloit urdhër dhe si i till i pa rekursueshëm në gjykatën e lartë pasi ligji nuk parashikon ndryshe.

4.8.2 Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes në procedimet për krim

Prokurori që heton një krim dhe konstaton një nga rrethanat e parashikuara në nenin 328 k.p.p nuk mund të vendos kryesisht pushimin sic mund të bëj në rastin e hetimve për kundërvajtje

¹⁵⁴ Neni 329, pika 6, k.p.p.

¹⁵⁵ Neni, 329 k.p.p.pika 8..

¹⁵⁶ Neni, 329 k.p.p.pika 8.

¹⁵⁷ Neni, 329 k.p.p.pika 8.

penale por i kërkon gj.s.p “...pushimin e akuzës ose çështjes”¹⁵⁸ Parshikimi në fjalë konsiton në risinë më të rëndësishme që sollën ndryshimet e bëra në k.p.p me ligjin 35/2017, pasi bën të kontrollueshëm domosdoshmërishtë drejtëpërdrejtë nga gjykata ushtrimin e ligjshëm apo jo, të ndjekejes penale nga prokurori edhe kur viktimë e veprës penale nuk ka shfaqur vullnetin për një kontroll të till. Kështu prokurori nuk vendos kryesisht por i propozon gj.s.p të vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur konstaton një nga rrethanat e parashikuara në nenin 328 k.p.p për të cilat u fol më sipër. Bashkë me kërkesën prokurori ka detyrimin që të depozitoj në sekretarinë e gjykatës edhe “aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprahe, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër”¹⁵⁹

Për të garantuar parimin e kontradiktoritetit si një nga parimet themelore të procesit të rregullt i cili bëhet i mundur vetëm kur palëve u jepet e drejta dhe koha e mjaftueshme që të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre, “kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim...”¹⁶⁰

Mbi mënyrën e zhvillimit të seancës para gj.s.p ligjvënsi ka parashikuar se “kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprahe në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve”¹⁶¹ duke ruajtur kështu procesi karakterin e mbyllur për publikun dhe të hapur për palët pasi bëhet fjalë për ruajtjen e sekretit hetimor.

Prezenca e palëve në gjykim është fakultative, përfshi edhe prezencën e prokuroit duke qenë se nuk është duke ushtruar ndjekejn penale.

¹⁵⁸ Neni 329/a pika 1, k.p.p.

¹⁵⁹ Neni 329/a, pika 3, k.p.p.

¹⁶⁰ Neni 329/a, pika 4, k.p.p.

¹⁶¹ Neni 329/b, pika 2, k.p.p.

Procesi zhvillohet në bazë të dokumentave shkresorë të paraqitur, fashikullit të hetimit dhe kundërshtimet e mundëshme të palës dhe në fund gj.s.p mund të disponoj me një nga tre formualt, pushimin e akuzës ose çështjes sipas pikës 3 të nenit 329/b k.p.p; kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve disiplinuar në shkronjën 'b' pika 3, e nenit 329 k.p.p; kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes normuar në shkronjën 'c' pika 3, e nenit 329 k.p.p.

Njësoj sin ë rastin e shqyrtimit të ankimit kundër vendimit të prokuroit për pushimin e akuzës ose çështjes, kur hetimet konstatohen të plota gjykata duke pranuar kërkesën e prokurorit vendos proceduralisht zgjidhjen e çështjes me formulimin "*pushimin e akuzës ose ceshtjes*" Është rasti kur pas ushtrimit të kontrollit gjyqësor është konstatuar se prokuroi rregullisht nuk kërkon të ushtroj ndjekejn penale. Po ashtu, kur gj.s.p konstaton se hetimet e prokuroit jaanë të plota por asnjë nga rrethanat e parashikuara në pikën 1 të nenit 328 k.p.p nuk mund të inkuadrohet, kërkesa e prokuroit rrëzohet më formulimin "*kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes*" normuar në shkronjën 'c', pika 3, e nenit 329 k.p.p. Ky është rasti kur prokurori shkel detyrimin kushtetues që imponon atij të drejtën dhe detyrimin për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësuar akuzën në gjyq në emër të shtetit.

Nëse gj.s.p konstaton se hetimet nuk janë të plota rrëzon kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes duke vendosur "*kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve*" sipas përcaktimeve të shkronjës 'b', pika 3 e nenit 329 k.p.p.

“Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime...”¹⁶² duke lindur kështu detyrimi për prokurorin që të rregjistroj veprën penale dhe nëse rezulton nga aktet edhe emrin e personit të cilit vepra penale i atribuohet. Në të kundërt, edhe pse hetimet janë urdhëruar nga gjykata, mos shënimi në rregjistrin e njoftimeve i transformon ato në përndjekje ndaj ati kundrjet të cilit bien e per organin procedues fakti përkthehet në shkelje disiplinore ose përmban tërësinë e elementëve objektiv dhe subjekti të kërkuara nga ligji për ekzistencën e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës parashikuar nga neni 248 k.p.

Nuk parashikohet detyrimi i gj.s.p të shpall vendimin në prani të palëve ndaj në respektim të nenit 113 k.p.p *“origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim.”*

Parashikohej se gj.s.p., kur pranonte anikimin kundër vendimit të pushimit të prokurorit që procedonte për kundërvajtje dhe i kthente aktet prokuroit duke e detyruar atë të vazhdoj hetimet apo të paraqes kërkes për dërgimin e çështjes ne gjykim ose kur e detyronte ate të kryente hetime për vepra apo persona që rezultojnë nga aktet e procedimit, ushtrimi i funksioneve të prokurorit nuk dukej se ishte në lartësinë e duhur, ndaj njoftohej drejtuesi i prokurorisë. Ligjvënsi nuk i ka dhën këtë mundësi gj.s.p që rrëzon kërkesën e prokuroit per pushimin e akuzës soe çështjes dhe i kthen aktet. Gjithsesi nëse gj.s.p në një rast të till vendos të njoftoj drejtuesin e prokurorisë nuk do të ishte në tejkalim të kompetencave.

Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit. Gjukata e apleti mund të disponoj sipas katër formulave: pranimin e ankimit të të pandehurit

¹⁶² Neni 329/b, pika 5, k.p.p.

duke ndryshuar disponimin e vendimit të pushimit me një formulim më të favorshëm¹⁶³; pranimin e ankimit të viktimës dhe urdhërimin e vazhdimin të hetimeve;¹⁶⁴; pranimin e ankimit të viktimës dhe urdhërimin e dërgimit të ceshtjes ne gjyq;¹⁶⁵ dhe së fundmi kur vendos pranimin e ankimit të prokurorit vendos pushimin e akuzës ose ceshtjes.

Nuk parashikohet detyrimi i gj.s.p të shpall vendimin në prani të palëve ndaj në respektim të nenit 113 k.p.p “*origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre*”

Edhe disponimi i gjykatës së apelit, njësoj si disponimi i gj.s.p është i lloit urhdërkur vendos kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kthimin e aktev prokuroit dhe detyrimin për të ngritur akuzë në gjyq, sidoqoftë duke lënë në fuqi apo duke ndryshuar disponimin e gj.s.p, dhe është disponim i lloit vendim kur vendos pushimin e akuzës ose ceshtjes. Nga sa më sipër, nuk parashikohet në rastin konkret rekursi gjykatën e lartë për urhdërin e gjykatës së apelit ndërsa i rekursueshëm është vendimi i gjykatës së apelit për pushimin e akuzës ose ceshtjes në respektim të nenit 432 k.p.p.

4.8.3 Revokimi i vendimit të pushimit

Vendimi i pushimit duke qenë se është marrë në gjendjen që janë aktit, është i efektshëm për sa kohë ato qëndrojnë atë tilla/rebus sic santibus, pasi nëse “*dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i*

¹⁶³ Neni, 329 k.p.p, pika 8.

¹⁶⁴ Neni, 329 k.p.p, pika 8.

¹⁶⁵ Neni, 329 k.p.p, pika 8.

*seancës paraprahe...*¹⁶⁶ Objekt revokimi është vendimi i pushimit, i shpallur në cdo gjendje dhe shkallë të procedimit. “Sipas një interpretimi sistematik është e arsyeshme të konsiderohet se mbi vendimin e pushimit të prokurorit disiplinon neni 292 k.p.p i cili edhe pse disiplinon rifillimin e hetimeve kur me pas behet ankimi i viktimës ankuese që një kusht procedimi është njësoj nuk pengohet prokurori edhe kur ‘*dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar*’ sepse mungesa e tyre ka detyruar prokurorintë vendosë pushimin e çështjes/akuzës.¹⁶⁷

Polgjqy, prokuroi dhe vetë viktima nuk janë të ndaluar të zbulojnë apo marrin prova që mund të dalin rishtazi dhe tregojnë se vendimi ka qënë i pabazuar edhe nëse është nxjerr vendim për pushimit të procedimit.

Normohet se prokurori dhe viktima janë subjektet e legjitimuar për të kërkuar revokimin e vendimit të pushimit dhe “*kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës*”.¹⁶⁸ Mos shoqërimi i kërkesës me prova të reja, pashmankshmërisht passjell mospranimin e saj edhe kryesisht nga ana e gjykatës. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi pa praninë e palëve nga gj.s.p që vendos në kontradiktoritetin e siguar nëpërmjet shkresave, që janë vendimi i pushimit, kërkesa për revokim dhe prova e re që duhet të shoqëroj kërkesën. Nuk parashikohen afate për ngritjen e kërkesës por gjithsesi që të jetë e efektshme ajo duhet të paraqitet brenda afateve të përgjithshëm të parashkrimit të ndjekejes penale parashikuar nga neni 66 k.p. Konsiderohet provë e re ajo që nuk është marrë në konsideratë për vendimarrjen e pushimit pavarësisht nëse ka qënë e njohur apo jo në atë moment. Kur gj.s.p gjen të bazuar kërkesën “*revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet*”¹⁶⁹

¹⁶⁶Neni 329/c, k.p.p .

¹⁶⁷ D.Lara “*Koment mbi procedurën penale*” Botimet Morava Tiranë 2019, fq 1059.

¹⁶⁸ Neni 329/c pika 2, k.p.p.

¹⁶⁹ Neni 329/c pika 3, k.p.p.

Prokurori, për të njëjtin fakt historik penalisht të rëndësishëm procedon me rregjistrimin në rregjistrin e njoftimeve të veprave penale dhe kryen të gjitha veprimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të k.p.p., prokurori procedon sipas nenit 331 k.p.p.

Diponimi i gj.s.p, qoftë kur vendos mospranimin e kërkesës, rrezimin e saj apo revokimin e vendimit të pushimit, depozitohet në sekretari brenda 5 ditëve nga bërja¹⁷⁰ e tij dhe duke qenë se është vendim i ankimeshëm, sekretaria e gjykatës njofton prokurorin dhe viktimën.

Vendimi i mospranimit të kërkesës dhe ai i rrezimit të kërkesës mund të ankimohen në gjykatën e apelit, ndërsa vendim që revokon vendimin e pushimit nuk është i ankimeshëm.

Gjykata e apelit njësoj si gj.s.p shqyrton ankimin në dhomë këshillimi në bazë të akteve shkresore, të vendimit të pushimit që kërkohet të revokohet, ankimi, fashikulli i prokurorit, dhe vendimit që rrezon kërkesën për revokim. Gjykata e apelit ka të njëjtattribute me gj.s.p ndaj mund të urdhëroj si gj.s.p mospranimin e ankimit, pranimin e ankimit dhe rifillimin e hetimeve, rrezimin e ankimit.

Në rast se pranohet kundërshtimi i urdhërit të mospranimit, gjykata e apelit nuk mund të shqyrtoj kërkesën në themel por vetëm mund të prish urdhrin e mospranimit dhe të kthejë aktet për rigjykim pranë të njëjtit gj.s.p. Vendimi i gjykatës së apelit depozitohet në sekretari Brenda pesë ditëve nga bërja e tij.

Mbi bazën e parimit të përgjithshëm se *'ligji cakton rastet në të cilat ... urdhrat e gjykatës mund të ankimohen'*,¹⁷¹ disponimi i gjykatës së apelit nuk mund të rekursohet në GjL sepse ligji hesht. Nuk

¹⁷⁰ Neni 113 k.p.p.

¹⁷¹ Neni 407, pika 1 k.p.p.

gjen në këtë rast mbulesë të ligjshme parashikimi I nenit 432 pika 1 k.p.p sipas së cilit '*rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet...*'¹⁷²

4.8.4 Kërkesa për dërgimin e çështje në gjyq

Kuadri normativ parashikon se prokurori në rrugë të zakonshme, kërkon dërgimin e çështjes në gjyq, ose më sakt kërkon senacën paraprake që gj.s.p në fund të saj të disponoj dërgimin e çështjes në gjyq. Seanca paraprake, megjithëse mban këtë emër, jo gjithmonë paraprijën gjykimin në themel. Ajo çelet në të gjitha ato raste kur nuk procedohet me gjykim të drejtëpërdrejtë, kur nuk kërkohet miratimi i marrveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, kur nuk kërkohet dënimi me urdhër penal si dhe kur nuk kërkohet pushimi i çështjes për krime apo nuk vendoset pushimi i çështjes për kundravajtje.

Sic do të shohim më poshtë kur të flasim për senacën paraprake, kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq që në thlb konsiston në ushtrimin e ndjekjes penale, është e pavlefshme nëse prokurori nuk njofton palët mbi përfundimin e hetimeve paraprake, nëse njoftimi nuk përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje, nëse i pandehuri nuk njoftohet gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e

¹⁷² D.Lara "*Koment mbi procedurën penale*" Botimet Morava Tiranë 2019, fq 1061.

hetimeve shtesë, të bëjë deklaratime apo të kërkojë që të merret në pyetje si dhe nëse i pandehuri kërkon të pyetet, dhe prokurori nuk procedon me pyetjen e tij.¹⁷³

Kërkesës i bashkëlidhet fashikulli me njoftimin për veprën penale, dokumentat në lidhje me hetimet paraprake, duke përfshirë eventalisht hetimet e kryera nga pol.gjyq dhe procesverbalet e akteve të përpiluara para gjyqtarit, sic mund të jetë ai i seancës së vleftësimit të arrestimit në flagrancë apo i ndalimit apo vendimet e marra në lidhje me kërkesat për sigurimin e provës. Nëse hetimet ju referohen disa personave apo disa akuzave, në fashikull bëjnë pjesë aktet për pjesën që ju referohen personave apo akuzave për të cilat ushtrohet ndjekja penale.

Konkretisht, kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq përmban *“kërkimin që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq”* që padyshim duhet të evidentohet që në krye të kërkesës; *gjenealitetet e të pandehurit*, kërkesa përpilohet vetëm në rastet kur njihet i pandehuri pasi në të kundërt do të ishim në kushtet e pezullimit të hetimeve; *gjenealitetet e viktimës*, e cila në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja 'dh', k.p.p thirret në senacën paraprake dhe senacën gjyqësore gjithmonë kur është e mundur, kur ka shfaqur interes në procedim dhe vendbanimi rezulton nga aktet e procedimit; *parashtrimin e faktit penal*, që konsiston në elementet objektive të veprës që kanë të bëjnë me veprimin/mosveprimin, pasojnë nëse është veprë penale materiale, lidhjen shkaksore dhe në përgjithësi faktin historik për të cilin i pandehuri do të mbrohet; *cilësimin juridik të veprës penale*, identifikimi sipas prokurorit i normës që mbron marrëdhënjen juridike që dyshohet e cënuar apo e vënë në rrezik nga i pandehuri; *burimet e provës dhe faktet që ato u referohen* në të mundur evidentimin e burimeve të provës me anë të

¹⁷³ Neni 329 pika 2 k.p.p *“Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është e pavylefshme kur nuk respektohen përcaktimet e paragrafëve 2, 3 dhe 4, të nenit 327, të këtij Kodi.”*

së cilave prokurori pretendon të rindërtoj faktin historic si dhe mundësi për përgatitjen e mbrojtjes teknike; *datën dhe nënshkrimin e prokurorit.*

“Duke normuar në mënyrë taksative përmbajtjen, tregohet qartë se kërkesa nuk duhet të jetë e arsyetuar; qëllimi i ligjvënsit është të mos i ngarkoj punë prokurorit dhe në të njëjtën kohë të shmang cdo kushtëzim të gj.s.p”¹⁷⁴

Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, e ngritur në përfundim të hetimeve paraprake, është veprimi procedural që ndan fazën e procesit gjyqësor nga procedimi për hetimet paraprake, këtij përfundon edhe veprimtaria e gj.h.p.

“Kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.”¹⁷⁵

¹⁷⁴ P.Tonini *“Manuale di procedura penale”* Tredicesima edizione, Giufre Editore-Milano, 2012, Parte terza, Capitolo III, La fase introduttiva dell’udienza preliminare, Gli adempimenti che precedono l’udienza.

¹⁷⁵ Neni 331 pika 4 k.p.p.

Kapitulli V

Seanca paraprake¹⁷⁶

5.1 Hyrje

Në ndryshimet e aplikuara me ligjin 35/2017 në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar seanca paraprake e cila zhvillohet në të gjitha ato raste kur më parë nuk është vendosur pushimi i çështjes, kur nuk procedohet me gjykim të drejtëpërdrejtë, kur nuk procedohet me dënimin me marrëveshje¹⁷⁷. Kontrolli i hetimeve dhe akuzave të ngritura nga prokurori nuk kryhet më prej eprorit të tij që në rastet e zakonshme ishte drejtuesi i prokurorisë e në raste të veçanta Prokurori i Përgjithshëm por veprimtaria e zhvilluar në fazën e hetimeve paraprake shohet nga gj.s.p në kontradiktoritet mes palëve¹⁷⁸

Gjyqtari i seancës paraprake duhet të jetë i ndryshëm nga gjyqtari i hetimeve paraprake dhe nga ai i debatit gjyqësor.¹⁷⁹

Parashikimi i gjyqtarit të seancës paraprake mënjanon zhvillimin e proceseve të panevojshme dhe i debateve gjyqësore shterpë për shkak se çështja mund të kalojë në fazën e debatit gjyqësor

¹⁷⁶ Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilët thuhet: “*Qëllimi kryesor i parashikimit të kësaj figure për kontrollin e veprimeve të prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe forcimi i fazës së hetimit, si faza më e dobët e procesit penal edhe përpara decentralizimit të prokurorisë, realizohet nëpërmjet kompetencave konkrete që i janë lënë këtij gjyqtari. Kështu, përveç rastit të shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, gjyqtari i seancës paraprake ka për detyrë të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar në prova dhe ligj si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë së akteve. Për këtë arsye është parashikuar që seanca paraprake të zhvillohet me dyer të mbyllura dhe në të të jenë të pranishëm vetëm prokurori, i pandehuri dhe/ose mbrojtësi i tij i detyrueshëm, viktima dhe nëse ka, palët private”*

¹⁷⁷ Respektivisht: Nenet 328 & 329/a, neni 400; 406/a dhe 406/dh, k.p.p.

¹⁷⁸ K.Kurushi “Akuzat e reja në procesin penal” Disertacion për mbrojtjen e grades Doktor, U.T Tiranë 2017, fq78

¹⁷⁹ Neni 15 k.p.p

vetëm nëse akuza është formuluar në mënyrë të qartë dhe nuk është mbështetur në prova kontradiktore dhe të pamjaftueshme.¹⁸⁰

Gjyqtari i seancës paraprake mund të investohet ose nga i pandehuri, viktimja apo trashgimtarët e saj kur kundërshtojnë vendimin e prokurorit i cili duke proceduar për kundravajtje penale vendos pushimin e akuzës apo çështjes¹⁸¹ ose nga prokurori i cili kur procedon për krime kërkon pushimin e akuzës apo çështjes¹⁸² ose gjithmone nga ky i fundit kur në perfundim të hetimeve konstaton se ato janë të plota dhe kërkon dërgimin e çështjes në gjyq.¹⁸³

Në rastet kur kërkohet pushimi i çështjes nga prokurori që procedon për krime apo ankimohehet nga pala e interesuar vendimi i tij për pushimin e çështjes kur procedon për kundravajtje penale gjykohehet nga gj.s.p por nuk zbatohen rregullat e percaktuara nga nenet 332-332/g k.p.p të cilët gjene aplikim vetëm në rastet kur prokurori kërkon dërgimin e çështjes në gjyq.

Pavarësisht se tashmë do të kemi një harxhim më të madh të kohës së gjykimit pasi “prokurori do të paraqitet disa herë në dyert e gjykatës” nga ana tjetër do të kemi më shumë garanci proceduriale dhe më pak veprime proceduriale të kryera jo në formën e kërkuar nga ligji.¹⁸⁴

Të gjitha këto ndryshime janë bërë duke marrë si model seancën paraprake të parashikuar në Titullin e IX të Kodit të Procedurës Penale të Italisë¹⁸⁵.

180 Y.Shkreli “Roli i gjykatës gjatë hetimeve paraprake dhe në fazën paragyqësore” Botimë i Shkollës së Magjistraturës, Magjistrati VIII, Tiranë 2016 fq.225

181 Neni 329 K.Pr.P “Ankimi kundër vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes”

182 Neni 329/a K.Pr.P “Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështje”

183 Neni 331 K.Pr.P “Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq”

¹⁸⁴ A.Belishta “Aplikimi i akuzave të reja në procesin penal” Shtypshkronja Kotti, Korçë 2017, fq 178.

5.2 Përgatitja për seancë paraprake

Në Titullin VI, Kreu IX të K.Pr.P gjenden dispozitat që displinojnë seancën paraprake të cilat janë shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017. Për të evituar aritjen në rezultate paraprakisht të paralajmëruara për shkak të kontaminimit subjektiv që domosdoshmërisht karakterizon gjyqtarin që në një fazë të procedimit është shprehur, kompetencat e gj.h.p në këtë moment konsiderohen të përfunduara.

Neni 332 K.Pr.P stabilizon afatet për caktimin e seancës paraprake. Pika e parë e nenit përcakton se gjyqtari i seancës paraprake brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq duhet të caktoj datën e zhvillimit të seancës.

Në pikën e dytë të këtij neni thuhet se, *“nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, deri në datën e seancës nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë”*. Pika 3 e këtij neni detyron Gjykatën të vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj. Parashikim të tilla nuk janë bërë në rastin kur prokurori kërkon pushimin e akuzës ose të çështjes.¹⁸⁶

Normohet se gjyqtari i seancës paraprake njofton të pandehurin dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, duke treguar ditën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca, njoftohet gjithashtu prokurorit dhe mbrojtësit e të pandehurit, duke i bërë të ditur këtij të fundit të drejtën për t’u njohur me aktet e depozituara, si dhe për të paraqitur memorje ose dokumente. Prokurori ftohet të depozitojë të gjitha aktet e kryera pas paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, pasi mund të ketë kryer veprime në harkun kohor midis depozitimit të kërkesës dhe ditës së

¹⁸⁵ Nenet 416-437 K.Pr.P italian.

¹⁸⁶ Neni 329/b K.Pr.P *“Shqyrtimi i kërkesës”*

seancës dhe për të garantuar parimin e kontradiktoritetit palët duhet të njihen edhe me këto veprime. Njoftimet e sipërcituara duhet të bëhen të paktën dhjetë ditë para datës së seancës.¹⁸⁷

Dispozitat e neneve 332 dhe 332\A të K.Pr.P e vendosin gjyqtarin në një pozicion të tillë që duhet të bëjë një zgjedhje ose të aplikoj nenin 332\2 i cili e detyron të vendosi datën e seancës jo më larg se 10 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, ose të aplikoj nenin 332\A i cili e detyron të njoftoj palët të paktën 10 ditë para datës së seancës, pasi gjyqtari paraprakisht ka nevojë për një hark kohor të caktuar për të studiuar dosjen dhe për tu njohur me aktet dhe nuk mund që kontekstualisht me depozitimin e kërkesës të caktoj seancën dhe të njoftoj palët.¹⁸⁸ Në të kundërt gj.s.p është i detyruar që në një ditë që mbrrin në gjykatë kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, të caktoj datën e seancës në ditën e dhjetë dhe kontekstualisht të njoftojë palët. Gjithsesi këto afate asnjë pasojë nuk shkaktojnë për gjyqtarin magjistrat por mund të përbëjnë shkak për përgjegjësi disiplinore pasi në bazë të Nenit 2 k.p.p “...këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal...”

Kjo veprimtari nuk është e gjitha në dorën e gj.s.p pasi mbrritja e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq përpara tijë ka të bëjë edhe me faktor të tipit administrative në kuptimin që nëse nuk do të hidhej shorti në gjykatë në ditën që mbrrin kërkesa do të ishte gj.s.p përpara dy dispozitave kontradiktore. Për të bërë një zgjedhje sa më korrekte nëse do të ishim përpar dy

¹⁸⁷ Neni 332/a K.Pr.P “Veprimet përgatitore”

¹⁸⁸ Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilët thuhet shprehimisht se “Gjyqtari ka detyrimin të njoftojë palët për datën dhe orën e seancës paraprake të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të saj, në mënyrë që t’u japë mundësinë të njihen me të gjitha aktet e hetimit paraprak dhe të përgatisin pretendimet e tyre”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Seksioni i Hetimeve dhe Seancës Paraprake. Vendim nr.864 dt. 02.03.2018. Gjyqtari E.Bani, arrin në përfundimin se : “Sa më sipër u arsyetua, Gjykata në çështjen objekt gjykimi vendosi të njoftojë palët për datën dhe orën e seancës paraprake të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të saj, në mënyrë që t’u japë mundësinë të njihen me të gjitha aktet e hetimit paraprak dhe të përgatisin pretendimet e tyre”

dispozitave të kundërta, duhet të bëhet një interpretim në harmoni me vendimet e Gjykatës Kushtetuese¹⁸⁹ dhe me parimet themelore nga të cilat udhëhiqet procesi penal.

5.3 Hapja e seancës, verifikimi i paraqitjes së palëve dhe rinovimi i njoftimeve.

Neni 332/b K.Pr.P i titulluar “Verifikimi i paraqitjes së palëve”, në pikën e parë përcakton se gjyqtari i seancës paraprake zhvillon një seancë gjyqësore me dyer të mbyllura në prani të detyrueshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit, me qëllim kontrollin e hetimeve të përfunduara nga prokurori përpara se çështja penale e hetuar të dërgohet për gjykim. Gjykata verifikon paraqitjen e palëve, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimeve në rast se ato nuk kanë marrë njoftim ose kur njoftimi është i dyshimtë apo është deklaruar i pavlefshëm. Seanca paraprake nuk mund të zhvillohet nëse konstatohet se njëra prej palëve nuk ka marrë njoftim apo se njoftimi është i dyshimtë dhe për këtë gj.s.p është i detyruar të shtyj seancën dhe të urdhëroj përsëritjen e njoftimeve. Kur mbrojtësi i të pandehurit nuk është i pranishëm, gjykata i cakton një mbrojtë kryesisht pasi zbatohet neni 49 i k.p.p i cili disiplinon rastet e mbrojtjes së detyrueshme. Mungesa e mbrojtësit në asnjë rast nuk përlligj shtyrjen e seancës dhe kur ajo ndodh për shkaqe të pa arsyeshme gj.s.p mund caktoj gjobë ndaj tij nga 5.000 deri në 100.000 lekë dhe mund ta

¹⁸⁹ Vendimin Nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera thuhet se: “...në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën. Vendimi nr.7, datë 16.02.2015 i Gjykatës Kushtetues “ Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohet” Në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 9, datë 26.02.2007; Nr. 36, datë 15.10.2007; Nr. 52, datë 01.12.2011. thuhet se “parimi i sigurisë juridike ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim kërkohet që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të

urdhëroj të paguaj shpenzimet e seancës.¹⁹⁰ Kur i pandehuri, në gjendje të lirë apo i paraburgosur, nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, gjykata deklaron me vendim mungesën e tij. Në këto raste i pandehuri quhet i pranishëm, me kusht që të përfaqësohet nga mbrojtësi. Quhet i pranishëm edhe i pandehuri që, pasi është paraqitur, largohet nga seanca ose i pandehuri i pranishëm në një seancë, por që nuk paraqitet në seancat vijuese. Vendimi për deklarimin e mungesës revokohet, edhe kryesisht, kur i pandehuri paraqitet. Kur i pandehuri nuk paraqitet në seancë dhe del se mungesa është shkaktuar për shkak të ndonjë pengese të ligjshme, gjykata, edhe kryesisht, shtyn seancën dhe urdhëron përsëritjen e njoftimeve. Zbatohen rregullat që kanë të bëjnë me pezullimin e afateve të paraburgimit të disiplinuar në nenin 265 k.p.p që përcakton pezullimin e afateve të paraburgimit në rastet e shtyrjes së seancës për shkak të kërkesave të padrejta të të pandehurit apo mbrojtësit të tij ose për shkak të mosparaqitjes a largimit të mbrojtësit¹⁹¹.

Përsa i përket kërkesës së prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes, ajo zhvillohet në prani të palëve të cilat duhet të njoftohen nga gjyqtari i seancës paraprake, por prezenca e tyre në seancë nuk është e domosdoshme.¹⁹²

5.4 Diskutimi midis palëve gjatë shqyrtimit.

¹⁹⁰ Neni 350 pika 5 k.p.p

¹⁹¹ Neni 332/b k.p.p

¹⁹² Neni 329/b pika 2 K.Pr.P “*Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.*”

Pasi verifikon dhe legjitimon paraqitjen e palëve, gjykata e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe fton të parin prokurorin të paraqes në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimeve paraprake dhe provat ku mbështetet kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq.¹⁹³

Pas diskutimit të prokurorit, i pandehuri ka të drejtë të parashtojë kërkesat e tij por duke pasur parasysh karakterin vecanërisht teknik të kësaj faze të procedimit dhe prezencën e detyrueshme të mbrojtësit është ky i fundit që *de facto* parashtron kërkesa për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të tjera edhe nëpërmjet institutit të sigurimit të provës, si dhe që mund të bëjë i pandehuri deklaratimet që i çmon të nevojshme ose të kërkojë që të pyetet. Për më tepër është në këtë moment procedural kur i pandehuri ka të drejtë të kërkojë gjykimin e shkurtuar, ose në bashkëpunim me prokurorin të kërkojë të arrij në një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Ligjvënsi parashikon se kërkesat në lidhje me pavlefshmërinë absolute të akteve dhe ato në lidhje me papërdorshmërinë mund të ngrihen në cdo moment pasi nuk ka afate që i kufizojnë, kërkesat që kanë të bëjnë me pavlefshmëritë relative normohen nga afate rreptësisht të ndaluar duke qenë se neni 129 pika 5 e k.p.p përcakton se *“afatet për të ngritur dhe kundërshtuar pavlefshmërinë nuk mund të zgjaten”*.¹⁹⁴

¹⁹³ Sipas autorit D.Lara në botimin e tijë *“Koment mbi procedurën penale”* Botimet Morava Tiranë 2019: *“Kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk duhet të jetë e arsyetuar pasi ga njëra anë lehtëson veprimtarinë e prokurorit dhe nga ana tjetër eviton mundësinë që qëëndrimi i gj.s.p të kontaminohet para se të dëgjoj palët në process. Përsa i përket parashtrimeve të prokurorit gjatë zhvillimit të senacës paraprake sipas të njëjtit autor, prokurori diskuton mbi vlerën e provave të cilat nuk janë gjë tjetër vecse rezultat i hetimeve që ka zhvilluar në bashkëpunim me pol.gjyq dhe kështu arsyeton sit ë legjitimuar kërkesën e tij për dërgimin e çështjes në gjyq”*.

¹⁹⁴ Në këtë kontekst përqëndrimi i mbrojtësit duhet fokusohet piksëpari në pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq kur nuk respektohen paragrafët 2,3 dhe 4 të nenit 327 k.p.p (sanksionuar nga neni 332 pika 2 k.p.p). Gjithsesi që këto pretendime të marrin vlerë ato duhet të jenë ngritur një herë përpara prokurorit dhe ky i fundit të mos i ketë marrë parasysh pasi në baz të nenit 129 pika 2 k.p.p *“Kur pala është e pranishme, pavlefshmëria e një akti duhet të kundërshtohet përpara se ai të bëhet ose, kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi është bërë”* dhe *“Gjatë hetimeve paraprake çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori dhe nëse nuk kryhet nga ky i fundit, çmohet nga gjyqtari i seancës paraprake” neni 130 pika 4 k.p.p”*.

Pas të pandehurit është rradha e viktimës të paraqesi pretendimet e sajë, nëse është paraqitur, pretendime të cilat nëse hetimet kanë qenë të plota, përforcojnë qëndrimin e prokurorit.

Megjithatë prokurori ka detyrimin ligjor të grumbullojë edhe provat që shkojnë në favor të të pandehurit¹⁹⁵, mund të ndodhë që gjatë hetimeve paraprake me dashje apo nga pakujdesia dicka në këtë drejtim të ketë shpëtuar dhe janë pikërisht kërkesat e të pandehurit të cilat nëse gj.s.p i gjen të bazuara bëjnë të mundur lindjen e detyrimit për prokurorin për plotësimin e hetimeve.¹⁹⁶ Ligji parashikon edhe se gj.s.p edhe pa u vënë në lëvizje nga palët mund të urdhërojë prokurorin për plotësimin e hetimeve që do të thotë se një urdhër i tillë jo domosdoshmërisht shkon në favor të të pandehurit por bëhet fjalë për një projektim inkuizitor në një sistem akuzator.¹⁹⁷ Një herë që prokurori është i vendosur për dërgimin e çështjes në gjyq nuk ka arsye pse të diskutohet vendimi i prokurorit titullar i së drejtës – detyrimit për të dërguar çështjen në gjyq nëse kjo nuk ndodh për shkak se prokurori ka ometuar të marrë prova që shfaqojnë apo lehtësojnë pozitën e të

¹⁹⁵ Nente 8/a pika 2 dhe 301 pika 1 k.p.p

¹⁹⁶ K.Kurushi “Akuzat e reja në procesin penal” Disertacion për mbrojtjen e gradës Doktor, U.T Tiranë 2017, fq78:

“Nëse ai vlerëson se hetimet nuk janë të plota, pra nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme në funksion të faktit penal të hetuar dhe akuzës së ngritur nga prokurori urdhëron plotësimin e tyre duke përcaktuar drejtimin e hetimit dhe kur është rasti, gjyqtari mund të vendosë edhe për aktet konkrete që duhet të kryhen nga ana e prokurorit.”

¹⁹⁷ Neni 332/ç i K.Pr.P i titulluar “Vendimi për plotësimin e hetimeve, parashikon se: “Kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur, urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re.”

pandehurti.¹⁹⁸ Gj.s.p duhet të vendosi mbi kërkesën e prokurorit Brenda një afati 30 ditorë ndaj edhe afati i caktuar për përfundimin e hetimeve në raste të tilla duhet të jetë brenda datës së seancës së re.

Pasi prokurori ka përmbushur urdhërin e dhën nga gj.s.p për plotësimin e hetimeve ka mundësi që ‘fakti penal të dal ndryshe’, të rezultoj një ‘vepër tjetër penale’ apo nje ‘tjetër fakt’ si dhe të dal një ‘rrethanë rënduese’ situatë e cila është disiplinuar nga neni 332/d k.p.p.¹⁹⁹

Shqyrtimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq në një seancë paraprake nga një gjytar i vetëm, i jep mundësi këtij të fundit, të njihet me faktin që përbën vepër penale dhe, të njihet me dispozitat ligjore penale që prezumohet se përmbajnë tërësinë e elementëve objektiv dhe subjektiv të faktit që i atribuohet të pandehurit.

Kërkesa për gjykim, pasi ka kaluar në filtrin e seancës paraprake sipas përcaktimeve të nenit 332/d të K.Pr.Penale, akuza e shqyrtuar në këtë seancë merr formën e një akuzë të qartë në përfundim të seancës paraprake. Qartësia e akuzës është produkt i diskutimit që realizohet në seancë paraprake midis palëve në proces. Nëse akuza e ngritur në hetim rezulton me probleme gjatë diskutimit në seancë paraprake, prokurori ka mundësi ta reflektojë këtë diskutim në veprimin e ndryshimit të akuzës apo njoftimin e një akuze për një fakt të ri penal.

¹⁹⁸ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.540

¹⁹⁹ Rrethanat në fjalë, në mënyrë të detajuar disiplinohen në Pjesën e Dytë, tituli VII, Kreu II, seksioni IV Akuzat e reja, nenet 372, 373, 374 dhe 376 k.p.p.

Neni 332/d i K.Pr.P i titulluar Ndryshimi i akuzës në seancën paraprake parashikon se: “1. Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton një vepër tjetër penale, sipas shkronjës “b”, të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuza e re i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin. 2. Kur gjatë seancës paraprake në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe për të cilin duhet të procedohet kryesisht, gjykata lejon komunikimin e akuzës për faktin e ri, kur prokurori paraqit kërkesë dhe i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, gjykata i kthen prokurorit aktet që lidhen me akuzën e re dhe njofton drejtuesin e prokurorisë. 3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t’i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.”

Nëse prokurori nuk ndërhyt vetë në rregullimin e kësaj situate juridike, atëherë gjyqtari ka mundësi të ftojë prokurorin për të bërë korrigjimet apo saktësimet e nevojshme. Nëse prokurori nuk vepron, atëherë gjykata vendos që t'i kthejë aktet prokurorit për vazhdimin e hetimeve

Për të kapur diferencën midis “faktit të ri” dhe “faktit të ndryshëm” duhet të kemi parasysh se fakti mbetet i pa ndryshuar nëse nuk ndyshojnë elementet përbërës të sjelljes, ngjarja dhe elementi psikologjik.

Jemi përpara “faktit të ndryshëm” çdo herë që evidentohet një transformim, një zvendësim ose një ndryshim i faktit fillimisht të atribuar.

Jemi përpara “faktit të ri” të pa deklaruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, çdo herë që i shtohet faktit të atribuar fillimisht një fakt absolutisht i ndarë, një fakt tjetër nga fakti fillimisht i atribuar.²⁰⁰

Nëse gjatë seancës paraprake del një fakt i ri i pa specifikuar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, nëse prokurori bën kërkesë dhe i pandehuri jep pëlqimin, fakti i atribuohet të pandehurit, në rast të kundërt prokurorit i kthehen aktet dhe gjykata njofton drejtuesin e prokurorisë.

Në të gjitha rastet e ndryshimit të akuzës gjatë seancës paraprake, kur fakti del ndryshe, kur del një veprë penale tjetër, një rrethanë rënduese apo një fakt i rig j.s.p akordon një afat të përshtatshëm në mënyrë që mbrojtja e të pandehurit të përgatitet.

Nëse gjykata konstaton se prokurori nuk ka bërë cilësim të saktë ligjor ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, e fton prokurorin dhe i kërkon të modifikoj apo të

²⁰⁰ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.540

qartësoj akuzën dhe nëse prokurori nuk e bën i kthehen aktet dhe njoftohet drejtuesi i prokurorisë.²⁰¹ Parashikohet ky normim për ti dhënë kohë prokurorit ‘kokëfortë’ që në konsultë me Drejtuesin e zyrës së prokurorisë të reagoj pozitivisht mbi indikimet që i janë dhënë nga gj.s.p.²⁰² Nëse prokurori bën qartësimet dhe saktësimet e nevojshme, ato i njoftohen të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të cilët natyrisht nevo për kohë kanë në mënyrë që të ndryshojnë dhe impostojnë strategjinë e mbrojtjes.

5.5 Vendimi që i jep fundë seancës paraprake

Në rast se gj.s.p çmon se provat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake, janë të plota dhe të marra në respektim të rregullave të K.Pr.P, d se është bërë një cilësimi i saktë ligjor i faktit që i atribuohet të pandehurit dhe se nuk ka kërkesa apo nevoja për marrjen e provave të reja atëher ai deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor.

Siç u argumentua edhe më sipër, gj.s.p është kompetent të vendos si kur prokurori kërkon pushimin e akuzës ose çështjes ashtu edhe mbi kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq.

Neni 332/dh i titulluar Vendimi i gjyqtarit të seancës në paraprake në pikën “ç” stabilizon se:

“Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos:... pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë

²⁰¹ D.Lara në veprën “Koment mbi Proceduren Penale” Botimet Morava, Tiranë 2019 në fq 1072 përcakton se “Duke marrë shkas nga sistematika e renditjes së normave, ... bëhet fjalë për urdhër të gj.s.p përgjat zhvillimit të seancës paraprake dhe jo për urdhër të gj.s.p që i jep fund asaj. Të tillë janë vetëm ata që parashikohen në nenin 332/dh k.p.p, sic dërgimi i çështjes në gjyq, pushimi i saj, dërgimi në gjykatë për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar si dhe për miratimin e marrëveshjes”.

²⁰² Po aty.

*rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kod*²⁰³ Pavarësisht se prokurori konstaton se provat që ai ka mbledhur gjatë hetimeve paraprake janë të përshtatshme për të mbështetur akuzën në gjyq, gj.s.p pasi dëgjon mbrojtësin e të pandehurit, mund të vendos pushimin e akuzës ose çështjes.

Kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktimja ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.²⁰⁴ Kundër vendimit të gjykatës së apelit që lë në fuqi vendimin e gj.s.p mund të bëhet rekurs pasi neni 432 k.p.p përcakton se *“Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet...”*

Nuk mund të rekursohet vendimi i gjykatës së apelit që urdhëron dërgimin e çështjes për gjykim pasi është një vendim i lloit urdhër dhe ligji që cakton rastet në të cilat urdhrat e gjykatës mund të ankimohen²⁰⁵ në këtë rast hesht.

Neni 329/c K.Pr.P, shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, titulluar Revokimi i vendimit të pushimit, përcakton se: *“ Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj...”*

²⁰³ Formulatat e pushimit të akuzës ose të çështjes të parashikuar në nenin 328 K.PrP janë: “a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimja nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj”

²⁰⁴ Neni 332/gj k.p.p “Ankimi”

²⁰⁵ Neni 407 pika 1 k.p.p

Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin së bashku me provat e reja në të cilat mbështetet, dhe shqyrtohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake.

Kundër vendimit të mospranimit ose të rrëzimit të kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit, prokurori, viktimja ose trashëgimtarët e saj, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, e cila shqyrton ankimin në dhomë këshillimi²⁰⁶

Në rast se gjykata e apelit pranon ankimin kundër vendimit që ka vendosur mospranimin e kërkesës atëherë ajo i kthen aktet pot ë njëjtit gj.s.p duke e detyrar atë të marrë në shqyrtim kërkesën dhe në përfundim të saj të vendos nëse ajo është apo jo e bazuar.

Në rast se nuk vendos pushimin e çështjes gj.s.p merr vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq, vendim i cili është akti introduktiv i gjykimit të themelit që në mënyr alternative mund të instaurohet si gjykim i zakonshëm, i shkurtuar ose kur palët kanë paraqitur marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, vendoset dërgimi i çështjes në gjyq për miratimin e marrëveshjes.

Sidoqoftë, elementet e domosdoshëm të vendimit që dërgon çështjen në gjyq në referim të nenit 332/e k.p.p janë: gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale që vlejné për identifikimin e tij, si dhe gjeneralitetet e palëve private dhe të mbrojtësve të tyre; gjeneralitetet e viktimës, në rast se rezulton e identifikuar; parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit; burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; dispozitivin, duke treguar dhe gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes; përcaktimin e adresës së të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarët e tij dhe palëve të tjera në proces, për efekt të njoftimeve të mëtejshme; datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretarit të seancës gjyqësore.

²⁰⁶ Neni 329/ç K.Pr.P “Ankimi ndaj vendimit”

Elementet e mësipërme nuk kanë të njëjtën rëndësi pasi ndahen në element, të cilët nëse mungojnë sjellin parregullsin e aktit dhe nuk prodhojnë asnjë efekt dhe element të domosdoshëm që e bëjnë aktin relativisht të pavlefshëm.²⁰⁷

Pavlefshmëria e aktit vjen kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë ose janë të pamjaftueshme parashtrimet mbi faktin që përbën veprën penale si dhe identifikimi i dispozitave konkrete të cilat përmbajnë tërësinë e elementeve objektiv dhe subjektiv të faktit me rëndësi penale i cili i atribuohet të pandehurit.²⁰⁸

Listimi në mënyrë taksative dhe skematike i elementeve të vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq tregon se ai konsiston në një disponim të paarsyetuar pasi ‘*ratio legis*’ është të evitohet paragjykimin që do të binte mbi të pandehurin nga kontaminimi i bindjes së brendshme të gjyqtarit të themelit i cili para shqyrtimit gjyqësor do të afirmonte fuqinë e elementeve provues në ngarkim.²⁰⁹ Për më tepër ligji përcakton se “*procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj*”.²¹⁰

Ligji nuk detyron në mënyrë të shprehur gj.s.p të shpall vendimin në seancë me anë të leximit ashtu siç disiplinohet për vendimin e gjykimit në themel por, duke qënë se ligji disiplinon se “kur gjykata vendos dërgimin e çështjes në gjyq, pasi dëgjon palët, përcakton aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit”²¹¹ do të thotë që gj.s.p jo vetëm është i detyruar të lexoj vendimin

²⁰⁷ A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010. fq.593.

²⁰⁸ Neni 332/e pika 2 k.p.p.

²⁰⁹ P.Tonini “*Manuale di Procedura Penale*” Tredicesima Edizione, Giuffrè Editore, Milano 2012.

²¹⁰ Neni 332/dh pika 3 k.p.p.

²¹¹ Neni 332/Ë pika 1 k.p.p.

në prezencën e palëve por edhe duhet ti dëgjoj atom bi pretendimet e tyre për përmbajtjen e fashikullit të gjykimit.

Ligji parashikon se vendimi i gj.s.p, sido qoftë ai, depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tijë dhe sekretaria e gjykatës njofton prokurorin dhe palët e legjitimuar për të bër ankim.²¹²

Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankim. Ndërsa kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktima ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit²¹³

Duke qën se për ritin që zhvillohet para gjykatës së apelit ligji hesht, në mënyrë deduktive arrihet në përfundimin se në Apel zhvillohet një process i njëjtë me atë që zhvillohet pranë gj.s.p që ka dhënë vendimin sic më sipër është argumentuar.

Kësht, nëse kolegji i apelit e gjen ankimin të bazuar, mund të vendos dërgimin e çështjes në gjyq me gjykim të zakonshëm ose të shkurtuar nëse kërkesë nga i pandehuri ka pasur, ose dërgimin e çështjes në gjyq me marrëveshje nëse i pandehuri dhe prokurori kanë rënë dakord paraprakisht mbi mpranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Në rast se kolegji i apelit e gjen ankimin të pabazuar atëher lë në fuqi vendimin e gj.s.p që ka pushuar çështjen.

Në mbështetje të nenit 407 pika 1 k.p.p që parashikon se *“ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit”* disponimi i gjykatës së apelit që ka urdhëruar një nga tre rastet e dërgimit të çështjes në gjyq nuk mund të rekursohet pasi është i lloit urdhër dhe në këtë rast ligji hesht. Në të njëjtën linjë llogjike, rekursi lejohet

²¹² Neni 113 k.p.p *“Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim.”*

²¹³ Neni 332/gj K.Pr.P *“Ankimi”*

kundër disponimit të lloit vendimi të gjykatës së apelit që lë në fuqi vendimin e gj.s.p për pushimin e akuzës ose çështjes, pasi k.p.p në nenin 432 pika 1 parashikon se *“Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet...”* .

5.6 Fashikulli i gjykimit

Menjëherë pas shpalljes së vendimit, gj.s.p ka një detyrë ekstremisht delikate pasi në kontradiktoritetin mes palëve i takon atij të formoj fashikullin e gjykimit.²¹⁴

Për formimin e fshikullit të gjykimit gj.s.p mund të përdorë provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër²¹⁵, të gjitha aktet e kryera pas paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq²¹⁶ si dhe veprimet e kryera për shkak të urdhërit të gj.s.p për plotësimin e hetimeve²¹⁷ ose/dhe sigurimin e provës.²¹⁸

Asnjë seleksionim nuk duhet të bëj gj.s.p në rastet kur vendos dërgimin e çështjes në gjyq me gjykim të shkurtuar apo për miratimin e marrëveshjes ndërsa.

Ndarja e dy fshikujve formon një nga pikat më delikate dhe të komplikuar të kodit duke qenë se paraqitet detyrimi i formimit të provës gjastë shqyrtimit gjyqësor që iplikon shmangjen e

²¹⁴ Neni 332/ë, k.p.p. *“Kur gjykata vendos dërgimin e çështjes në gjyq, pasi dëgjon palët, përcakton aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit”*.

²¹⁵ Neni 331 pika 4 k.p.p

²¹⁶ Neni 332/a pika 2 k.p.p

²¹⁷ Neni 332/ç pika 1 k.p.p.

²¹⁸ Neni 332/c pika 6 k.p.p

kushtëzimit psikologjik të gjyqtari i themelit nga njohja e akteve të hetimeve paraprake jashtë kontradiktoritetit.²¹⁹

“Selektimi i “fashikullit të dyfishtë” lind nga nevoja për të ndaluar që gjykatësi i shqyrtimit gjyqësor, në ushtrimin e pushteteve të tij të matur/diskrecional të ndikohet nga përmbajtja e akteve të hetimeve paraprake që siç e dimë nuk kanë vlerën e provës dhe përfundojnë funksionin e tyre me dërgimin në gjyq të të pandehurit”²²⁰

Daipsozita liston²²¹ vecanërisht se mund të jenë pjesë e fashikullit të gjykimit: aktet që kanë të bëjnë me ushtrimin e ndjekjes penale dhe të kërkesave për pranimin e padisë civile. Sic mund të jenë kallëzimet, kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, apo edhe ekstrakti i shënimit në rregjistrin e prokurorit të faktit që përbën veprën penale apo kërkesa për pranimin e padisë civile që paditësi mund të ketë bërë pranë gj.s.p.; procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme të kryera nga nga prokurori dhe pol.gjyq, sic mund të jenë kontrollet e vendeve që mund të ndryshojnë për të cilat dihet se nuk mund të kryhen gjatë shqyrtimit gjyqësor; procesverbalet e kryera për sigurimin e provës; procesverbalet e veprimeve të plotësuara jashtë shtetit në ekzekutim të letërporosisë të cilat parimisht nuk duhet të rrjedhin nga burimi personal; dëshminë e penaltetit dhe dokumente të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit dhe identifikimin e tij që mund të kenë të jetë ekstrakti i dëshmisë së penaltetit, raporte nga shërbimi i provës apo veprime të tjera që provojnë normalizimine mërrëdhënjeve mes të pandehurit dhe të dëmtuarit; provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, kur nuk duhet të ruhen në vend tjetër. Për provat që nuk mund të ndjekin fashikullin vlen procesverbali i kontrollit apo kqyrjes apo i sekuestrimit që jep dijeni mbi ekzistencën e provës materiale; procesverbalet për veprimet e

²¹⁹ P.Tonini “*Manuale di Procedura Penale*” Tredicesima Edizione, Giufre Editore, Milano 2012.

²²⁰ F. Caprioli “*Compendio di procedura penale*” sesta edizione CEDAM-2012, Capitolo V, Il decreto che dispone il giudizio e la formazione dei fascicoli.

²²¹ Neni Neni 332/ë k.p.p.

këqyrjes, njohjes dhe eksperimentit hetimor. Normuar kështu dispozita nuk lë hapsirë për interpretim por duke fokusuar vëmendjen në shmangjen sa më shumë të jetë e mundur të përdorimit të veprimit shkresor, këto akte lexohen në gjykim vetëm atëherë kur bëhen të papërsëritshme apo për të bër kundërshtime si prova nga burimi personal²²²; aktet e ekspertimit të kryera në kushtet e nenin 314 pika 3 k.p.p që disiplinon aktet e ekspertimit të kryera ne vende, sende apo persona të cilët janë subjekt ndryshimi e kështu të papërsëritshëm; procesverbalet e provës të procedimeve të tjera të lidhura të parashikuara nga neni 193 k.p.p që kanë statusin e provës së lloit dokument; procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve e komunikimeve pasi të jenë selektuar ato përdorimi i të cilave është i ndaluar nga neni 223 pika 4 k.p.p; dhe çdo akt tjetër të rëndësishëm për gjykimin sic mund të jenë proceverbali i arrestimit në flagrancë apo urdhëri i ndalimit të prokurorit apo ankimi i viktimës në veprat penale që ndiqen kryesisht.²²³

5.7 Fshikulli i prokurorit

Rezulton se mbeten jashtë fashikullit provat për të cilat nuk shfaqet rreziku i mosarritjes në gjykim sic janë ato që kan burim personal sic mund të jenë deklaratimet e personave që trrgojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit ku mund të përmendim viktimën ose dëshmitarët eventual. Gjithashtu deklarimet e të pandehurit mbeten jashtë fashikullit të gjykimit dhe kështu në fashikullin e prokurorit, të gatëshme për tu përdorur si lexime të lejueshme²²⁴ kur nuk mund të

²²² D.Lara “Koment mbi Proceduren Penale” Botimet Morava, Tiranë 2019, fq 1079.

²²³ Sipas Autorit D.Lara “Koment mbi Proceduren Penale” Botimet Morava, Tiranë 2019 “Nga kjo rrjedh se nuk është në lirinë e veprimit të pakufishëm të gj.s.p përcaktimi i akteve të nevojshëm për gjykim, përvecse I atyre të parashikuara nga ligji se kryhen në funksion të gjykimit.”

²²⁴ Neni 369 k.p.p **Leximet e lejueshme:** “1. Gjykata edhe kryesisht, vendos që të lexohen, tërësisht ose pjesërisht aktet që përmbahen në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor. 2. Me kërkesën e palëve, gjykata mund të vendosë që të

dëshmohej apo si kundërshtime²²⁵ kur më parë ata janë pyetur apo kanë refuzuar të pyeten në gjykim.

Si përfundim mund të thuhet se fashikulli i prokurorit përbëhet nga kopjo e akteve që përbëjnë fashikullin e gjykimit si dhe të gjitha deklaratimet e bëra gjatë fazës së hetimeve paraprake nga i pandehuri, i bashkëpandehuri, viktimat, personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit apo i padituri civil, të cilat janë të gatëshme për tu përdorur nëse rezultojnë nga rastet e parashikuara në ligj.

Sipas disa autorëve edhe pse vendimi i gj.s.p për dërgimin e çështjes në gjy së bashku me fashikullin e gjykimit qëndrojnë në sekretarinë e gjykatës kompetente, në respektim të sjelljes deontologjike që passjell shmangjen e kontaminimit të bindjes së brendshme të gjyqtarit para

lexohen aktet e marra gjatë hetimeve paraprake kur për shkak të rrethanave të paparashikuara ato nuk mund të përsëriten më. 3. Leximi i deklaratimeve të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur ose kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra 215 nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë. Në këtë rast akti vlerësohet duke u lidhur me provat e tjera. 4. Oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, që pyetet si dëshmitar, mund t'i përdorë aktet e policisë gjyqësore për të ndihmuar kujtesën. 5. Në vend të leximit, gjykata, edhe kryesisht, mund të tregojë aktet që lejohet të përdoren për dhënien e vendimit. Tregimi i akteve barazohet me leximin e tyre”

²²⁵ Neni 362 k.p.p **Kundërshtimi i dëshmisë:** “1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmisë ose kur refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por vetëm pasi dëshmitari ka deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. 2. Këto thënie nuk përbëjnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor. 3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. 4. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjykimit, sipas pikës 2 të këtij neni, çmohen si prova edhe kur rezultojnë se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij” Neni 370 k.p.p, **Leximi i deklaratimeve të bëra nga i pandehuri:** “ 1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e deklaratimeve të të pandehurit, palët mund të përdorin deklaratimet e bëra më parë nga ai dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, në qoftë se ka folur për faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. 2. Kur i pandehuri është deklaruar në mungesë ose nuk është paraqitur ose refuzon të përgjigjet për deklaratimet që ka bërë në prani të mbrojtësit në përputhje me paragrafin 3, të nenit 38, të këtij Kodi, gjykata vendos që të lexohen procesverbalet e deklaratimeve të bëra nga ai gjatë hetimeve paraprake. 3. Kur deklaratimet janë bërë nga persona të marrë si të pandehur në një procedim të lidhur, gjykata vendos shoqërimin e detyrueshëm. Kur nuk mund të sigurohet prania e deklaruesit, gjykata, pasi dëgjon palët, vendos leximin e procesverbaleve që përmbajnë deklaratimet.”

zhvillimit të procesit në kontradiktoritet mes palëve që intersa të kundërta në ‘lojë’ kanë, gjyqtari i themelit nuk duhet të shoh dosjen para se të filloj procesi.²²⁶

5.8 Gjyqtari i seancës paraprake sipas legjislacionit procedural penal italian (Giudice dell’Udienza Preliminare-GUP).

Senaca paraprake dhe gjyqtari i saj që mban të njëjtin emër janë një fazë e procesit penal dhe një subjekt procedural të cilët me ligjin 35/2017 rezultojnë të jenë tranpianuar nga legjislacioni procedural penal italian. Ashtu si në k.p.p edhe në legjislacionin italian seanca paraprake ka për qëllim të verifikojë bazueshmërinë e akuzës²²⁷. Në bazë të dispozitave të k.p.p. italian zhvillimi i seancës paraprake nuk lidhet me faktin nëse jemi përpara rastit të gjykimit me trup gjykues apo me gjyqtar të vetëm. Gjyqtari i seancës paraprake duhet të kontrollojë fashikullin e hetimeve paraprake dhe ka një funksion të ndryshëm nga ai i gjyqtarit të hetimeve paraprake(G.I.P), në sensin që kontrollon nëse kërkesa për gjykim e depozituar nga prokurori rezulton e mbështetur në prova apo jo. Pra G.U.P. ndërhyt në përfundim të fazës së hetimeve paraprake dhe ka për funksion të tij gjykimin nëse kërkesa e bërë nga prokurori (Pubblico Ministero) për dërgimin e çështjes për gjykim është e plotë ose jo. Në bazë të nenit 418 të kodit të procedurës penale të Italisë, brenda 5 (afat i njëjtë si në k.p.p) ditëve nga depozitimi i kërkesës për gjykim Gjyqtari i seancës paraprake, cakton me anë të dekretit, ditën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca

²²⁶Në këtë kontekst Qëndrim të njëjtë ndajmë edhe ne me autorët: D.Lara “*Koment mbi Procedurën Penale*” Botimet Morava, Tiranë 2019; A.Molinari “*Manuale di diritto processuale penale*” Monduzzi editore 1997; M.Mercone “*Diritto processuale penale*” Simone editore 2003; A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010.

²²⁷ Në lidhje me procedimin penal përpara Gjyqtarit të Pajtimit(Giudice di Pace) kjo seancë nuk parashikohet, për vetë faktin e thjeshtimit të procedurave gjyqësore përpara këtij Gjyqtari. Kujtojmë se procedimi përpara Gjyqtarit të Pajtimit kryhet për vepra me rrezikshmëri të vogël shoqërore si dhe për kundervajtjet penale.

në dhomën e këshillimit, duke caktuar dhe mbrojtësin e të pandehurit në ato raste kur ky i fundit nuk ka një mbrojtës të zgjedhur prej tij. Gjyqtari i seancës paraprake njofton të pandehurin dhe palët e tjera private, që të paraqiten në ditën e caktuar së bashku dhe me paralajmërimin se në rast se nuk do të paraqiten në ditën e caktuar, do të gjykohen në mungesë (*in contumacia*).

Më sipër u parashtrua se nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e cështjes në gjyq deri në datën e gjykimit në senacë paraprake nuk duhet të kaloj një afat më i gjatë se dhjetë, dhe se gj.s.p duhet të njoftojë palët të paktën 10 ditë para datës së senacës (afat i njëjtë me k.p.p italian). Në rastin e senacës paraprake sipas ligjit procedural penal italian afati në dispozicion të g.u.p për të caktuar datën e senacës është 30 ditë nga momenti që kërkesa për dërgimin e cështjes në gjyq mbërrin në sekretarinë e gjykatës.²²⁸ Cmojmë se është i nevojshëm një normim i ngjashëm edhe në legjislacionin tonë në mënyrë që të shmanget gj.s.p nga detyrimi për të përzgjedhur se cilën nga dispozitat duhet të respektoj në rastin kur shorti nuk hidhet në të njëjtën ditë që ka mbërritur kërkesa për dërgimin e cështjes në gjyq.

Identike janë dispozitat që kanë të bëjnë me veprimet përgatitore g.u.p pasi edhe sipas k.p.p italian: Seanca paraprake (neni 420 i k.p.p. italian), zhvillohet në dhomën e këshillimit me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit; Gjyqtari në fillim të seancës kryen verifikimet e nevojshme në lidhje me paraqitjen e palëve, e mund të disponojë për, ribërjen e njoftimeve në rastet kur çmon se njoftimet e mëparshme janë të pavlefshme. Në rast se mbrojtësi i të pandehurit nuk është i pranishëm, atëherë gjyqtari mund të vendosë për zëvendësimin e tij me një mbrojtës tjetër me kusht që ai të gjendet menjëherë. Në rast se i pandehuri nuk paraqitet në seancë dhe nuk ekzistojnë kushtet objektive që të ndalonin pjesëmarrjen e tij në seancë paraprake, gjyqtari i seancës paraprake deklaron mungesën e të

²²⁸ Art 418, comma 2 c.p.p.

pandehurit.(neni 420 quater i k.p.p. italian); Pasi kryhen verifikimet në lidhje me paraqitjen (legjitimitetin) e palëve, gjyqtari deklaron të hapur diskutimin. Prokurori (pubblico ministero) parashtron në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimeve paraprake si dhe faktet dhe provat të cilat justifikojnë paraqitjen e kërkesës për gjykim; I pandehuri mund të bëjë deklarime spontane dhe të kërkojë që të merret në pyetje. Pastaj mund të flasin sipas radhës mbrojtësi i palëve private (nëse ka) si dhe mbrojtësi i të pandehurit. Prokurori dhe mbrojtësit mund të replikojnë midis tyre vetëm një herë. Prokuori dhe mbrojtësit formulojnë pretendimet respektive duke i argumentur në bazë të akteve të cilat ndodhen në fashikullin e hetimit. Në rast se Gjyqtari i Seancës Paraprake çmon se mund të vendosë në gjendjen që janë aktet atëherë deklaron të mbyllur diskutimin. Në rast se Gjyqtari i Seancës Paraprake mendon se hetimet nuk janë të plota, vendos (ordinanza per l'integrazione delle indagini) për kryerjen e hetimeve të mëtejshme duke caktuar dhe një afat për kryerjen e hetimeve si dhe datën e seancës tjetër paraprake. Gjyqtari i seancës paraprake mund të disponojë dhe kryesisht, marrjen e provave të tjera, të cilat çmohen se janë të rëndësishme. Në rast se gjatë seancës paraprake rezulton se akuza është e ndryshme nga sa del nga faktet e paraqitura, atëherë prokuori ndryshon akuzën dhe ja njofton të pandehurit të pranishëm në seancë. Në rast se i pandehuri nuk është i pranishëm në seancë, atëherë ndryshimi i akuzës i komunikohet mbrojtësit të të pandehurit.

Në rast se gjyqtari nuk disponon si më sipër, atëherë deklaron të mbyllur diskutimin dhe vendos në dy mënyra. Senaca paraprake për natyrën e sajë prej 'filtri' mund të ketë përfundime të ndryshme. Së pari ai mund të nxjerrë vendim për mosvazhdimin e procedimit (*sentenza di non luogo a procedere*)²²⁹ e së dyti mund të vendosë për dërgimin e çështjes për gjykim.

²²⁹ Art 425 c.p.p

5.9 Vendim për mosvazhdimin e procedimit (*sentenza di non luogo a procedere*)

Nëse del në sipërfaqe padobishmëria e debatit gjyqësor procesi humbet rëndësinë e tij dhe merret vendimi për mos vazhdimin e procedimit. Vendim që nxirret në rastet kur ekziston një shkak që e parashkruan veprën penale për të cilin ndjekja penale nuk duhej të ishte filluar, ose nuk duhet të vazhdonte si dhe në rastet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Një rast tjetër mbi të cilin bazohet vendimi për mosvazhdimin e procedimit është, kur fakti nuk ekziston ose kur rezulton se i pandehuri nuk e ka kryer ose dhe kur fakti nuk përbën vepër penale si dhe rastet kur i pandehuri është në një nga rastet e përjashtimit nga përgjegjësia penale. Gjyqtari mund të nxjerrë vendimin për mosvazhdimin e procedimit dhe në ato raste kur elementët e provës të paraqitur nga akuza janë të pamjaftueshëm, kontradiktore ose të pamjaftueshëm për të mbështetur akuzën.

Prerogativat vendimarrëse të g.u.p përputhen me ato të gjyqtarit të themelit (*giudice del dibattimento*), pasi formulat që i japin fund procesit, mbi të cilat vendoset lirimi nga akuzat ose sepse ka prova që shkarkojnë përgjegjësinë penale, ose sepse nuk ka prova që e ngarkojnë me përgjegjësi penale ose sepse provat në ngarkim janë kontradiktore, janë të aplikueshme edhe në këtë fazë. Përputhje kjo që merr në konsiderat edhe fushën e ndryshme të njohjes që i është rezervuar njërit dhe tjetrit gjyqtar.²³⁰

Vendimi për mosvazhdimin e procedimit mund të ankimohej nga prokuori dhe i pandehuri me përjashtim të rasteve kur në vendim është disponuar që fakti nuk ekziston ose se nuk e ka kryer i pandehuri. Mbi ankimin vendos gjykata e apelit në dhomën e këshillimit sipas rregullave tëparashikuara mbi zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit. Duke mosqënë shprehje e funksionit të plotë juridiksional, pasi merret ‘në gjendjen që janë aktet’ vendimi i dhën si më

²³⁰ M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010.

sipër, në fund të seancës paraprake mund të tejkalohet nga evolvimi i kuadros qi i ofrohet gjyqtarit për njohje. Në rast se pasi është nxjerrë vendimi për mosvazhdimin e procedimit dalin apo zbulohen prova të cilat vetëm ose së bashku me ato që ndodhen në fashikullin e hetimeve, mund të bëjnë të mundur dërgimin e çështjes për gjykim, Gjyqtari i Hetimeve Paraprake (GIP), mbi bazën e kërkesës së prokurorit mund të vendosë për revokimin e vendimit për mosvazhdimin e procedimit. Në kërkesën për revokim të vendimit, prokurori ka detyrimin që të tregojë dhe provat e reja si dhe mënyrat e marrjes së tyre. Gjyqtari i seancës paraprake(GUP) në rast se nuk deklaron te papranueshme kërkesën, i cakton një mbrojtës të pandehurit(nëse nuk ka) dhe cakton datën e seancës paraprake duke njoftuar dhe palët e tjera.²³¹ Seanca kryhet sipas rregullave që u përcaktuan më sipër.

5.10 Vendim për dërgimin e çështjes në gjyq (*decreto che dispone il giudizio*)

Seanca paraprake konsiston pra në një kontroll *full discovery* (paraqitje e plotë) të provave dhe të burimeve prej nga janë marrë provat nga ana e organeve të akuzës si policia gjyqësore apo prokurori²³². Kjo njohje e plotë e provave të marra nga ana e akuzës i lejon mbrojtjes së të pandehurit që të mund të krijojë dhe një strategji mbrojtjeje që mund të mbahet gjatë gjykimit.

Si rregull gjatë seancës paraprake nuk lejohet marrja e provave por g.u.p nëse konsideron hetimet të paplota mund të urdhëroj prokurorin ti plotësoj ato duke caktuar gjithashtu datën e seancës së re. Gjithashtu g.u.p mund të mari prova të reja kryesisht kur cmon se ka vënd për ti

²³¹ Art. 434-437 c.p.p

²³² Kujtojmë se seanca paraprake zhvillohet pa praninë e publikut por vetëm të palëve të interesuara (akuzë, mbrojtja e të pandehurit) në dhomën e këshillimit(camera di consiglio).

dhën fund procedimit me vendim pushimi (*sentenza di non luogo a procedere*)²³³ E veçanta e Gjyqtarit të Seancës Paraprake është fakti se ky gjyqtar ka funksionin e verifikimit të faktit nëse kërkesa për gjykim është e justifikuar në prova, por nuk i lejohet që të vendosë në lidhje me bazueshmerinë e provave²³⁴. Mund të thuhet se seanca paraprake (udienza preliminare) shërben si një “*filter*” midis fazës së *hetimeve paraprake* dhe shqyrtimit gjyqësor (*dibattimento*), në mënyrë që të evitohet shqyrtimi gjyqësor i kërkesave për gjykim të cilat nuk janë të mbështetura në prova. Një karakteristikë tjetër e funksioneve të Gjyqtarit të Seancës Paraprake(G.U.P) është fakti se ai mund të disponojë dhe në lidhje me masat e sigurimit personale (*de libertate*).

Mbi bazën e kërkesës së palëve ose edhe kryesisht(*d’ufficio*) ky gjyqtar mund të vendosë apo ndryshojë masat e sigurimit. Kjo gjë rrjedh nga fakti se Gjyqtari i Seancës Paraprake siç u theksua më lart, verifikon provat, mënyrat e marrjes së tyre e për pasojë gjykimi i kryer nga G.U.P., mund të shtrihet dhe në lidhje me kushtet që duhet të ekzistojnë në lidhje me vendosjen, ndryshimin apo zëvendësimin e masave të sigurimit. Për rrjedhojë ky gjyqtar mund të disponojë si mbi bazën e kërkesës së palëve por dhe kryesisht nëlidhje me ndryshimin dhe zëvendësimin e masave të sigurimit.

Seanca paraprake mund të ndahet në disa faza të cilat janë a)faza hyrëse; b)faza e zhvillimit të seancës; c)faza e vendimmarrjes në lidhje me faktin nëse çështja do të shkojë në gjykim apo jo. Faza e parë (hyrëse) konsiston në paraqitjen përpara gjyqtarit të akt akuzës si dhe të provave mbi të cilat mbështetet akuza. Prokurori (*Pubblico Ministero*) si pëëgjegjësi kryesor i fazës së hetimeve paraprake, depoziton kërkesën për gjykim (*rinvio a giudizio*) së bashku me fashikullin e hetimeve paraprake. Kërkesa për gjykimin e çështjes e depozituar nga ana e prokuorit duhet të paraprihet nga njoftimi i të pandehurit për mbylljen e hetimeve paraprake. Pasi është depozituar

²³³ Vetëm në raste të caktuara siç mund të jenë rastet e sigurimit të provës (incidente probatorio) apo ato të parashikuara nga art.421bis dhe 422 c.p.p lejohet marrja e provës gjatë seancës paraprake.

²³⁴ Verifikimi i provave do të kryhet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

kërkesa për gjykim, i takon Gjyqtarit të Seancës Paraprake(G.U.P.) që të caktojë datën për seancën paraprake duke njoftuar palët e interesuara. Caktimi i datës së seancës paraprake kryhet me dekret(*decreto*²³⁵).

Faza e dytë (*zhvillimi i seancës*) konsiston në paraqitjen e provave nga ana e prokurorit(Pubblico Ministero). Në rast se nga parashtrimi i provave vërehet se bëhet fjalë për një vepër penale të ndryshme nga ajo e kërkuar nga prokurori, gjyqtari i seancës paraprake, fton prokurorin të bëjë ndryshimet e nevojshme(*integrazione dell'accusa*). Pasi prokurori parashtron provat, mbrojtësi i të pandehurit mund të bëjë pyetje²³⁶ në lidhje me mënyrat e marrjes së provave.

Faza e tretë (*faza vendimmarrëse*) konsiston në mënyrën e disponimit të Gjyqtarit të Seancës Paraprake. Ky gjyqtar mund të vendosë ose me *dekret*, i cili konsiston në dërgimin e çështjes për gjykim (*giudizio dibattimentale*²³⁷) apo në rastin e dytë mund të disponojë me vendim (*sentenza*²³⁸) për mosvazhdim të procedimit(*sentenza di non luogo a procedere*)

Rregulli i përgjithshëm është që i njëjti gjyqtar që ka ushtruar rolin e gjyqtarit të hetimeve paraprake nuk mund të kryesojë seancën e hetimeve paraprake të të njëjtit procedim penal. Rastet përjashtimore janë atëherë kur në rrjedhën e hetimeve paraprake ai është kufizuar vetëm në dhënien e autorizimeve me karakter shëndetësor, dhënien e lejeve për bashkëbisedime, korespondencë telefonike, dhënien e lejeve ose ato deklarative të procedimit në mungesë. Ky parashikim i përcaktuar në nenin 7-të, (paragrafi 1 ord.giud.) përcakton mospërputhshmërinë e këtyre dy figurave (gjyqtari i hetimeve paraprake dhe gjyqtari i seancës paraprake). Kjo

²³⁵ Dekreti (decreto) është një akt i cili nxirret nga autoriteti procedurës dhe kryesisht ka funksion administrativ gjatë nje procedimi.

²³⁶ Në këtë moment mbaron sekreti hetimor dhe mbrojtja njihet me faktet dhe provat e mbledhura nga akuza.

²³⁷ Në këtë rast çështja kalon për gjykim duke filluar me caktimin e datës së seancës së parë, paraqitjes së palëve, shqyrtimi gjyqësor, vlerësimi i provave dhe dhënia e vendimit përfundimtar.

²³⁸ Vendimi për mosvazhdim të procedimit (*sentenza di non luogo a procedere*)duhet të jetë e bazuar në fakt dhe në ligj.

mospërputhshmëri ka për qëllim të evitojë që gjyqtari i cili është thirrur të shohë dhe të përcaktojë përfundimin e seancës paraprake nuk duhet të kushtëzohet dhe të influencohet nga vlerësimi i indicieve të fajësisë të të njëjtit subjekt që ka vepruar edhe në fazën e hetimeve paraprake²³⁹. Si gjyqtari i hetimeve paraprake ashtu edhe ai i seancës paraprake janë gjyqtarë të gjykatës së përgjithshme, të cilët kanë kryer për së paku dy vjet funksionet e gjyqtarit deldibattimento (neni 7 bis-paragrafi 2 bis ord. giud).

5.11 Formimi i fashikullit të gjykimit

Në rastin kur gjyqtari i seancës paraprake (GUP) nxjerr vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim, pasi dëgjon palët, formon dhe fashikullin e debatit gjyqësor (*fascicolo del dibattimento*) i cili do të përdoret në gjykim përpara gjykatës që do të shqyrtojë çështjen në themel.

Qëllimi që ligjvënsi ka kërkuar të arrij me agarcinë e ‘doppio fashikullit’²⁴⁰ është mos kontaminimi i gjyqtarit të themelit me elementet e marrë gjatë hetimeve paraprake nga prokurori dhe mbrojtësi. Mos kontaminimi në terma absolut, i gjyqtarit të themelit me elementet e marrë gjatë hetimeve paraprake do të mund të arrihej vetëm nëse gjykimi i themelit do të kishte vend në kontekstualitetin e faktit vepër penale. Duke u kufizuar qëllimi i veprimtarisë hetimore- të dobishëm vetëm për të orjentuar titullarin e akuzës të ushtroj apo të mos ushtrojë ndjekjen penale- është përjashtuar në parim një rëndësi provuese e kësaj veprimtarie pasi formimi i provës është i rezervuar vetëm gjyqtarit të themelit.²⁴¹

²³⁹ Conso-Grevi “Compendio di procedura penale”, Cedam 2003, fq.459-460.

²⁴⁰ M.Ferraioli, në veprën “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010 në faqen 611 shprehet se: “*Fashikulli i parë formohet më nisjen e procedimit dhe pasurohet dalë-mgadale me veprimtarinë që kryhet gjatë hetimeve paraprake, në seancë paraprake dhe nëse është parashikuar edhe më vonë Në të gjenden dokumentimi i veprimtarisë së hetimeve paraprake që kryhet nga prokurori dhe dokumentimi I aktiviteti hetues që eventualisht mund të kryhet nga mbrojtësi. Fashikulli i dytë formohet për në debatin gjyqësorë dhe është I destinuar për gjyqtarin që do të thirret për të dokumentuar gjykimin*”

²⁴¹ M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010.

Në fashikullin e debatit përmbahen: a) aktet që lidhen me akuzën, b) procesverbalet e akteve të papërsëritshëm të cilët janë kryer nga policia gjyqësore), c) procesverbalet e akteve të papërsëritshme që janë kryer nga prokuori dhe nga mbrojtësi, d) dokumentet e marra jashtë vendit përmes letrave porosive si dhe procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme të marra në të njëjtën mënyrë, e) procesverbalet e veprimeve të kryera për sigurimin e provës, f) procesverbalet e akteve, përveç atyre të parashikuara nga shkronja 'd', të marra jashtë vendit si rezultat i letërporosive ndërkombëtare për të cilat avokatët janë vendosur në një pozicion për të ndihmuar dhe ushtruar fakultetet e lejuara nga ligji italian, g) certifikatën e përgjithshme të rekordit penal dhe dokumentet e tjera të treguara në nenin 236²⁴², f) provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, kur nuk duhet të ruhen në vend tjetër.

Palët mund të bien dakord mes tyre për futjen në fashikullin e debatit gjyqësor dhe të akteve që ndodhen në fashikullin e prokuorit si dhe të dokumentave që kanë lidhje me aktivitetin e hetimit të mbrojtjes së të pandehurit (*attività di investigazione difensiva*).²⁴³

Sic shihet qartazi, në përbërjen e fashikullit të gjykimit sipas legjislacionit procedural penal italian mungojnë: procesverbalet për veprimet e këqyrjes, njohjes dhe eksperimentit hetimor; aktet e ekspertimit; procesverbalet e provës të procedimeve të tjera të lidhura; procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve e komunikimeve; dhe çdo akt tjetër të rëndësishëm për gjykimin.

²⁴² Neni 236 c.p.p i titulluar Dokumente në lidhje me gjykimin mbi personalitetin përcakton se :“*Eshtë e mundur të merren certifikatat e të dhënave penale, dokumentacioni ekzistues në zyrat e shërbimit shoqëror të organeve publike dhe në zyrat e shërbimit të provës , si dhe dënimet e paravokueshme të çdo gjykatësi italian dhe dënimet e huaja të njohura, për qëllime të gjykimit të personalitetit të të akuzuarit ose të personit të viktimës, nëse fakti për të cilin procedohet duhet të vlerësohet në lidhje me sjelljen ose cilësitë morale të këtij të fundit*”

²⁴³ Art. 431 c.p.p, Fascicolo per il dibattimento

KAPITULLI VI:

Konkluzione dhe rekomandime

6.1 Konkluzione

Në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore kanë ekzistuar rrugë dhe mënyra të ndryshme të zhvillimit të procesit të të provuarit dhe konkretisht gjetjes së të vërtetës në procedimin penal.

Historia e shteteve europiane ka njohur dy lloje sistemesh procedurale penale dhe prevalenca e njërit apo e tjetrit sistem vinte në varësi të konceptit që kishte shoqëria mbi lirinë personale të individit. Shtetet totalitare ishin të interesuara ti jepnin një përgjigje të shpejtë dhe efikase në rastet kur ndodhte krimi, dhe këtë e bënin pavarësisht nëse çënoheshin të drejtat dhe liritë themelore të subjektit që procedohej.

Shprehje e një tradite të konsoliduar nga epoka e perandorisë romake, sistemi inkuizitor i cili ka arritur majat e zbatueshmërisë së tij në procesin kanonik²⁴⁴, strukturohej sipas kriterëve të konfuzionit në të njëjtin subjekt rolet e akuzuesit dhe gjyqtarit, në atribuimin e akuzatorit-gjyqtar të detyrës për të kërkuar burimet e provës dhe në pamundësinë e të akuzuarit për të marrë pjesë në aktivitetin e individualizimit dhe të sigurimit të burimeve të provave; përvetësimi i mënyrës së shkruar në marrjen e elementëve të provës; trajtimi në sekret i procesit; parashikimi i burgosjes *ante judicium*.²⁴⁵

Sistemi akuzator ashtu sic ishte strukturuar në epokën republikane të Romës në ndryshim nga ai inkuizitor, bazohej në modelin e kundërshtimit midis palëve, akuzuesi dhe i akuzuari vendoseshin përpara një të treti me funksionin e gjyqtarit.

Rregullat e procesit akuzator kërkonin domosdoshmërisht prezencën e një akuzuesi i ndryshëm nga gjyqtari, i cili vepronte në kushte të barabarta me të akuzuarin në kërkimin e elementeve të

²⁴⁴ Në historinë europiane çdo fuqizim i pushtetit të Shteti i korrispondonte një reduktim i pushtetit të kishës dhe anasjelltas. Procesi kononik është procesi penal i cili zbatohet nga autoritetet e kishës katolike.

²⁴⁵ Shprehje latine që nënkupton marrjen e një vendimi përpara se të procedohej gjyqësisht.

provës për ti vendosur ato më pas në vlerësimin e gjyqtarit; panashmërinë e gjyqtarit , i thirrur, si subjekt i zhveshur nga funksione hetuese, të vendosi në bazën e provave të marra me iniciativë të palëve; prezumimi i pafajsisë së personit të akuzuar, deri në momentin kur vendimi i dënimit merr forëm të prerë; mbrojtja e të drejtave themelore të të akuzuarit në pritje të procedimit; publicitet i procedurës, pa u fragmentizuar nga aktivitete sekrete, për të lejuar kontrollin efektiv të shoqërisë.

Nga hulumtimet e kryera për llogari të këtij disertacioni ka rezultuar se ligji 35/2017 që ndryshoj pjesën më të madhe të dispozitave të kodit të procedurës penale ka pasur një ndikim minimal në aktivitetin e gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe ka parashikuar seancën paraprake . Ndyshimet kryesor në kishin të bënin me: introduksionin e senacës paraprake si një fazë e re e procesit penal dhe të gjyqtarit të senacës paraprake si një subjekt i ri i procesit penal i cili në dallim nga gjyqtari i hetimeve paraprake ka kompetenca të mirëpërcaktuar; ndyshim tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me të drejtat e viktimës në procesin penal e cila njësoj si i pandehuri ka të drejtën të njoftohet dhe të jetë prezent në faza të rëndësishme proceduriale dhe mosnjoftimi i saj mund të shkaktoj pavlefshmërinë absolute të gjithë procesit penal; reformimi i kodit të procedurës penale nuk harroj edhe institutin e rigjykimit i cili nuk mund të kërkohet në rast se duhet të rishikohet një vendim pafajësie i formës së prerë apo kur kërkohet të rëndohet pozita e të pandehurit; përsa i përketë fazës së hetimeve paraprake ajo që këtu vlen të theksohet ka të bëjë me heqjen e disa attributeve që më parë i përkisnin prokurorit. Prokurori tashmë nuk mundet të procedoj çështjen kryesisht kur heton një krim dhe as mund të disponoj kryesisht dërgimin e çështjes në gjyq por në të dyja rastet është i detyruar ti drejtohet me kërkesë subjektit të ri procedural, gjyqtarit të seancës paraprake. Gjithsesi, prokurori konservon akoma të drejtën për të vendosur mosfillimin e procedimit, pezullimin e procedimit dhe pushimin e çështjes kur procedon për kundravajtje

penale. Këto vendime megjithse me karakter të pastër juridiksional ligjvënsi ka hezituuar t'ia kaloj gjyqtarit, i cili si subjekt i tretë dhe i paanshëm, në kontradiktoritetin mes palëve që kanë interesa të kundërt në procedim mund të marrë një vendim më cilësorë dhe për rrjedhojë më të drejtë.

Një ndër funksionet kryesore të gjyqtarit të hetimeve paraprake, dhe ndoshta me i rëndësishëm, është disponimi në lidhje me kërkesat për caktimin e masave të sigurimit gjatë hetimeve paraprake, por gjithashtu e një rëndësie të vecantë paraqitet edhe ndëryhrja e tij në adminstrim të mjeteve të kërkimit të provës sic janë *in primis* përgjimet, të cilat vetëm në raste urgjence mund të vendosen me iniciativën e prokurorit dhe për një periudhë jo më të gjatë se 48 orë brenda së cilës duhet të kërkohet miratimi i gj..h.p.

Në përfundim të fazës së parë që ka të bëjë pikërisht me *hetimet paraprake* të kryera nga ana e Prokurorit Publik, të cilat kanë për qëllim të mbledhin të gjitha faktet me qëllim që ky i fundit për një person që prezumohet i përfshirë në veprën penale si përgjegjës (person i dyshuar), të vendosë nëse do të procedojë ose jo në ngritjen e akuzës përfundon edhe aktiviteti i gjyqtarit të hetimeve paraprake. Me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq (përmbajtja e së cilës është normuar në mënyrë taksative, e pa arsyetuar me qëllimi të mos i ngarkoj punë prokurorit dhe në të njëjtën kohë të shmang cdo kushtëzim të gj.s.p), fillon faza e dytë e quajtur *senaca paraprake* e cila zhvillohet përpas një gjyqtari, i quajtur gjyqtari i seancës paraprake dhe përbën një *'filtër'* midis hetimeve paraprake dhe gjykimit dhe ka si funksion që të përcaktojë nëse veprimet e kryera gjatë hetimeve paraprake janë në përputhje me rregullat e përcaktuara në k.p.p dhe nëse këto veprime janë të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykim.

Arrihet kështu në përfundim të këtij studimi duke evidentuar se ndryshimet e aplikuar me ligjin 35/2017 kanë zbehur karakterin inkuizitor të procesit penal, duke aplikuar te drejtat e të

pandhurit/hetuarit për një proces të rregullt ligjor, por gjithsesi ato nuk e kanë konsoliduar figurën e gj.h.p duke bër të pa mundur evitimin e formalitetin e aprovimit të kërkesave të prokuroit.

6.2 Rekomandime

Së pari, edhe pse gjyqtari i hetimeve paraprake shfaqet rishtazi në procesin penal shqipëtar kompetencat e tij janë të përcaktuara në mënyrë mjaftë të përgjithshme saqë lënë hapsirë për interpretim dhe konfundojnë palët në veprimtarinë e tyre. Fakti se termi “*gjyqtar i hetimeve paraprake*” shfaqet vetëm 2 herë në gjithë kodin e procedurës penale është mjaftë domethënës për të kuptuar se ligjvënsi nuk është sforcuar minimalisht për të përcaktuar në mënyrë të shprehur rastet kur ky gjyqtar duhet dhe mund të ndërhy. Nuk kuptohet nëse në rastin e gjykimit të drejtpërdrejtë mund të jetë i njëjti gjyqtar që vleftëson arrestimin, cakton masën e sigurisë dhe procedon me gjykimin apo ka papajtueshmëri për shkak të pjesëmarrjes në procedim. Gjithashtu e dyshimtë mbetet situata për të përcaktuar gjyqtarin kompetent për shqyrtimin e një marrëveshje eventuale të arritur mes prokuroit dhe të pandehurit gjatë hetimeve paraprake mbi pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Situata të tilla gjenden gjithandej në kodin e procedurës penale dhe është e udhës një ndërhyrje tjetër reformuese e domosdoshme dhe e mjaftueshme për të përcaktuar kufinj të kompetencës së këtij subjekti të ri procedural.

Së dyti, juridiksioni, si respektimi i formave, nënkupton dialogun midis mbajtësve të interesave të kundërta në ndjekjen penale të fakteve të paligjshme kriminale dhe garantimin e së drejtës së mbrojtjes para një gjyqtari i cili, nga ai dialog, duhet të nxjerrë arsyet e bindjes së tij, në mënyrë që të vendosë ndaj një kërkesë për konfirmimin apo jo të përgjegjësisë penale. Sa herë prokurori hap hetimin e tij për pjesëmarrje mbrojtëse, duke e vendosur veten në një pozitë kontradiktore në lidhje me ata që kanë interes liri, kushtet për rëndësinë juridiksionale të një veprimtarie të tillë janë përmbushur. Nëse, atëherë, rezultati i veprimtarisë i nënshtrohet vlerësimit të një gjyqtari, garancitë juridiksionale janë në gjendje të shprehen në tërësinë e tyre.

Në këtë kontekst sa herë prokurori vendos msofillimin e hetimeve pasi: personi ka vdekur; personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale; mungon ankimi i viktimës ose ajo e tërheq ankimin; kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston; vepra penale është shuar; është dhënë amnisti; ose në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji, ai e vendos veten në një pozitë kontradiktore në lidhje me palën tjetër që ka një interes të mbrojtur nga Kushtetuta.

Gjithahstu në rastet kur prokurori vendos pezullimin e hetimeve pasi nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, përsëri nga ana tjetër ekziston një subjekt që ka një interes të mbrojtur nga kushtetuta dhe diametralisht të kundërt me vendimin e prokurorit.

Emblematic është rasti kur prokurori procedon për kundërvajtje penale dhe vendos të mos ushtrojë ndjekejn penale duke u shenderruar në gjykatës e duke vlerësuar se: fakti nuk ekziston; fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; viktimë nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; i pandehuri vdes; apo se ka ndonjë rast tjetër të parashikuara me ligj. Vendimi i pushimit për kundërvajtje penale nga prokurori është një nga ato raste ku legjislacioni procedural penal ka përshtatur në gjirin e tij apo thelbin e tij parime të sistemit inkuizitor me një prokuror-gjykatës.

Si vendimi i prokurorit për msofillimin e procedimit, vendimi për pezullimin e procedimit ashtu edhe vendimi për pushimin e akuzës ose çështjes janë vendime që e vendosin prokurorin në një

posit diametralisht të kundër me viktimën e veprës penale apo edhe me vetë të pandehurin kur pretendon një formulë më të favorshme pushim. Është e vërtet se për këto raste ligji parashikon mundësinë e kontrollit gjyqësor të vendimit, por mund të nodh që palët nuk marrin dijeni për vendimet e prokurorit pasi asnjë pavlefshmëri nuk shkaktojnë dispozitat që lidhen me njoftimin e vendimeve në fjalë e për rrjedhoj vendim i prokurorit me karakter juridiksional zgjidhe çështjen. Ka dyshme të forta për mospërputhje kushtetuese të dispozitave që legjitimojnë marrjen e vendimeve në fjalë nga prokurori. Gjykata, si tërësi e organeve , gjyqësore me pushtet gjyqësie është e pajisur me pushtet për të vendosur/ius dicere të cilin e ka jo vetëm të drejtë por edhe detyrim të pashmangshëm për ta ushtruar. Dhe pikërisht njohja e kësaj të drejte-detyrimi apo ngarkimi me këtë funksion është juridiksioni- shqip gjyqësia- konkretizim i pushteti gjyqësor. Kushtetuta në nenin 135 të sajë përcakton se *“Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj”* duke mos lënë asnjë shteg për interpretim.

Duhet të konsolidohet pikërisht figura e gjyqtarit të hetimeve paraprake me qëllim që organi akuzës mos të marrë më vendime me karakter juridiksional por vetëm të konstatoj duke ja lënë vendimëmarrjen një subjekti të pavarur dhe të paanshëm i cili të vendos në respektim të parimit të kontradiktoritetit.

Së treti, si në rastet kur prokurori procedon për krime dhe vendos të mos ushtroj ndjekjen penale, ashtu edhe kur ankimohet vendimi i prokurorit që pushon procedimin për kundërvajtje nuk ka arsye pse të aktivizohet gj.s.p, duke qenë i mjaftueshëm gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, jo vetëm se ky i fundit prezumohet se ka një njohje më të plotë të

verpimtarise hulamtuese së zhvilluar nga prokurori dhe po.gjyq dhe për rrjedhoj vendimi i tij duhet të jetë më cilësor, por edhe për faktin se duke konsideruar papajtueshmëritë për shkak të pjesmarrjes në procedim është e kotë të ‘digjet’ edhe një gjyqtar tjetër person fizik, i cili do të ishte i dobishëm për gjykimin në themel apo edhe në rastet eventuale kur gjykata e apelit apo gjykata e lartë do të kthente çështjen për rishqyrtim.

Së fundmi, përsa i përketë senacës paraprake, shihet e nevojshme një ndërhyrje në momentin fillestarë dhe në momentin përfundimtarë.

Duke normuar se data e cenaces paraprake nuk duhet të jetë me larg se dhjetë ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim dhe se palët duhet të njoftohen dhjetë ditë para, ligjvënsi vë në pozitë të vështirë gj.s.p që me short nuk është caktuar pikërisht në momentin e mbrritjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq duke e detyruar atë të zbatoj njërën ose tjetrën kërkesë ligjore e duke e bërë kështu subjekt të përgjegjësisë disiplinore pasi rregullat e k.p.p janë të detyrueshme për subjektet e procesit penal. Nga sa më sipër është e udhës që të zgjatet afati në lidhje me datën e senacës dhe të mundësohet rrespektimi i kërkesave ligjore. Kur procedohet me gjykim të zakonshëm duhet bërë ndarja ndërmjet fashikullit të gjykimit dhe atij të prokurorit dhe për këtë gj.s.p ka një detyrë ekstremisht delikate pasi në kontradiktoritetin mes palëve i takon atij të formoj fashikullin e gjykimit. Selektimi i “*fashikullit të dyfishtë*” lind nga nevoja për të ndaluar që gjykatësi i shqyrtimit gjyqësor, në ushtrimin e pushteteve të tij të matur/diskrecional të ndikohet nga përmbajtja e akteve të hetimeve paraprake që siç e dimë nuk kanë vlerën e provës dhe përfundojnë funksionin e tyre me dërgimin në gjyq të të pandehurit. Qëllimi që ligjvënsi ka kërkuar të arrij me agarrancinë e ‘fashikullit të dyfishtë’ është mos kontaminimi i gjyqtarit të themelit me elementet e marrë gjatë hetimeve paraprake nga prokurori dhe mbrojtësi. Mos kontaminimi në terma absolut, i gjyqtarit të themelit me elementet e marrë

gjatë hetimeve paraprake do të mund të arrihej vetëm nëse gjykimi i themelit do të kishte vend në kontekstualitetin e faktit veprë penale. Duke u kufizuar qëllimi i veprimtarisë hetimore- të dobishëm vetëm për të orjentuar titullarin e akuzës të ushtroj apo të mos ushtrojë ndjekjen penale- është përjashtuar në parim një rëndësi provuese e kësaj veprimtarie pasi formimi i provës është i rezervuar vetëm gjyqtarit të themelit

Edhe pse normativisht e përcaktuar, përmbajtja e fashikullit të gjykimit rezulton mjaftë e gjerë pasi në referim të nenit 332/ë pika 2 k.p.p aty gjenden: a) aktet që i përkasin kushteve për ushtrimin e ndjekjes penale dhe kërkesave për pranimin e padisë civile; b) procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme, të kryera nga policia gjyqësore dhe prokurori; c) procesverbalet e veprimeve të kryera për sigurimin e provës dhe të atyre të plotësuara jashtë shtetit në ekzekutim të letërporosisë; d) dëshminë e penaltetit dhe dokumente të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit dhe identifikimin e tij; e) provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, kur nuk duhet të ruhen në vend tjetër;

Në referim të nenit 431 të kodit të procedurës penale italiane, në fashikullin për e gjykimit përmbahen: a) aktet që lidhen me akuzën, b) procesverbalet e akteve të papërsëritshëm të cilët janë kryer nga policia gjyqësore), c) procesverbalet e akteve të papërsëritshme që janë kryer nga prokuori dhe nga mbrojtësi, d) dokumentet e marra jashtë vendit përmes letrave porosive si dhe procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme të marra në të njëjtën mënyrë, e) procesverbalet e veprimeve të kryera për sigurimin e provës, f) procesverbalet e akteve, përveç atyre të parashikuara nga shkronja 'd', të marra jashtë vendit si rezultat i letërporosive ndërkombëtare për të cilat avokatët janë vendosur në një pozicion për të ndihmuar dhe ushtruar fakultetet e lejuara

nga ligji italian, g) çertifikatën e përgjithshme të rekordit penal dhe dokumentet e tjera të treguara në nenin 236²⁴⁶, f) provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, kur nuk duhet të ruhen në vend tjetër.

Nga një krahasim objektiv evidentohet se: procesverbalet për veprimet e këqyrjes, njohjes dhe eksperimentit hetimor; aktet e ekspertimit; procesverbalet e provës të procedimeve të tjera të lidhura; procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve e komunikimeve; çdo akt tjetër të rëndësishëm për gjykimin, nuk rezultojnë të jenë pjesë përbërse e fashikullit për gjykim në k.p.p Italian.

Fakti është shumë domethënës për shkak se edhe pse është përjashtuar në parim rëndësia provuese e kësaj veprimtarie pasi formimi i provës është i rezervuar vetëm gjyqtarit të themelit, ky i fundit duke marrë në shqyrtim jashtë kontradiktoritetit mes palëve, veprimtarinë e mësipërme ndikohet në mënyrën e trajtimit të të pandehurit.

Ndërsa kqyrja dhe eksperimenti hetimor në parim janë veprime të papërsëritshme pai janë subjekt të ndryshimit të faktorëve të jashtëm, nuk ka arsye pse veprimi i 'njohjes' i kryer nga prokurori, pa prezencën e të pandehurit dhe mbrojtësit të tijë të jetë pjesë e fashikullit gjyqësor. Veprimi i njohjes që kryhet nëpërmjetë paraqitjes ose i tregimit me figure, të personave, sendeve dhe objekteve të tjera atij që duhet të bëjë njohjen, mund të shërbej si pistë hetimesh apo për të orjentuar prokurorin në lidhje me ushtrimin ose jo të ndjekejs penale, por jo ti paraqitet gjyqtarit në fashikullin për gjykim, jashtë kontradiktoriteti të palëve pasi rrezikon serjosisht dëmtimin e gjykimit me pasoja të rëndësishme për lirinë e shtetasve.

²⁴⁶ Neni 236 c.p.p i titulluar Dokumente në lidhje me gjykimin mbi personalitetin përcakton se : "Eshtë e mundur të merren certifikatat e të dhënave penale, dokumentacioni ekzistues në zyrat e shërbimit shoqëror të organeve publike dhe në zyrat e shërbimit të provës , si dhe dënimet e parevokueshme të çdo gjykatësi italian dhe dënimet e huaja të njohura, për qëllime të gjykimit të personalitetit të të akuzuarit ose të personit të viktimës, nëse fakti për të cilin procedohet duhet të vlerësohet në lidhje me sjelljen ose cilësitë morale të këtij të fundit"

I njejtë diskutim vlen edhe për *aktet e ekspertimit*, në kushtet kur normohet se për pyetjen e ekspertëve respektohen dispozitat mbi pyetjen e dëshmitarëve, është e udhës që akti i ekspertimit të qëndroj në fashikullin e prokuroit dhe të paraqitet në gjykatë në respektin të parimit të kontradiktoritetit pa kontaminuar paraprakisht qëndrimin subjektiv të gjyqtarit.

Përsa i përket *procesverbaleve të provës së procedimeve të tjera të lidhura*, parashikuar nga neni 193 k.p.p, ato në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në qëndrimin e gjyqtarit dhe rëndojnë pozitën e të pandehurit i cili ka të njëjtin status edhe në një proces tjetër që për shkakë të parashikuar në ligj nuk mund të bashkohet.

Rezulton se pjesë e fashikullit të gjykimit janë edhe *procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve e komunikimeve*. Mund të ndodh që transkriptimi i bisedave telefonike të mos jetë integral, dhe i paraqitur kështu para gjyqtarit të themelit influencon në ndërgjegjen e tij dhe bën të mundur që ai të formjë bindjen për rindërtimin llogjik dhe kronologjik të faktit penalisht të rëndësishëm ende para se të ketë dëgjuar të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, ndaj cmojmë se është e udhës që edhe këto veprime të paraqiten gjyqtarit në prezencë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Për më tepër dispozita përmban edhe një kluzolë të hapur kur normon se pjesë e fashikullit të gjykimit mund të jenë edhe të gjitha aktet e tjera të nevojshme, cka i jep një marzh mjaftë të gjerë diskrecionaliteti gj.s.p që mund të shpjerë në një influencim të pashmangshëm të gjyqtarit të themelit mbi mënyrën se si ai do të trajtojë të pandehurin.

Nga sa më sipër, rekomandohet reduktimi i përmbajtjes së fashikullit të gjykimit, në mënyrë që të respektohet procesi i rregullt ligjor i garantuar nga formimi i provës gjatë shqyrtimit gjyqësor në respektim të parimit të kontradiktoritetit.

BIBLIOGRAFIA

Burime parësore

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore;

3. Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut, BE;
4. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
5. Konventa e OKB-se kunder krimit te organizuar;
6. Konventa Penale e Keshillit te Evropes kunder korrupsionit;
7. Traktati i Bashkimit European;
8. Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit European;
9. Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise;
10. Kodi i Penal i Republikes se Shqiperise;
11. Kodi i Procedures Penale i Republikës së Kosovë;
12. Kodi i Procedures Penale i Republikës së Italisë;
13. Ligj nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*;
14. Ligj nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*;
15. Ligj nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*
16. Ligj nr. 25/2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”*;
17. Ligj nr. 108/2014 *“Për policinë e shtetit”*;
18. Ligj nr. 55/2018 *“Për profesionin e avokatit në republikën e shqipërisë”*
19. Ligj nr. 37/2017 *“Kodi i drejtësisë penale për të mitur”*

20. Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
21. Ligj nr.8750, datë 26.3.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”
22. Ligj nr. 10221, datë. 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit në RSH”;
23. Ligji nr. 8331, date 16.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar;
24. Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999,“Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar
25. Ligj nr. 8920 datë 11.7.2002 Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj

1.2 Burime dytësore

1. D.Lara “Koment mbi Proceduren Penale” Botimet Morava, Tiranë 2019;
2. Sh.Muçi “Edrejta penale (pjesa e përgjithshme)” Albdesign, Tiranë 2017;
3. K.Kurushi “Akuzat e reja në procesin penal” Disertacion per mbrojtjen e grades Doktor, U.T Tiranë 2017;

4. A.Belishta “*Aplikimi i akuzave të reja në procesin penal*” Shtypshkronja Kotti, Korçë 2017;
5. Y.Shkreli “*Roli i gjykatës gjatë hetimeve paraprake dhe në fazën paragjyqësore*” Botimë i Shkollës së Magjistraturës, Magjistrati VIII, Tiranë 2016;
6. D.Kumbaro “*Versus Albania*” Jurisprudenca e Gjykatës Europiane Për te Drejtat e Njeriut” Tiranë,2015;
7. H.Islami, A.Hoxha, I.Panda “*Procedura Penale*” Tiranë 2014
8. P.Tonini “*Manuale di Procedura Penale*” Tredicesima Edizione, Giufre Editore, Milano 2012;
9. F. Caprioli “*Compendio di procedura penale*” sesta edizione CEDAM-2012;
10. G.Lozzi “*Lezioni di procedura penale*” VIII edizione, Giapichelli editore, Torino 2012;
11. I.Peçi Shkolla e Magjistraturës “*Jeta juridike*” Revista juridike shkencore” Nr.1,viti IX i botimit,Tirane,Botimet Morrava. Mars 2011 “*Ndihma ligjore falas sipas KEDNJ*;
12. I.Salihi, “*E drejta penale. Pjesa e përgjithshme*”, Prishtinë, 2010;
13. A.A.Dalia, M.Ferraioli, “*Manuale di Diritto Processuale Penale*” Settima edizione, Cedam, Padova 2010;
14. Hans Kelsen “*Teoria generale del diritto dello Stato*” Copyright RCS Libri s.p.a Milano 2009;
15. M.Ferraioli “*Il ruolo di “grante” del giudice per le indagini preleminari*”Terza edizione,Cedam,Verona, 2006;
16. A.Islami, A. Hoxha, I. Panda, “*Procedura penale*” 2007;
17. Cassese, A., “*Lineamenti di diritto internazionale penale*”, Il Mulino,2006

18. A.Anastasi, “*Historia e Institucioneve*”, Tirane 2004;
19. Conso-Grevi “*Compendio di procedura penale*”, Cedam 2003;
20. G.Mercone, “*Diritto processuale penale*”, XI edizione, Simone editore 2003;
21. P. Di Stefano., P.Gatti., F.Izzo., R.Mario., “*Codice di procedura penale Annotato con la Giurisprudenza*” X Edizione, Napoli 2002, Gruppo editorial Esselibri-Simone;
22. Halim Islami, “*Demokratizimi i Legjislacionit Penal*”, Tirane 2000;
23. Hans Kelsen “*Lineamenti di dottrina pura di diritto*” Përkthyer nga Renato Treves. Gulio Einaudi editore. Torino 2000
24. A.Molinari “*Manuale di diritto processuale penale*” Monduzzi editore 1997;
25. Siracusano et al. “*Diritto processuale penale*”, Torino, Giuffrè editore, 1996.

Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Rpublikës së Shqipërisë:

- 1 Vendimin Nr.4, datë 23.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese;
- 2 Vendimi Nr.7, datë 16.02.2015 i Gjykatës Kushtetues;
- 3 Vendimin Nr.9, datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë:

- 1 Corte Costituzionale, vendim nr.241, dt.9-17 qershor.1999
- 2 Corte Costituzionale, vendim nr.155, dt. 20.05.1996;
- 3 Corte Costituzionale, vendim nr.371, dt.17.tetor-02.nëntor.1996;
- 4 Corte Costituzionale, vendim nr.432, dt.6-15 shtator 1995;
- 5 Corte Costituzionale, vendim nr.502, dt.19-30 dhjetor.1991;
- 6 Corte Costituzionale, vendim nr.496, dt.26.10.1990.

Vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë

- 1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Vendim nr.864 dt. 02.03.2018

Sitografia:

- 2 <https://www.brocardi.it/.html>

- 3 <http://www.fjalorshqip.com/>
- 4 <https://www.altalex.com/>

